RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI AUDITIMIN FINANCIAR
NË BASHKINË SHKODËR

Korrik 2022

Nr.	PËRMBAJTJA	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**4-12**
I.1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-5
I.2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-10
I.3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	10-12
II.	**HYRJA**	**12-16**
II.1.	Objekti i auditimit	
II.2.	Qëllimi i auditimit	
II.3.	Identifikimi i çështjes	
II.4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
II.5.	Përgjegjësitë e audituesve	
II.6.	Kriteret e vlerësimit	
II.7.	Standardet e auditimit	
II.8.	Metodat e auditimit	
II.9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**16-87**
III.1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	16-18
III.2.	**Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit**	18-87
III.2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	18-26
III.2.1.1	Mbi auditimin e brendshëm	26-29
III.2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	29-72
III.2.3	Opinioni mbi pasqyrat financiare të vitit 2021	72-87
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**87-96**
V.	**ANEKSE**	**97-118**

Shkurtime

AAJM	Aktive Afatgjata Jo Materiale
AAM	Aktive Afatgjata Materiale
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
DAV	Drejtoria e të Ardhurave
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IT	Teknologjia e Informacionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
NA	Nëpunës Autorizues
NJA	Njësi Administrative
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NZ	Nëpunës Zbatues
OE	Operator Ekonomik
PBA	Projekt-Buxheti Afatmesëm
PF	Pasqyrat Financiare
TNI	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
SHA	Shoqëri Anonime
SHPK	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
USH	Urdhër Shpenzimi
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) ushtroi auditim financiar në Bashkinë Shkodër, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprimtarisë së sektorit të auditimit të brendshëm, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, si dhe të transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 08.04.2022 deri më datë13.05.2022, grupi i auditimit auditoi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej5 akt-konstatime. Mbi aktet e mbajtura dhe Projekt Raportin e grupit të auditimit, nga subjekti i audituar, janë paraqitur observacionet, të cilat janë reflektuar rast pas rasti në mënyrë të përmbledhur nga grupi i auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur, në përfundim rezultoi se nga auditimi:

-Të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, për vitin 2021, u konstatua se,në fund të vitit 2021 në Bashkinë Shkodër dhe NJA borxhi tatimor është në vlerën 1,601,133 mijë lekë (426,803 mijë lekë krijuar brenda vitit 2021) vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodër.

-I dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve rezulton se përgjatë vitit 2021 në territorin e Bashkisë Shkodër dhe NJA, është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 45 stacione shitje.

-Arkëtimit të tarifës së licencimit të subjekteve për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburantit, u konstatua se në 28 prej tyre është ushtruar aktivitet pa u pajisur me licencën përkatëse. Për këto stacione konstatohet se përgjatë vitit 2021 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e subjekteve për detyrimin e pajisjes me licencë për ushtrimin e aktivitetit, njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë.

-Gjithashtu nga këto stacione shitje të karburantit u konstatua se për 20 prej tyre nuk është kryer pagesa e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodër në vlerën 13,871,692 lekë.

-Procedurave të ndjekurapër arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2021 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër në vlerën 256,014,573 lekë, nga të cilat:

-254,345,500 lekë gjoba të IMTV (36 gjoba në vlerën 173,468,000 lekë i përkasin vitit 2021)

-1,669,073 lekë Gjobat e Policisë Bashkiake. Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse[1]. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga IMTV Shkodër, rezulton se për gjobat e mësipërme është bërë kërkesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë (GJSHP) Shkodër për lëshimin e urdhrit për ekzekutimin e tyre nëpërmjet përmbarimit. Në vijim nga IMTV Shkodër i janë përcjellë vendimet e GJSHP Shkodër zyrave të përmbarimit për ekzekutimin dhe arkëtimin e gjobave të vendosura, por në vazhdim nuk administrohet informacion se cilat janë masat e

[1] Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 ñPër organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunësò, i ndryshuar, ñPër shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmujor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative"; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, si dhe Kreun IV.3.8 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër.

marra nga zyrat e përmbarimit, si sekuestrimin e pasurive të luajtshme/paluajtshme për likujdimin e gjobës, të cilat në gjykimin e grupit të auditimit vonojnë procesin e arkëtimit të gjobave.

-Nga Bashkia Shkodër janë marrë angazhime të reja buxhetore për vitin 2021 pa pasur fonde në dispozicion në llogarinë e vetë në degën e thesarit. Nga auditimi i kontratave për investime me afat financimi 2021-2023, miratuar me VKB nr.63, datë 28.12.2020, financuar nga të ardhurat e veta, konstatohet se përgjatë vitit 2021 nga Bashkia Shkodër në 8 raste, janë lidhur kontrata në vlerën 76,659 mijë lekë pa pasur në dispozicion minimalisht 20% të vlerës së kontratës për vitin e parë të financimit.

-Raportimit të transaksioneve dhe ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021, ka rezultuar kontabilizimi jo i saktë dhe i drejtë për:

Llogaria nr. 468 ñDebitorë të ndryshëmòështë kontabilizuar më pak për vlerën 223,179,324 lekë;

Llogaria nr. 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò është kontabilizuar më shumë për vlerën 2,064,307 lekë;

Llogaria nr. 683 ñShuma ty parashikuara ty shfrytëzimitò është kontabilizuar më pak për vlerën 79,382,461 lekë;

Llogaria nr.213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò është kontabilizuar më shumë për vlerën 9,614,406 lekë;

Llogaria nr.202 ñStudime dhe kërkimeò është kontabilizuar më shumë për vlerën 17,677,741 lekë.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
1	**Gjetje nga auditimi:**Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, për vitin 2021, u konstatua senë fund të vitit 2021 në Bashkinë Shkodër dhe NJA në mënyrë progresive janë 5972 subjekte debitore në vlerën 777,462 mijë lekë, nga të cilët brenda vitit 2021 janë debitor 4837 subjekte ñBiznes dhe Institucioneò në vlerën 181,019 mijë lekë, e ndarë si më poshtë vijon: -968 subjekte ñBiznesi i Madhò në vlerën 74,331 mijë lekë; -3841 subjekte ñBiznesi i Vogëlò në vlerën 83,622 mijë lekë; -28 subjekte ñInstitucioneò në vlerën 23,066 mijë lekë. -Për vitin 2021 taksa e fjetjes në hotel paraqitet me realizim në vlerën 12,967 mijë lekë kundrejt planifikimit në vlerën 15,000 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua se, ndjekja e kësaj taksë aplikohej bazuar në akt-konstatimet e Sektorit të Kontrollit në Terren çdo datë 5 fillim muaj me tarifën e përcaktuar në VKB është 70 lekë/natë/personi për hotele nën 4 yje dhe 175 lekë për hotele 4-5 yje. Në këto akt-konstatime nuk evidentohet se sa netë kanë fjetur këto persona, por është evidentuar thjeshtë numri i tyre. - Në raport me numrin e subjekteve debitorë në fund të periudhës ushtrimore dhe subjekteve për të cilat është kërkuar në zbatim të ligjit masa shtrënguese, konstatohet se numri i këtyre masave është i ulët, pasi nga 5972 subjekte fizik/ juridik me vlerë	29-72	E Lartë	**<u>Rekomandimi:</u>** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën 777,462 mijë lekë. **<u>Rekomandimi:</u>** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%. **Menjëherë**

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	238,686 mijë lekë janë marrë masa shtrënguese vetëm për 802 subjekte ose rreth 14% e totalit të subjekteve. Marrja e këtyre masave nuk është e plotë sepse nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese në rend shterues, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, vendosje e barrës hipotekore, barrë siguruese, deri në kallëzim penal.			
2	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, u konstatua se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Shkodër dhe NJA vlera debitore e kategorisë ñfamiljarò është 566,030 mijë lekë (216,018 mijë lekë debitor krijuar brenda vitit 2021), nga të cilat: -16,014 familje debitore në vlerën 187,880 mijë lekë për taksën e ndërtesës; -15,517 familje debitore në vlerën 7,203 mijë lekë për taksën e truallit; -14,683 familje debitore në vlerën 256,764 mijë lekë për tarifën e pastrimit; -14,290 familje debitore në vlerën 82,484 mijë lekë, për tarifën e ndriçimit; -7368 familje debitore në vlerën 31,835 mijë lekë, për tarifën e gjelbërimit; Gjithësej familje të taksuara sipas DAV janë 42,439 familje, ndërkohë rezultojnë 14,730 familje të cilat nuk taksohen/tarifohen, ku vetëm nëse do të bënim llogaritjet vetëm për tarifën e pastrimit, sipas nivelit të aplikuar në NJA, rezultojnë 39,966,900 lekë të cilat ndikojnë në reduktimin e të ardhurave nga mospërfshirja e numrit të plotë të familjeve. Për familjet të cilat nuk janë të taksuara dhe tarifuara, DAV Bashkia Shkodër nuk ka ndërmarrë veprime ligjore për identifikimin dhe faturimin e tyre, ku mos taksimi çon në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër. -Sipas informacionit të pasqyruar në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit, llogaritë bankare të Agjentit tatimor Ujësjellës Kanalizime SHA kanë qenë të bllokuara nga shoqëri përmbarimore në bankat e nivelit të dytë, dhe si pasojë detyrimi që Ujësjellës Kanalizime SHA ka ndaj Bashkisë Shkodër nuk është transferuar në llogari të saj duke sjellë mosrealizim të ardhurash sipas planifikimit për vitin 2021 me një diferencë prej -50,466 mijë lekë, ose ndryshe -6% më pak të ardhura. Kjo vlerë ka ndikuar gjithashtu edhe në mosrealizimin e zërave kryesorë të të ardhurave si: taksa e ndërtesës, e truallit, tarifa e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit etj. Nga DAV Shkodër për këtë situatë nuk janë marrë masat ligjore (aplikimin e gjobave) ndaj agjentit tatimor UK SHA Shkodër, i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë ñFamiljarò.	29-72	E Lartë	**<u>Rekomandimi:</u>** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë ñFamiljeò, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit për vitin 2021, rezultojnë 39,966,900 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër. **<u>Rekomandimi:</u>** Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore nga abonentët familjarë, si rrjedhojë e bllokimit të llogarive bankare të UK ShA., Shkodër (në rolin e agjentit tatimor), vlerësimin e detyrimit që ka UK ShA Shkodër ndaj Bashkisë Shkodër si dhe aplikimin e penaliteteve ndaj UK Sha Shkodër. **<u>Rekomandimi:</u>** Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 566,030 mijë lekë, me qëllim eleminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë. **Menjëherë**
3	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekura për planifikimin dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se vlera debitore gjithësej për këtë taksë, progresivisht deri në vitin 2021 është 26,299,610 lekë (nga të cilat 6,306,764 lekë lekë krijuar brenda vitit 2021), vlerë e cila	29-72	E Lartë	**<u>Rekomandimi</u>**: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP, të marrë masa për evidentimin e të

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodër. -Gjithashtu konstatohet se nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithësej tokë bujqësore në Bashkinë Shkodër dhe Njësitë Administrative janë 16091 Ha, sipërfaqe e cila shërben si bazë për planifikimin e arkëtimeve nga kjo taksë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se taksa e tokës bujqësore është planifikuar në vlerën 21,736,000 lekë, ndërkohë sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit, bazuar në kategorinë e bonitetit dhe sipërfaqe tokë bujqësore, rezulton se taksa e tokës bujqësore e cila duhet të përllogaritet nga Bashkia Shkodër është 25,372,760 lekë pra *3,636,760 lekë planifikuar më pak nga DAV Bashkia Shkodër, vlerë e cila ndikon në reduktimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore.* Sipërfaqja e mësipërme e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore.			gjithë familjeve me tokë bujqësore sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë, duke evidentuar familjet me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër. **Rekomandimi**: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet që kanë tokë bujqësore, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës 26,299,610 lekë. **Menjëherë**
4	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve rezulton se përgjatë vitit 2021 në territorin e Bashkisë Shkodër dhe NJA, është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 45 stacione shitje. -Nga numri i stacioneve të mësipërme u konstatua se në 28 prej tyre është ushtruar aktivitet pa u pajisur me licencën përkatëse. Për këto stacione konstatohet se përgjatë vitit 2021 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e subjekteve për detyrimin e pajisjes me licencë për ushtrimin e aktivitetit, njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë. -Gjithashtu nga këto stacione shitje të karburantit u konstatua se për 20 prej tyre nuk është kryer pagesa e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të *ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodërnë vlerën 13,871,692 lekë.*	29-72	E Lartë	**Rekomandimi:**Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt të drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët ndërmjet Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë. **Rekomandimi:**Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Shkodër të zbatojë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, për arkëtimin e detyrimeve ndaj subjekteve të cilat kanë pasur licencë të ushtrimit të aktivitetit, por nuk kanë paguar tarifën përkatëse, në vlerën 13,871,692 lekë në total. **Menjëherë**
5	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likujdimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Shkodër për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 2,285,200 lekë, për 3 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy	29-72	E Lartë	**Rekomandimi:**Kryetari i Bashkisë Shkodër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	persona. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për likujdimin e subjektit Gjovalin Stolaj, në urdhrin nr.628, datë 01.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna të subjektit Gj.S, moslikujdimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbarimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Shkodër. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.			largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet. **Menjëherë dhe në vijimësi**
6	**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të ndjekurapër arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2021 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër në vlerën 256,014,573 lekë, nga të cilat: -Gjobat e IMTV të paarkëtuara janë gjithësej 254,345,500 lekë (36 gjoba në vlerën 173,468,000 lekë i përkasin vitit 2021); -Gjobat e Policisë Bashkiake të paarkëtuara janë gjithësej 1,669,073 lekë, nga të cilat në vitin 2021 janë pa u arkëtuar 1405 gjoba në vlerën 1,650,022 lekë; Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse[2]. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga IMTV Shkodër, rezulton se për gjobat e mësipërme është bërë kërkesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë (GJSHP) Shkodër për lëshimin e urdhrit për ekzekutimin e tyre nëpërmjet përmbarimit. Në vijim nga IMTV Shkodër i janë përcjellë vendimet e GJSHP Shkodër zyrave të përmbarimit për ekzekutimin dhe arkëtimin e gjobave të vendosura, por në vazhdim nuk administrohet informacion se cilat janë masat e marra nga zyrat e përmbarimit, si sekuestrimin e pasurive të luajtshme/paluajtshme për likujdimin e gjobës, të cilat në gjykimin e grupit të auditimit vonojnë procesin e arkëtimit të gjobave dhe reduktojnë investimet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.	29-72	E Lartë	**<u>Rekomandimi:</u>**Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve të mësipërm, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 256,014,573 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura. **<u>Rekomandimi:</u>**Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Kryeinspektori i IMTV Shkodër, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proçes shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/paluajtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamat-vonesa) të palëve të treta ndaj Bashkisë Shkodër. Për çdo rast, kur nga përmbaruesit nuk merren të gjitha masat e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, Bashkia Shkodër të drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që nga kjo e fundit të aplikohen penalitetet ndaj përmbaruesve. **Menjëherë dhe në vijimësi**
7	**Gjetje nga auditimi:**Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se për vitin	29-72	E Lartë	**<u>Rekomandimi:</u>**Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa

[2] Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 ñPër organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunësò, i ndryshuar, ñPër shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmujor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative"; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, si dhe Kreun IV.3.8 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër.

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	2021 në 28 raste në vlerën totale 96,852,384 lekë, faturat tatimore janë paraqitur në degën e thesarit jashtë afatit 30 ditor. -Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se në fillim të vitit 2021 vlera e faturave të palikuiduara (celja e llogaria 401-408 dhe celja e llogarisë 467) ka qenë 149,042,632 lekë dhe fund të vitit 2021 vlera e faturave të palikuiduara (teprica kreditore e llogarisë 401-408 dhe llogarisë 467) është 209,368,206 lekë, ose 60,325,574 lekë më tepër në krahasim me fillim-vitin 2021. -Nga auditimi i pasqyrave financiare, konkretisht llogarive të detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të Bashkisë Shkodër ndaj palëve të treta, konstatohet se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021 sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit është në vlerën 248,490,839 lekë të shpenzimeve të institucionit, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura raportuar në MFE është 3,376,220 lekë, e cila tregon se Drejtoria e Financës raporton në MFE një vlerë të detyrimeve të prapambetura prej 245,114,619 lekë më pak se vlera e tyre e pasqyruar në raportimin e vetëvlerësimit financiar. -Gjithashtu sa i përket likujdimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, u konstatua se në 5 raste nuk është respektuar rradha e likujdimit të tyre, pra detyrimi i parë në radhën kohore nuk është likujduar i pari.			për likujdimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës. -Planifikimin e grafikut të likujdimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. **Rekomandimi:**Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, duke kryer sistemimet e nevojshme në llogarinë 4864. **Menjëherë dhe në vijimësi**
8	**Gjetje nga auditimi:**Nga auditimi i llogarisë nr. 468 ñDebitorë të ndryshëmò të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Shkodër për arkëtim ndaj të tretëve, është kontabilizuar më pak, për vlerën 223,179,324 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, si vijon: -13,438,000 lekë kamatëvonesa për detyrimet ndaj biznesit dhe institucioneve; -222,324,563 lekë debitorë kategoria familjar për taksa dhe tarifa vendore krijuar brenda vitit 2021; -Gjoba të vendosura nga IMTV mbivlerësuar për vlerën 4,432,962 lekë, më tepër për 8,294,277 lekë kamatëvonesa, si dhe më tepër për 144,000 lekë për likuidime brenda vitit.	72-87	E Lartë	**Rekomandimi:**Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme, që kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 ñDebitorë të ndryshëmò me kundërparti llogarinë nr. 470 ñTë ardhura për tôu marrëò. **Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022**
9	**Gjetje nga auditimi:**Nga auditimi i llogarisë nr.683 ñShuma tª parashikuara tª shfrytëzimitò të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, është kontabilizuar më pak, për vlerën 79,382,461 lekë.	72-87	E Lartë	**Rekomandimi:**Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në llogarinë nr. 683 ñShuma të parashikuara të shfrytëzimitò duke e debituar atë në momentin e njohjes dhe krediturar llogarinë nr. 150 ñShuma tª parashikuara pªr rreziqe e shpenzime. **Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022**
10	**Gjetje nga auditimi:**Nga auditimi i llogarisë nr.213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se	72-87	E Mesme	**Rekomandimi:**Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e

Gjetja	Përmbledhje e Gjetjes	Faqe nr.	Rëndësia	Rekomandimi
	për shtesat në aktive të bëra gjatë vitit 2021, nuk është përllogaritur amortizimi për pjesën e mbetur nga data e marrjes në dorëzim të investimit deri në fund të vitit 2021. Përllogaritur për 362 objekte të vitit 2021 (likujdimi i fundit + 30 ditë shtesë deri në kolaudimin e objektit, si dhe pjesën e mbetur të vitit 2021) në vlerën 9,614,406 lekë.			plotë dhe të saktë të llogarisë nr.213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò, për vlerën 9,614,406 lekë. **Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022**
11	**Gjetje nga auditimi:**Nga auditimi i kontratave për investime me afat financimi 2021-2023, miratuar me VKB nr.63, datë 28.12.2020, financuar nga të ardhurat e veta, konstatohet se përgjatë vitit 2021 nga Bashkia Shkodër në 8 raste, janë lidhur kontrata në vlerën 76,659 mijë lekë pa pasur në dispozicion minimalisht 20% të vlerës së kontratës për vitin e parë të financimit.	29-72		**Rekomandimi:**Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (jo më pak se 20% për kontratat shumëvjeçare) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse. **Në vijimësi**

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit.

Opinioni mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Shkodër për vitin ushtrimor 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200[3], pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, **shprehim një opinion të modifikuar[4]** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Shkodër, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2021, të cilat janë të shprehura në bazën për opinionin e modifikuar.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Shkodër, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e

[3] Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

[4] Audituesi duhet të modifikojë opinionin në rastet kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.

përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISSAI 1700.7).

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se disa llogari në pasqyrat financiare nuk paraqesin saktë vlerën e tyre reale, si dhe nivelin e materialitetit, i cili ka vlerën 55,659 mijë lekë[5].Për këto arsye kemi dhënë opinion të modifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

-Llogaria nr. 468 ñDebitorë të ndryshëmòështë kontabilizuar më pak për vlerën 223,179,324 lekë;

-Llogaria nr. 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò është kontabilizuar më shumë për vlerën 2,064,307 lekë;

-Llogaria nr. 683 ñShuma ty parashikuara ty shfrytëzimitò është kontabilizuar më pak për vlerën 79,382,461 lekë;

-Llogaria nr.213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreòështë kontabilizuar më shumëpër vlerën 9,614,406 lekë;

-Llogaria nr.202 ñStudime dhe kërkimeòështë kontabilizuar më shumëpër vlerën 17,677,741 lekë.

<u>Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Shkodër</u>.

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Shkodër, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

<u>Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.</u>

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Këto standarde kërkojnë që ne tôi përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë

[5]Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450. Materialiteti i llogaritur për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 është 55,659 mijë lekë. Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, u evidentuan gabime materiale të cilat individualisht dhe ose së bashku, janë mbi nivelin e materialitetit prej 55,659 mijë lekë të përcaktuar për vitin financiar 2021, por nuk janë të përhapura në llogaritë vjetore të subjektit, fakt ky që përbën bazën e opinionit e modifikuar (ISSAI 1700.7).

të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 373/1 Prot., datë 08.04.2022, ndryshuar me shkresën nr.373/2 prot., datë 04.05.2022, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Shkodër nga data 08.04.2022 deri në datën 13.05.2022, u krye ñ*Auditimi Financiar*ò, i cili mbuloi periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, nga grupi i auditimit:
1.K.K, Auditues, Përgjegjës Grupi.
2.A.G, Auditues, Anëtar.

II.1. Objektivi i auditimit.

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

II.2. Qëllimi i auditimit.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.
Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

II.3.Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Shkodër, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.
Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.
Fushat të cilat u audituan janë si vijon:
1.Aktiviteti i Njësisë së Auditit të Brendshëm;
2.Implementimi dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
3.Planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit;
4.Raportimi financiar.

II.4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Niveli drejtues i Bashkisë Shkodër (Kryetari i Bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Drejtori i Drejtorisë së Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontrolleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

II.5.Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njësisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Identifikon dhe vlerëson risqet e keq-pasqyrimit material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, bazuar në të kuptuarit e entitetit dhe mjedisit të tij, përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë. Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keqraportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërputhshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

II.6.Kriteret e vlerësimit.

Standardet dhe kuadri ligjor që shërbeu si kriter për vlerësimin e aktivitetit të subjektit të audituar, është si më poshtë vijon:

Lloji i dokumentit:	**Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore**
Standarde auditimi dhe kuadri ligjor i KLSH:	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 200; 400 etj; Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA); Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI ñPër implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimitò; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Manuali i Auditimit Financiar, KLSH me ndryshime;
Ligje mbi të cilat mbështetet subjekti në aktivitetin e tij:	Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; Ligji nr. 139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm publikò; Ligji nr. 25/2018 ñPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuarò; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò, i ndryshuar; Ligj nr.9385, datë 4.5.2005 ñPër pyjet dhe shërbimin pyjorò, i ndryshuar.
VKM:	VKM nr. 807, datë 16.11.2016 ñPër disiplinimin e angazhimeve buxhetoreò, i ndryshuar;

	VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò i ndryshuar; VKM nr.391, datë 21.06.2006 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò, e ndryshuar; VKM nr.83, datë 03.02.2016 ñPër Miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publikò.
Akte të tjera nënligjore:	Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar; Udhëzimi MF nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde te monitorimit te buxhetit te Njësive të vetëqeverisjes vendoreò; Udhëzimi MF nr.10/1,datë 28.02.2017 ñPër përgatitjen e buxhetit vendorò, etj; Udhëzimet vjetore të MFE për zbatimin e buxhetit; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 28, datë 15.12.2011 ñMbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësite publikeò; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò; Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik miratuar me urdhrin e Ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017.
Akte normative të Bashkisë Shkodër:	VKB për miratimin e rregullores mbi organizimin e funksionimin e Bashkisë Shkodër, etj; VKB për miratimin e rregullores së Këshillit të Bashkisë Shkodër; VKB për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021.

II.7.Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara, si rrjedhojë edhe Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 100, 200, Manualit të Auditimit të Financiar, Rregullores së Procedurave të Auditimit, dhe sigurohet se auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara.

II.8.Metodat e auditimit.

1. Kontrolli aritmetik.
2. Kontrolli i vlerësimeve.
3. Konfirmimi nga të tretët.
4. Kontrolli sipas një treguesi.
5. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe MFK.

II.9.Dokumentimi i auditimit.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve 5 gjithsej, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar u përgatit Projekt Raporti i Auditimit, i cili shërbeu për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

- **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.
Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.
Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.
Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.
Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.
Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.
Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

- **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.
Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III.PËSHKRIMI AUDITIMIT

III.1.Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Bashkia është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Zona Gjeografike: Bashkia e Shkodrësshtrihet në Veriperëndim të Shqipërisë, në një territor prej 873 km², dhe kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë.
Bashkia e Shkodrës është pjesë e Qarkut Shkodër dhe përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (Shkodër, Rrethina Shalë, Shosh Pult, Postribë, Guri i Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, dhe Velipojë). Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej një qytet dhe 93 fshatra.

Bashkia	NJA	Qytete dhe fshatra përbërëse
Shkodër	Shkodër	5 Lagje
	Ana e Malit	10 fshatra
	Bërdicë	6 fshatra
	Dajç	11 fshatra
	Guri i Zi	11 fshatra
	Postribë	11 fshatra
	Pult	7 fshatra
	Rrehtinat	10 fshatra
	Shalë	11 fshatra
	Shosh	5 fshatra
	Velipojë	10 fshatra

Organizimi i Bashkisë Shkodër[6]
Bashkia Shkodërka nën varësi njësitë shpenzuese:
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve;
Drejtoria Ekonomike e Arsimit;
Drejtoria Ekonomike e Kulturës;
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;
Teatri Migjeni;
Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore;
Sport Klub Vllaznia.

Administratae BashkisëShkodër dhe Njësitë Shpenzuese në varësi të saj, përbëhen nga
-Këshilli Bashkiak (2punonjës), Sekretari i Këshillit (1), Punonjës Sekretarie (1);
-Kryetari (1), Zv. Kryetari (4), 15 Drejtori (15), 27 Sektorë (129), 6 Njësi me funksione të ndryshme, Njësia e prokurimit, auditimit të brendshëm, etj., (107), 10 Njësi Administrative (10);Policia Bashkiake (1 Kryeinspektor), Inspektor (1), Policë (22), Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (1 Kryeinspektor), Specialist (3), Inspektor (4), Ndihmës Inspektor (4), Gjendja Civile (11 Përgjegjës) dhe Punonjës/Specialist (9), Qendra Kombëtare e Biznesit (2 Specialist), Punonjës me kontratë që financohen nga donatorët (4 specialist), Punonjës të shërbimit publik (30);
Njësitë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Shkodër:
Drejtoria e Çerdheve dhe Kopshteve ï 239 punonjës;
Drejtoria Ekonomike e Arsimit ï 249 punonjës;
Drejtoria Ekonomike e Kulturës ï 31 punonjës;
Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit ï 36 punonjës;
Teatri Migjeni ï 41 punonjës;
Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore dhe Pyjore ï 34 punonjës;
Sport Klub Vllaznia ï 21 punonjës.

Funksionet kryesore të Bashkisë Shkodër kryhen në fushën e:
Infrastrukturës dhe shërbimeve publike.
Shërbimeve sociale.
Kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese.
Mbrojtjes së mjedisit.
Bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike.
Zhvillimit ekonomik vendor.
Sigurisë publike.

Financat.
Gjithashtu Bashkia Shkodër ka të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:
a)krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;
b)vendos taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
c)harton, miraton dhe zbaton buxhetin e tyre;
ç)mban llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofron informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.

[6] VKB nr.63, datë 28.12.2020.

-Për vitin 2021 nga Bashkia Shkodër janë shpenzuar gjithësej 2,767,515 mijë lekë, nga të cilat:
450,503 mijë lekë për investime, nga të cilat 333,379 mijë lekë janë mbuluar nga të ardhurat e veta;
566,893 mijë lekë për paga;
93,983 mijë lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore;
522,729 mijë lekë për mallra të ndryshëm;
164,479 mijë lekë për transferime në institucione të varësisë;
964,928 mijë lekë për transferta në ndihmë ekonomike për familje në nevojë, invalidë etj.

-Për vitin 2021 Bashkia Shkodër nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithësej 738,309 mijë lekë.

III.2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

III.2.1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe Auditi i Brendshëm.
Në zbatim të nënpikës 1.1 të programit të auditimit:ñIdentifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publikeò,u auditua dokumentacioni si më poshtë:
1. Rregullorja e brendshme e miratuar;
2. Kod i brendshëm etik ose një kod sjellje, apo udhëzim për zbatimin e etikës;
3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;
4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar;
5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave.

Drejtimet kryesore të auditimit të MFK-së janë:
- Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.
- Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi/ Komunikimi, si dhe Monitorimi.
- Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike që mbulon.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Shkodër, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: *"Mjedisi i Kontrollit", "Menaxhimi i Riskut", "Aktivitetet e Kontrollit", "Informimi dhe Komunikimi"* si dhe *"Monitorimi",* sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ñ*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*ò i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri

tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, proçedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti "Mjedisi i Kontrollit":

Në lidhje me parimin 1 *"Angazhimin për integritet dhe vlerat etike".*

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

- Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.
- Për vitin 2021 ka qenë në fuqi Rregullore e Brendshme miratuar me Vendimin nr.96, datë 20.03.2017, e cila është ndryshuar me Vendimin nr.341, datë 09.07.2021. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me ndryshimet në rregullore.
- Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar proçedura e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, si dhe janë përcaktuar detyrat për njësinë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, procedura të mirëfillta për trajtimin e rasteve të tilla. Ndërsa për ndëshkimin e rasteve ndiqen proçedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjislacionin për shërbimin civil dhe kodin e punës. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.
- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (në zyrën e integruar me një ndalesë), duke iû adresuar strukturave të Bashkisë sipas problemeve, të cilat do të trajtojnë ankesat dhe kërkesat dhe përgjigjet do të firmosen nga Drejtorët sipas fushës përkatëse që ka shqyrtuar problematikën. Kjo proçedurë është përcaktuar në nenin 15 të Rregullores së Brendshme.
- Ka proçes vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrëdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip një herë në 6 muaj. Po ashtu ka vlerësime vjetore dhe për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kod Pune.

Në lidhje me parimin 2 ñTitullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrjeò.

- Për vitin 2021 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit, nuk administrohen raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.
- Për vitin 2021, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë hartuar çdo 4 - muaj, si dhe ka raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analizat faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.
- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka një plan menaxhimi për veprime korrigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Ndërsa nga shoqëritë e përbashkëta, ku bashkia është aksionere dhe nga ndërmarrjet në varësi të saj, Bashkia merr raportime ne lidhje me vendim-marrjen e këshillit drejtues, por mungojnë raportimet periodike për përformancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt argumentimi subvencioni.

- Titullari merr opinione për përformancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.
- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 ñTitullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitëò. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se rregullorja e brendshme të bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta/të plota/mbivendosje, konkretisht:

Pika 34.26 për detyrat e sektorit të menaxhimit të aseteve;

Pika 34.31 për detyrat e drejtorit të drejtorisë juridike, nuk përcaktohet si detyrë, dhënia e propozimeve për ndryshimin/përditësimin e akteve administrative që lidhen me aktivitetin e bashkisë, dhënien e konsulencës ligjore;

Pika 34.32, shkronja ñeò dhe ñfò mbivendosje të detyrave sipas përcaktimit të bërë në pikën 34.33, shkronja ñaò dhe ñbò;

Pika 35.6, shkronja ñqò është detyrë e arkivistit dhe jo drejtorit të drejtorisë mirëmbajtja e arkivit;

Pika 35.6, shkronja ñtò mbivendosje të detyrave sipas përcaktimit të bërë në pikën 35.8, shkronja ñfò, paragrafi i parë, pika 35.6 shkronja ñuò me përcaktimin e bërë në shkronjën ñjò në pikën 35.8;

Pika 35.8, shkronja ñbò mbivendosje të detyrave sipas përcaktimit të bërë në pikën 35.9, shkronja ñaò;

Pika 35.9, shkronja ñeò- *asistencë ligjore në çështje të ndryshme të drejtorisë*, kjo është detyrë e drejtorisë dhe sektorit juridik. Po kështu edhe përcaktimi i bërë në pikën 35.10, shkronja ñcò;

Pika 37.8, shkronja ñbò mbivendosje me pikën 37.9, shkronja ñbò;

Pika 37.9, shkronja ñdò është detyrë e një niveli drejtues dhe jo zbatues;

Nuk ka një ndarje proporcionale të detyrave ndërmjet përgjegjësit të sektorit të kontabilitetit me përgjegjësin e sektorit të financës. Disa prej detyrave të dy sektorëve janë të njëjta dhe nuk ndryshojnë në thelb nga njëra-tjetra, përshembull: Përgjegjësi i sektorit të financës - përgatitë të gjithë dokumentacionin për shpenzimet që kryen institucioni dhe mban përgjegjësi për to, përpilon urdhër-pagesën me të gjitha ekstremet përkatëse pasi ka kontrolluar më parë dokumentacionin shoqërues që kërkon ligji ï Përgjegjësi i sektorit të kontabilitetit - në bazë të numrit të punonjësve dhe të strukturës së pagave të miratuara nga këshilli bashkiak dhe të prezencës mujore të punonjësve (informacion që ofrohet nga Drejtoria e organizmit, personelit) bën hartimin e listë pagesave të punonjësve të institucionit[7] për çdo muaj duke bërë ndalesat për sigurimet shoqërore dhe tatimet sipas legjislacionit në fuqi; përpilon listë pagesën për shërbimet brenda vendit dhe jashtë vendit; përpilon liste pagesën për orët jashtë kohës normale të punës sipas ligjeve në fuqi;

-Detyra e përcaktuar në pikën 37.11, shkronja ñqò, është detyrë më tepër për drejtorinë e burimeve njerëzore;

-Mbivendosje të detyrës sipas përcaktimit të bërë në shkronjën ñgò pika 34.2 me përcaktimin e bërë në shkronjën ñbò të pikës 38.7;

-Në pikën 41.15 parashikohen funksione si: Kontrolli dhe monitorimi i shërbimeve veterinare dhe situatës epizotike në territorin e Bashkisë Shkodër. Kryeja e kontrollit sanitaro-veterinar të kafshëve para, gjatë dhe pas therjes si edhe çertifikimin veterinar në përputhje me kërkesat e parashtruara në ligj në ambientet e therjes së kafshëve ï Këto detyra sipas Ligjit nr. 9863,

[7] Në thelb është pjesë e dokumentacionit për shpenzime të institucionit.

datë 28.1.2008 ñPër ushqiminò, i ndryshuar dhe Ligjit Nr.10465, datë 29.9.2011 ñPër shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, i përkasin Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe Drejtorive Rajonale të tij, si dhe shërbimit veterinar zyrtar. Gjithashtu AKU në ushtrimin e kompetencave të veta kontrollon edhe punën e veterinerëve zyrtar në certifikimin e mishit.

-Në pikën 37.9 parashikohet në strukturën e IMTV funksioni ñNdihmës inspektorò, ndërkohë nuk përcaktohen detyrat për këtë pozicion pune.

-Parashikohet pozicioni dhe funksioni i Inspektorit Pyjor Bashkiak, duke i dhënë të drejtën e marrjes së masave administrative, ndërkohë që sipas përcaktimit të bërë në nenin 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 ñPër pyjet dhe shërbimin pyjorò, i ndryshuar (në fuqi për periudhën kur është përgatitur rregullorja e brendshme), shërbimi pyjor ndahet në funksione menaxhuese dhe kontrolluese, si dhe funksioni i kontrollit dhe marrjes së masave administrative ushtrohet nga policia pyjore, pjesë e inspektoratit përgjegjës për pyjet; Gjithashtu që të përligjet pozicioni i mësipërm duhet të reflektohet në strukturën e Drejtorisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave, mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 40 në Ligjin nr.57/2020 ñPër Pyjetò.

-Lidhur me strukturën organizative të Bashkisë Shkodër, ndërmarrjes dhe institucioneve në varësi, përgjatë vitit 2021 nuk ka pasur ndryshime.

-Për çdo drejtori janë përcaktuar objekti, qëllimi, detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist.

-Mungon raporti i vlerësimit nga njësia e auditit të brendshëm për përputhjen e rregullores me strukturën organike.

Në lidhje me parimin 4 ñNjësia publike demonstron angazhimin në realizimin e kompetencaveò.

- NëBashkinëShkodërnukështëhartuarñHartaeproçesittëMenaxhimittëBurimeve Njerëzoreò.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme, por vetëm nga trajnimet e zhvilluara nga ASPA.

- Për Bashkinë Nëpunësi Autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxheri i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor.

- Nëpunësi Zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin, të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Financës.

Në lidhje me parimin 5 ñNjësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxherialeò.

-Në Rregulloren e Brendshme është parashikuar ñDelegimi i kompetencaveò në zbatim të ligjit 44/2015 ñKodi i Proçedurave Administrativeò si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokolli i institucionit rezulton se, nga NA për periudhën objekt auditimi ka patur 3 raste të delegimit të detyrave, konkretisht me vendimin nr.03 datë 06/01/2021, vendim nr.5, vendimin nr.6, vendimin nr.7, datë 07.01.2021, për nënshkrimin e disa korrespondencave shkresore.

- *Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS).*

Në zbatim të nenit nr. 24 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetorò, i ndryshuar; ligji nr. 139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, i ndryshuar; ligji nr. 68/2017 datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, i ndryshuar dhe Udhëzimin e MFE nr.23, datë 30.07.2018 ñPër proçedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendoreò, është ngritur GMS, Ekipet e menaxhimit të programeve buxhetore. Lidhur me përbërjen e GMS, ajo është sipas përcaktimit të bërë në pikën 30 të Udhëzimit

nr.23, datë 30.07.2018 ñPër proçedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendoreò.
Nga verifikimi i veprimtarisë së Grupi të Menaxhimit Strategjik (GMS) rezultoi se:
- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

II. Komponenti "Menaxhimi i Riskut".

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me realizimin e tyre.
-Nga Bashkia Shkodër përcaktohen objektiva sasior. Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton se nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik të zhvillimit (afat 5 vjeçar), sipas përcaktimit të bërë në nenin 32 të Ligjit nr.68/2017 ñPër financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò.
Në lidhje me parimin 7: ñNjësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivaveò.
-Janë krijuar mekanizmat për vlerësimin e riskut.
-Është krijuar rregjistri i riskut, ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut, por nuk është krijuar strategjia e menaxhimit të riskut. Mbetet problematike menaxhimi i riskut, pasi nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e proceseve të punës të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eleminimin e plotë të tij.
-Rregjistri i riskut nuk përditësohet rregullisht (2 herë në vit), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK- së dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeò.
-Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuara.
-Nuk dokumentohen takimet periodike (1 herë në dy muaj) të Koordinatorit të Riskut me drejtorët e drejtorive përkatëse të institucionit.
-Bashkia Shkodër ka disa sisteme informacioni të integruar dhe implementuar si:
1. Sistemi i Integruar i Zyrës me një ndalesë;
2. Sistemi i Integruar i Taksave dhe Tarifave Vendore;
3. Sistemi i Integruar i Shërbimeve Sociale;
4. Sistemi i monitorimit të mbetjeve;
5. Programi Financa 5, është instaluar, por mbetet përshtatje sipas specifikimeve teknike, kjo në përputhje me kushtet e kontratës së mirëmbajtjes;
6.Programi i kontabiliteti Alpha i cili përdoret vetëm për veprimet e magazinës, i vjetër i instaluar që në vitin 2004 dhe që ka nevojë të bëhet update dhe back up të të gjitha të dhënave.
Në lidhje me parimin 8: ñNjësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrimeò.
-Ky institucion ka caktuar koordinatorin e riskut për vlerësimin e riskut të mashtrimit, ka miratuar rregulloren për parandalimin e konfliktit të interesit, por nuk ka caktuar një bilbilfryrës. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë.
Në lidhje me parimin 9: ñNjësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëmò.
Problematikë e evidentuar në lidhje me këtë parim është mungesa e rregullave të shkruara në lidhje me procedurën që ndiqet për lëvizjet e stafit dhe mungesa e pasqyrimit të këtyre ndryshimeve si risqe në regjistrin e riskut të institucionit. Ndryshimet e shpeshta të drejtuesve të njësive publike kanë shfaqur luhatje të vazhdueshme të kulturës dhe qëndrimeve filozofike përsa i përket menaxhimit të ndryshimeve dhe zhvillimit të sistemeve të kontrollit të

brendshëm. Ndryshimet strukturore apo menaxheriale duhet të ndiqen nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

III. Komponenti: " Aktivitetet e Kontrollit"

Në lidhje me parimin 10: "Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolliò.

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë, krahas detyrave, janë identifikuar pak a shumë edhe proçeset e punës. Ekzistojnë proçedura të brendshme për proçeset e punës, si proçedurat standarte te zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të proçedurave administrative, etj.
- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.
- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, hartimi dhe rregjistrimi i pagesës kryhet nga specialistët e Sektorit të Financës, ndërsa Autorizimi i pagesës nga NA.
- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të përllogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i marrjes në dorëzim të mallrave/punimeve/shërbimeve.
- Për çdo vit buxhetor hartohet rregjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhornohet sa herë ka ndryshime fondesh. Ekzistojnë dosjet e proçedurave të prokurimeve, ku gjurmën e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumenta autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.
- Në Rregulloren e Brendshme për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.
- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publikò i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur rregjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivet afatgjata dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet e këtyre aktiveve.
- Në përgjithësi për proçedurat e inventarizimit, vlerësimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AAGJM, ka gjurmë auditimi, pasi ekziston dokumentacioni i firmosur nga komisionet dhe punonjësit përkatës si: Urdhri i NA për ngritjet e komisionit të inventarizimit, vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimi si dhe për asgjesimin e tyre. Ekzistojnë fletët e inventarit, relacioni i vlerësimit për aktivet për nxjerrje jashtë përdorimi, proçesverbale dhe relacionet për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe proçesverbalet për asgjesimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimi. Janë prerë dokumentet bazë (fletë-daljet) dhe kryer veprimet kontabël përkatës.
-Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet Bankave të nivelit të dytë në llogarinë e Thesarit për Bashkinë Shkodër, kurse një pjesë e taksave dhe tarifave arkëtohen nëpërmjet agjentëve tatimorë sipas marrëveshjeve të lidhura ndërmjet palëve. Për këto të ardhura në përgjithësi janë bërë akt-rakordimet përkatëse periodike dhe vjetore dhe janë kontabilizuar.
-Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Degën e Thesarit, kryen kontrollin e disponibiliteteve monetare, kontrolli i angazhimeve, menaxhimi i investimeve sipas planit kontraktual të

pagesave dhe gjendjen limit të arkës, ku për cdo transaksion merret konfirmimi i Degës së Thesarit për gjendjen e disponilibiteteve, dhe bëhet çelja e fondeve me shkresë nga Bashkia.
Në lidhje me parimin 11: ñNjësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisëò.
- Në Bashkinë Shkodër zbatohen rekomandimet e politikave për sigurinë kibernetike në lidhje me ndryshimin e fjalëkalimeve, firewall-et, hyrje e kufizuar në të dhënat TI, etj.
Institucioni ka sistem rezervë (Back-up) si dhe plan-rikuperimi nga fatkeqësitë. Në përgjithësi, Bashkia Shkodër bazohet në rregullat e përgjithshme të përcaktuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe nuk ka procedura të brendshme specifike për këtë fushë.
-Në rregulloren e brendshme përcaktohen detyrat e specialistit të IT, i cili varet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.
-Në strukturën e Bashkisë janë 3 specialist IT.
Në lidhje me parimin 12: ñNjësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe proçeduraveò.
- Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.
- Ekzistojnë proçedura kontrolli të integritetit të të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrolle dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilizimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. PF konfirmohen nga NA dhe NZ. Këto procedura janë të përfshira në detyrat dhe përgjegjësitë në të gjitha nivelet e Drejtorisë Ekonomike.
- Nuk ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF. Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 ñPër hartimin e PFò, i ndryshuar). Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: "Informimi dhe Komunikimi"

Në lidhje me parimin 13: ñNjësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësorò.
BashkiaShkodërdisponondfaqenesajzyrtarenë web kupasqyrohetaktivitetiisaj si Rregullorja e Brendshme, broshura, planet e performancës, projekte të brendshme dhe të huaja, bashkëpunime brenda dhe jashtë vendit, aktivitete, struktura organike, vendimet e këshillit bashkiak, buxheti vjetor, publikime të ndryshme, si dhe shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.
Për vitin 2021 nga Bashkia Shkodër mbi vendimmarrjen e saj, janë kryer konsultime me publikun dhe palët e interesit.
Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm verbal dhe shkresor.
Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.
Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit.
Titullariinformohetngadrejtuesiteprogramevenëpërmjetmbledhjeve,raportevedherelacionevet ëndryshme.Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike përprobleme apoparregullsi,në rrugë shkresore/verbale/email.

V. Komponenti: "Monitorimi dhe Raportimi"

Në lidhje me parimin 16: ñNjësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshmeò.

- Proçedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, administrohen raportimet e drejtuesve të drejtorive përkatëse për përmbushjen e objektivave.
- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet periodikisht. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.
- Bashkia Shkodër lidhur me pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe deklaratën e cilësisë, ka raportuar në MFE.

Në lidhje me parimin 17: ñNjësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitëò.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm.Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eleminimin e tyre.

Titulli i gjetjes: Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mesatarisht, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mungojnë disa proçedura në lidhje me 5 komponentët si:

"Mjedisi i kontrollit"

-Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
-Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.
-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.
-Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.
-Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta/të plota/mbivendosje.

"Menaxhimi i Riskut"

-Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e të cilave të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eleminimin e plotë të tij.
-Rregjistri i riskut nuk përditësohet rregullisht (2 herë në vit).
-Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuara.
-Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues i drejtorive pranë Bashkisë Shkodër.
-Programi i kontabiliteti ñAlphaò i cili përdoret vetëm për veprimet e magazinës, është i vjetër duke moskryer plotësisht funksionet e sektorit të kontabilitetit, si dhe që ka nevojë të bëhet update dhe back up të të gjitha të dhënave.

"Aktivitetet e Kontrollit"

-Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

"Monitorimi"

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore nuk lidhet me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit.

-Në Bashkinë Shkodër mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeò; Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 18-26, të Raportit të Auditimit)*

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi Zj. V.D, ish Kryetare e Bashkisë Shkodër, Zj. B.D, Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Zj. A.P, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò i ndryshuar;

Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeò;

Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Risk i shtuar për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shkaku: Mungesa e zbatimit efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Rëndësia:E Mesme.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër, drejtorët e drejtorive, si dhe përgjegjësat e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Rekomandimi:Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investim në program kompjuterik të liçencuar për mbajtjen e kontabilitetit në Bashkinë Shkodër.

III.2.1.1. Mbi organizimin e njësisë së auditit të brendshëm dhe vlerësimin e veprimtarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të pikave 1.2 dhe 1.3 të programit të auditimit, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

1. Karta e Auditimit të Njësisë AB të Bashkisë Shkodër;
2. Plani Strategjik dhe vjetor, si dhe pasqyrat shoqëruese;
3. Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2021;
4. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmoizimit të Auditit të Brendshëm;
5. Dosjet e përhershme të subjekteve të audituara;
6. Rekrutimi i punonjësve në Njësinë e Auditit të Brendshëm, dhe ngritja e nivelit profesional të tyre.

Përshkrimi i situatës mbi krijimin dhe përbërjen e strukturës së njësisë së auditit të brendshëm.

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 ñPër miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publikò, është krijuar njësia e Auditit të Brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100, i Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm. Ky sektor përgjatë vitit 2021, është organizuar dhe ka funksionuar në zbatim të VKB nr.2, datë 08.01.2021, dhe ka pasur 3 punonjës përkatësisht, përgjegjësi dhe 2 specialist.
Përgjatë vitit 2021, drejtuesi i Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Shkodër, është z.P.Z.

Struktura e njësisë AB për vitin 2021

Nr	Periudha	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime te vijueshme
1	P.Z	Pergjegjes	I lartë, Niveli II	25	25	I certifikuar	
2	E.N	Specialiste	I lartë, Niveli II	22	18	I certifikuar	
3	B.B	Specialiste	I lartë, Niveli II	14	5	I certifikuar	

Burimi: NJAB Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Aktiviteti i NJAB për viti 2021.

Përgjatë vitit 2021, nga sektori i auditit të brendshëm, janë kryer gjithësej 8 auditime, ndarë si më poshtë vijon:
Viti 2021, plani vjetor i auditimeve i miratuar me shkresën nr.14784 prot., datë 20.10.2020, ndryshuar me shkresën nr.3835/8 prot., datë 19.10.2021, sipas të cilit janë planifikuar për tâ audituar 9 auditime, realizuar 4 dhe në proces 4, pasqyruar si më poshtë:

Nr	Planifikuar	Nr.	Subjekte të audituara ngs NJAB	Nr.	Realizimi i angazhimeve të auditimit					Të përfunduar	Në proces
					Përputh	Perf	Financ	IT	Kombin		
1	Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor	1	Drejtoria e Analizës dhe e Programimit Buxhetor	1	1					1	
2	Drejtoria e Financës	1	Detyrimet e prapambetura	1	1						1
3	Drejtoria e të Ardhurave	1	Shtëpia e Femijes 6-15 Vjeç	1					1		1
4	Drejtoria e Shërbimit Social dhe Strehimit	1	Drejtoria e Shërbimit Social dhe Strehimit	1					1		1
5	Drejtoria për ndihmën Ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuar	1	Drejtoria për ndihmën Ekonomike dhe personat me aftësi të kufizuar	1					1		1
6	NJA Shalë	1	NJA Shalë	1	1					1	
7	NJA Velipojë	1	NJA Velipojë	1	1					1	
8	NJA Guri i Zi	1	NJA Guri i Zi	1	1					1	
9	Njësia e Prokurimit	1									
		9	**Totali**	**8**	**5**	**0**		**0**	**3**	**4**	**4**

Burimi: NJAB Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Plani strategjik 2021-2023 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2021 është përcjellë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me shkresën nr.14784 prot., datë 20.10.2020. Për aktivitetin e vitit 2021 është raportuar pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me shkresën nr.2462 prot., datë 15.02.2022.
-Karta e auditimit të brendshëm është miratuar me urdhrin nr.1287 datë 13.12.2021.
Nga auditimi i raportimit për vitin 2021, rezulton se janë dhënë 95 rekomandime gjithsej, nga të cilat janë pranuar 81 prej tyre ose 85%. Nga rekomandimet e pranuara janë zbatuar 44 prej tyre ose 54%, në proces zbatimi 37 ose 46%.Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën më poshtë

Nr	Viti	Të dhëna sipas Raportimit				Sipas Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Pranuar	Zbatuar	Ne proces	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
1	2021	95	81	44	37	1	0	-	1
TOTALI		**95**	**81**	**44**	**37**	**1**	**0**	**0**	**1**

Titulli i Gjetjes: Mbi krijimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditit të Brendshëm Publik në Bashkinë Shkodër, përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2021.
Situata: Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 13 të Ligjit nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò;
- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;
- Nukjanë kryer auditime të teknologjisë së informacionit;
- Nukjanë kryer trajnime për stafin e NJAB Shkodër;
-Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim fusha të aktiviteteve që kryen Bashkia Shkodër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Mbrojtjes kundër Zjarrit, Qendra e Zhvillimit, Teatri ñMigjeniò, ku sipas përcaktimit të bërë në pikën 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm *"Për sisteme të cilat vlerësohen me risk të lartë, plani duhet të parashikojë auditimin e tyre me një frekuencë më të shpeshtë, një herë në vit", duhet* të auditohen cdo vit.
-Nuk është përcjellë në MFE ndryshimi mbi planin e auditimit të vitit 2021;
-Karta e auditimit të brendshëm nuk miratuar brenda afatit sipas Urdhrit nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë ñPër miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016ò, hyrë në fuqi në Shtator 2020;
-Raportimi mbi aktivitetin vjetor 2021 të sektorit të auditimit të brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, nuk është sipas strukturës së përcaktuar në shkronjën ñçò të nenit 14 në Ligjin nr. 114/2015, ñPër Auditin e Brendshëm Publikò, pasi nuk jepet informacion për veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar. Gjithashtu në raportin vjetor të aktivitetit, kreu IV.3 ñFushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyreònuk përmban plotësisht informacion sipas përcaktimit të bërë në formatin standard 5 ñStruktura e raportit vjetor të njësive të auditimit të brendshëmò në manualin e auditimit të brendshëm;
-Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, pormbahennëambientetebrendshmetëSektorittëAudititëBrendshëmnë kundërshtim me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 ñPër arkivatò;
Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar më sipër, llojin e mangësive të identifikuara si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi Zj. V.D, ish Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Z. P.Z, Përgjegjës i Sektorit të NJAB.
Kriteri: Shkronja ñçò në nenin 6, nenin 13, shkronja ñçò në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò;
-Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë ñPër miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016ò;
-Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar;
Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë si Financa, Taksat apo Prokurimet.
Shkaku: Mungesa e zbatimit të kuadrit rregullator të fushës.
Rëndësia: E Mesme
Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Shkodër, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisk të lart, si vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet

publike etj, në mënyrë që ti jap të japë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave.
Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Shkodër, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.
Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

III.2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", ligjet vjetore "Për buxhetin e shtetit" të vitit 2021, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.

- **Çështjet e audituara sipas pikës 2 të programit:**

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 2021;
2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;
2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit;
2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipasraportimitnë MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.);
2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

- **Dokumentacioni i audituar si më poshtë:**

1. Dokumentacioni i hartimit të PBA-ve për periudhën objekt auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministritë e Linjës;
2. Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
3. Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit për shpenzimet dhe të ardhurat;
4. Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
5. Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikuiduara dhe vendime gjyqësore;
6. Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimit të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
7. Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimine zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
8. Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin ñExcelò, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj.).

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se:
2.1.Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2021.
Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2021-2023, u konstatua se janë realizuar fazat epërgatitjes,dukefilluarqëngangritjaegrupittëpunës,Grupi i

MenaxhimitStrategjikmeurdhërtëTitullarit të institucionit, organizimin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e tavaneve tëshpenzimevesipas programeve.
Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultimeme komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet plotësimit të një ankete onlinë në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër.
Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar, u konstatua se për periudhën 2021-2023 PBA dhe buxhetet vjetore, që i korrespondojnë kësaj periudhe, janë miratuar me VKB nr.63, datë 28.12.2020,si dhe VKB përkatëse për miratimin e fondeve të trashëguara për çdo fillim viti buxhetor. Gjithashtu janë konfirmuar me shkresat e Prefektit të Qarkut Shkodër, shkresa nr.01/1 prot., datë 14.01.2021. Në vija të përgjithshme gjatë hartimit dhe miratimit të kërkesave buxhetore, janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tregjeve të reja, përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, reabilitimin dhe investimin e infrastrukturën bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, përmirësimin e sistemit të edukimit dhe trajnimit profesional, mbulimin e territorit me shërbime sociale sipas nevojave të komunitetit, zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.
Fusha me prioritet në shpenzimet për investime janë konsideruar:

a. *Infrastruktura rrugore;*
b. *Urbanistika;*
c. *Furnizimi me ujë të pijshëm;*
d. *Ujitja dhe Kullimi;*
e. *Shërbimi zjarrëfikës;*
f. *Konviktet.*

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr.23 datë 30.07.2018 ñ*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njësive të Qeverisjes Vendore*ò. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion *(kontratat në vazhdim),* angazhimet *(detyrimet e prapambetura sipas llojit)*, tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme *(kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme)*.
Programi i të ardhurave për vitet 2021-2023 është bërë mbi bazën e paketës fiskale të miratuar me VKB nr.25, datë 20.12.2019.
Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Buxheti total i Bashkisë Shkodër për vitin 2021 është 3,110,338 mijë lekë.
Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë, realizohet nga dy burime:
Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transferta e kushtëzuar.
Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitet 2021-2023, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr.1 PBA për periudhën 2021-2023sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Shkodër

Nr	Kodi	Emërtimi	PBA 2021 & të trashëguara	Buxheti Vjetor 2021 (Plani i rishikuar)	Diferenca
			1	2	1-2
1	1110	Planifikim Menaxhim Administrim	365,211,517	339,598,313	25,613,204
2	1170	Shërbimi i gjendjes Civile	15,818,000	15,764,800	53,200
3	1620	Zgjedhje të Përgjithshme dhe Lokale	-	10,095,000	(10,095,000)
4	3140	Shërbimet e Policise Vendore	30,695,862	26,363,397	4,332,465
5	3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	186,373,324	113,405,381	72,967,943
6	4130	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik	12,098,037	10,416,517	1,681,520
7	4160	Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	2,818,144	1,477,304	1,340,840
8	4220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	3,353,640	1,924,000	1,429,640
9	4240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes	42,840,792	39,339,816	3,500,976
10	4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	34,866,374	30,313,257	4,553,117
11	4520	Transporti rrugor/ Mirëmbajtje rruge rurale	535,387,668	559,870,353	(24,482,685)
12	4530	Menaxhimi i rrugëve	80,256	80,256	-
13	4570	Transporti publik	24,092,759	10,773,560	13,319,199
14	4760	Zhvillimi i Turizmit	10,486,274	6,260,000	4,226,274
15	4910	Fondi Rezerve	10,149,000	10,149,000	-
16	4940	Fondi i kontigjences	20,366,000	20,366,000	-
17	4960	Ndërmjet llogarive në qendër	-	235,081	(235,081)
18	4980	Shpenzime të tjera	27,510,329	-	27,510,329
19	5100	Menaxhimi i mbetjeve	291,318,364	290,953,704	364,660
20	5200	Menaxhimi i ujërave të zeza	15,000,000	15,000,000	-
21	5320	Mbrojtja e mjedisit	6,972,000	6,972,000	-
22	6140	Urbanistikë vendore	2,668,000	1,000,000	1,668,000
23	6190	Strehimi	5,522,031	54,341,775	(48,819,744)
24	6220	Menaxhim i Mbetjeve Urbane	-	-	-
25	6260	Shërbimet publike vendore	99,344,757	93,940,638	5,404,119
26	6330	Ujësjellës kanalizime vendore	27,903,756	27,464,756	439,000
27	6440	Ndricimi i rrugëve	114,445,122	112,394,960	2,050,122
28	7220	Shërbimet e kujdesit parësor	3,000,000	3,000,000	-
29	8130	Sport dhe argëtim	127,390,748	155,083,481	(27,692,733)
30	8140	Zhvillimi i Sportit	344,448	344,448	-
31	8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	125,373,338	101,408,651	23,964,687
32	8250	Programe specifike kulturore dhe të turizmit	292,444	292,444	-
33	9120	Arsimi parashkollor dhe 9-vjecar	356,141,313	343,236,399	12,904,914
34	9230	Arsimi parauniversitar (mesëm-përgjithshëm)	146,380,269	142,490,833	3,889,436
35	9240	Arsimi parauniversitar (mesëm-profesional)	32,090,360	33,201,830	(1,111,470)
36	10140	Shërbimet e kujdesit social	884,699	683,563	201,136
37	10430	Përkujdesi Social	1,094,609,743	1,074,569,373	20,040,370
38	10661	Strehimi social	46,877,072	34,483,193	12,393,879
39	10910	Emergjencat Civile	-	8,059,428	(8,059,428)
Totali i Shpenzimeve të Njësisë			**3,818,706,440**	**3,695,353,511**	**123,352,929**

Burimi: Drejtoria e Buxhetit, Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, mbi planifikimin buxhetor afatmesëm 2021-2023, pjesë e të cilit është edhe planifikimi për vitin buxhetor, si dhe krahasimi i tij me planin progresiv të vitit buxhetor, rezulton se diferenca ndërmjet planit fillestar dhe atij final është 123,352,929 lekë. Diferencë e konsiderueshme rezulton në programin ekonomik ñPlanifikim, menaxhim administrimò, për arsye tëfondeve të trashëguara nga viti i kaluar, të cilat kanë rritur planin e vitit 2021.

Pjesë e PBA dhe planifikimit të buxhetit vjetor, është edhe planifikimi i të ardhurave, si burim i integruar në programet buxhetore, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Kështu për

periudhën 2021-2023 Bashkia Shkodër ka planifikuar të arkëtojë të ardhura tatimore dhe jo tatimore, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.2 Planifikimi i të ardhurave

Përshkrimi	Plan 2021
Te ardhura tatimore	1,839,909
Te ardhura jotatimore	1,801,711
TOTAL	**3,641,621**

Burimi: Drejtoria e Buxhetit, Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.373/5 prot., datë 07.07.2022, konkretisht nga Drejtoria e Mjedisit, për sa më poshtë:

Pretendimi i Subjektit:

Per vitin 2021: Të gjitha të ardhurat e planifikuara në vitin 2021 (580/mije lekë) dhe jo vetëm por ka planifikuar një fond prej 7,950/ mije lekëpër Shpenzime për përmirësim të fondit pyjor kullosor (punime pastrimi dhe luftim sëmundjesh) si edhe në investime për realizimin e Planeve të Menaxhimit të Fondit Pyjor Kullosor për Ekonomi Pyjore, investim i realizuar, si e vetmja mënyrë për përdorimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe detyrim ligjor pika 7 ç neni 13i Ligjit nr. 57/2020 "*Për pyjet*" ku ñPlani i mbarështimitò është dokumenti bazë për mbarështimin e një ekonomie pyjore, që përmban analizën e gjendjes së pyjeve, përcakton objektivat që duhet të realizohen në funksion të statusit që kanë, si dhe planifikon masat për trajtimin e tyre dhe ndërhyrjet për vitet e ardhshme.

Tabela e aktiviteteve dhe realizimi i tyre nga pikëpamja financiare:

Aktiviteti	Buxheti Fillestar në mijë lekë	Buxheti i Rishikuar në mijë lekë	Realizimi i 12 Mujorit 2021 në mijë lekë
P04260.O1.A1 Administrimi i shërbimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkine Shkoder & te trasheguara	9,522	16,090	9,329
P04260.O1.A2.Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore /kullosore/shërbimi pyjor & të trashëguara	4,519	4,686	1,911
P04260.O2.A1 Mbledhje e informacionit / përgatitje materialesh për realizimin e rishikimit/hatimit të Planit të menaxhimit .	-	-	-
P04260.O2.A2 Përgatitje e materialeve për Realizimin e regjistrimit dhe inventarizimit të Pyjeve dhe kullotave bashkiake.	-	-	
P04260.O3.A1 . Investime për përmirësim të fondit pyjor/kullosor & të trashëguara	1,500	5,966	-
P04260.O3.A2 Shpenzime për përmirësim të fondit pyjor/kullosor.	2,000	2,000	1,837
P04260.O3.A3 Zbatimi i projektit për ndërtimin e lerës së ujit /kullota në NJA - Të Trashëguara	-	817	-
04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave	**16,541**	**29,559**	**13,077**
Të trashëguara	18,325	754	-
Totali	**34,866**	**30,313**	**13,077**

Aktivitetet P04260.O3.A1, P04260.O3.A3 janë Aktivitete të parashikuara/realizuara për Investime të Fondin pyjor/kullosor si aktiviteti P04260.O1.A2 (pjesërisht në shumën 1 167 mije lekë në zërin investime).

Sqarojmë se pas kërkesave të përsëritura, drejtuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me datën 03.03.2022 me Urdhër nr.92, Ministria e Turizmit ka miratuar planin e mbarështimit të ekonomisë pyjore Brucaj dhe kështu është bërë likuidimi i investimit të parashikuar ne Aktivitetin P04260.O3.A1 sipas tabelës se mësipërme në muajin Maj të vitit 2022 brenda afatit 30-ditor sipas faturës datë 27.04.2022.

Pra në vitin 2021 Bashkia ka planifikuar dhe realizuar investime bazuar në dispozitat ligjore dhe gjetja nr. 5 se nuk janë planifikuar fonde për investime nuk qëndron.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Për pretendimin e ngritur më sipër nga subjekti i audituar sqarojmë se:

Edhe në qëndrimin tonë të mbajtur për observacionet e pasqyruara për akt-konstatimin, pjesë e të cilit është edhe trajtimi i bërë më sipër, i jemi referuar tabelës E3-Projektet e investimit, tabelë e cila është bashkëlidhur dokumentit përfundimtar të PBA 2021-2023. Në këtë tabelë vlera e planifikuar për investim në fondin pyjor për vitin 2021 është 0 lekë. Megjithatë pas

shqyrtimit të të dhënave të pasqyruara nga ana juaj, merret në konsideratë pretendimi i ngritur.

2.2.Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të KB.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Shkodër dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën esituacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Shkodër ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Shkodër.

Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, në Bashkinë Shkodër rezultoi se:

Për vitin 2021, totali i shpenzimeve të planifikuara përbëhet nga:

Të ardhurat e trashëguara nga viti 2020 në vlerën 108,954 mijë lekë;

Transferta e pakushtëzuar 652,826 mijë lekë;

Transferta e kushtëzuar 1,073,772 mijë lekë

Transferta specifike në vlerën 397,366 mijë lekë;

Të ardhurat e planifikuara për tu mbledhur gjatë vitit në vlerën 877,420 mijë lekë;

Total për tu shpenzuar 3,111,308 mijë lekë.

-Për vitin 2021 me vendim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, buxheti ka pësuar **24 ndryshime**[8] buxhetore brenda të njëjtit program buxhetor, me efekt në shtesa/pakësim të fondeve për artikull ekonomik, si dhe me vendim të Këshillit të Bashkisë ka pësuar **1 ndryshim** ndërmjet programeve buxhetore, konkretisht:
-Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore të shpeshta përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

Tabela nr.4 Realizimi i buxhetit vjetor në nivel programi ekonomik

Nr.	Emërtimi	Buxheti Vjetor i rishikuar 2021	Realizimi	%
1110	Planifikim Menaxhim Administrim	339,598	236,527	70%
1170	Gjendja Civile	15,764	15,407	98%
1620	Zgjedhje te Pergjithshme dhe Lokale	10,095	9,890	98%
3140	Sherbimet e Policise Vendore	26,363	18,967	72%
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	113,405	56,479	50%
4130	Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	10,416	5,690	55%
4160	Sherbimi i tregjeve, Akreditimi dhe Inspektimi	1,477	126	9%
4220	Shërbimet bujqesore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatoreve	1,924	1,917	100%
4240	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	39,339	31,147	79%
4260	Administrimi i Pyjeve	30,313	13,075	43%
4520	Rrjeti rrugor rural	559,870	391,979	70%
4530	Menaxhimi rrugeve	80	-	0%
4570	Transporti publik	10,773	3,046	28%
4760	Zhvillimi i Turizmit	6,260	4,159	66.5%
4910	Fondi rezerve	10,149	-	0%
4940	Fondi I kontigjences	20,366	-	0%
4960	Ndermjet llogarive ne qender	235	-	0%
5100	Menaxhimi i mbetjeve	290,953	121,313	42%
5200	Menaxhimi i ujerave te zeza dhe kanalizimeve	15,000	13,997	93%
5320	Mbrojtja e mjedisit	6,972	-	0%
6140	Planifikimi Urban Vendor	1,000	-	0%
6190	Strehimi	54,341	50,702	93%
6260	Sherbimet publike vendore	93,940	62,160	66%
6330	Furnizimi me uje	27,464	9,016	33%
6440	Ndricim rrugesh	112,394	108,868	97%
7220	Sherbime te kujdesit paresor	3,000	-	0%
8130	Sport dhe Argetim	155,083	142,520	92%
8140	Zhvillimi i Sportit	344	344	100%
8220	Trashegimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	101,408	77,679	77%
8230	Arti dhe Kultura	-	-	0%
8250	Programe specifike kulturore dhe te turizmit	292	-	0%
9120	Arsimi baze perfshire arsimin parashkollor	343,236	274,606	80%
9230	Arsimi i mesem i pergjithshem	142,490	72,413	51%
9240	Arsimi profesional	33,201	14,217	43%
10140	Kujdesi social per personat e semure dhe me aftesi te kufizuara	683	-	0%
10430	Kujdesi social per familjet dhe femijet	1,074,569	1,034,911	96%
10661	Strehimi social	34,483	3,733	11%
10910	Emergjencat Civile	8,059	8,059	100%
	TOTALI	**3,695,353**	**2,782,960**	**75%**

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se:
Për vitin 2021 realizimi i buxhetit është në nivelin 75%, si dhe programi ekonomik që paraqitet me realizimi më të lartë është ñShërbimet bujqësoreò;
Programi me realizimin më të ulët është ñMbrojtja e mjedisitò;
Titulli i gjetjes: Angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion (20 % të vlerës së projektit buxhetuar për vitin 2021, sipas PBA 2021-2023).

[8]Pasqyruar në tabelën nr.3kapitulli Anekse;

Situata:Përgjatë vitit 2021 Bashkia Shkodër ka ndërmarrë angazhime të reja buxhetore (lidhur kontratë) për kryerjen e investimeve (llogaria 231) në punë publike, gjithësej 71 angazhime me vlerë totale 296,900 mijë lekë (vlera e kontratave të lidhura), të cilat janë parashikuar për tâu financuar në periudhën 2021-2023. Nga shqyrtimi i kontratave të lidhura dhe listës së projekteve (E3 sipas PBA 2021-2023, FPT përfundimtare, raporti i zbatimit të buxhetit) me afat financimi 2021-2023, miratuar me VKB nr.63, datë 28.12.2020, u konstatua se në8 raste, për kontrata të lidhura në vlerën 76,659 mijë lekë, nga Bashkia Shkodër janë ndërmarrë angazhime buxhetore pa pasur në dispozicion minimalisht 20% të vlerës së kontratëspër vitin e parë të financimit, pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

	Objekti	Data e lidhjes së kontratës	Vlera e kontratës[9] (mijë lekë)	Buxhetuar për vitin 2021 (mijë lekë)
1	Sistemim asfaltim rruga e Drinit Bahcallek	08.11.2021	6,749	294[10]
2	Sistemim Asfaltim Rruga e Gështenjave Rrenc, Guri i Zi	10.05.2021	7,834	885
3	Rikonstruksion Rruga "Ferrukej"	08.11.2021	8,094	605
4	Rikonstruksion Rruga (degëzim) ñAt Zef Valentiniò	10.12.2021	8,828	335
5	Rikonstruksion vazhdimi i Rrugës ñBardhosh Daniò në lidhje me Rrugën ñRrojejò	10.12.2021	11,295	1,337
6	Rikonstruksion vazhdimi i Rrugës ñAjasëmò	04.11.2021	14,663	333
7	Sistemim - Asfaltim i rruges Vukatanë ï Guri i Kuq (Loti 2)	30.03.2021	11,833	1,417
8	Rikonstruksion Rruga "Usta Meta"	20.12.2021	7,363	273

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Kriteri: Pika 9, 10të nenit 3, nenin 40, nenin 50 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
Pika 1 në nenin 47 në Ligjin nr.68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò;
Pika 1, paragrafi II në nenin 76 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar (në fuqi për periudhën kur janë lidhur kontratat Sistemim - Asfaltim Rruga e Gështenjave Rrenc, Guri i Zi dhe Sistemim - Asfaltim i rrugës Vukatanë ï Guri i Kuq, Loti II);
Pika 1 dhe 4 në nenin 106 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, për kontratat e tjera;
Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.
Efekti:Përballjen e Bashkisë me riskun e moslikujdimit në kohë të detyrimeve kontraktuale dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura, të cilat mund të shoqërohen edhe me penalitete.
Rëndësia:I Lartë.
Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (jo më pak se 20% për kontratat shumëvjeçare) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike,Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.373/5 prot., datë 07.07.2022, konkretisht nga Drejtoria e Financës, për sa më poshtë:
Pretendimi i Subjektit:
Realizimi i planit të të ardhurave në total për vitin 2021, është në masën 90%. Bashkia Shkodër gjatë të gjitha viteve pas reformës territoriale ka zbatuar Planin e Investimeve Kapitale bazuar në planifikimin strategjik, atë afatmesëm duke u mbështetur tërësisht në autonominë e saj dhe kapacitetin mbështetur në të ardhurat e veta. Bashkia Shkodër ka

[9] Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2021 dërguar në Këshillin Bashkiak me shkresën nr.2961 prot., datë 23.02.2022. FPT 2021-2023 përfundimtare, lista e projekteve, planifikimi i financimit të tyre, Urdhri i prokurimit.
[10] Pra për këtë kontratë në vitin e parë të financimit duhet të shpërndahet minimalisht 20% e vlerës së kontratës.

analizuar të gjitha mundësitë ligjore për planifikimin dhe financimin e projekteve me fonde të veta mbështetur në nenin 40 të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, në të cilin është përcaktuar shprehimisht:
ñ1. *Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë shpenzime, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përputhje me parimet e disiplinës fiskale, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimin me efiçencë, efektivitet dhe ekonomi të burimeve të tyre financiare. Të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, që nuk janë shpenzuar brenda vitit fiskal, trashëgohen në vitin tjetër fiskal…..*ò
nenin 41 të po të këtij ligji ku është përcaktuar shprehimisht se: *"1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore".*
nenin 47, pika 3 të ligjit 68/2017, ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, në të cilin është përcaktuar shprehimisht: *"3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të zbatojnë angazhimet sipas renditjes së regjistrimit të tyre në sistemin informatik financiar të qeverisjes qendrore.* ***Në rast se njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin angazhime buxhetore disavjeçare, ato regjistrojnë angazhimet kundrejt planit vjetor për tre vite në vijim*** *dhe, nëse angazhimi buxhetor është më i gjatë, mbetja regjistrohet në janar të vitit të katërt në sistemin informatik financiar të Qeverisë.*
Për sa më sipër, miratimi i financimeve të kontratave për një periudhë 2-3 vjeçare është bërë në zbatim të ligjit. E rëndësishme dhe e mjaftueshme është që këto fonde të jenë të angazhuara për këtë autoritet kontraktor në vijim, bazuar tek buxheti afatmesëm. Vendimi i Këshillit Bashkiak, ka miratuar fondin për buxhetin e vitit 2021, si edhe projekt buxhetin afatmesëm, 2021-2023, ndërsa në vijim sipas procedurave dhe legjislacionit financiar vazhdon miratimi me të njëjtën procedurë duke transferuar dhe fondet përkatëse vit pas viti.
Sqarojmë se, Bashkia Shkodër ka nënshkruar kontrata me afat 2-4 muaj, por me financim me afat 3-vjeçar, ku janë te përcaktuara qarte ne nenin nr.3, të kontratës së nënshkruar nga operatori ekonomik dhe autoriteti kontraktor, financimet nder vitet, te planifikuara me buxhetin e vitit respektiv dhe programin buxhetor afatmesëm, i cili është i miratuar me Vendim te Keshillit Bashkiak.
Pra theksojmë se nuk kemi të bëjmë me kontrata shumëvjeçare, por me financim ndër vite të miratuara me Vendim Këshilli Bashkiak dhe të planifikuara me buxhetin e vitit respektiv dhe programin buxhetor afatmesem.

<u>Qëndrimi i Grupit të Auditimit:</u>

Për pretendimin e ngritur më sipër nga subjekti i audituar sqarojmë se:
-Në asnjë rast nuk jemi shprehur se është mangësi të ndërmarrësh angazhim buxhetor me financim që shtrihet në 3 vite;
-Në asnjë rast nuk jemi shprehur se është mangësi që të planifikosh likujdimin e vlerës së investimit të shtrirë në 3 vite buxhetore;
-Në asnjë rast nuk jemi shprehur mbi realizimin apo jo të të ardhurave;
-Grupi i auditimit është shprehur se për 8 projekte për të cilat është ndërmarrë një angazhim buxhetor duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale, duke parashikuar likujdimin e vlerës së projektit të shtrirë në 3 vite, në vitin e parë nuk janë shpërndarëminimalisht 20% e fondeve, pra konstatimi i grupit të auditimit është për një fenomen tjetër dhe jo për veprimin tuaj, pra lidhjen e kontratës dhe financimin e saj në 3 vite. Theksojmë se angazhimet buxhetore në 8 kontratat e mësipërme janë angazhime buxhetore shumëvjeçare, pasi kontrata dhe fondet janë dy element të lidhur me njëri tjetrin dhe nuk mund të shihen të ndarë nga ana juaj, për të ardhur në pretendimin tuaj se kontrata nuk është shumëvjeçare por financimi është i shtrirë në disa vite.
Trajtimi i gjetjes nga grupi i auditimit është i bazuar në përcaktimet e bëra si më poshtë vijon:

▪ Ligji nr.139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, i ndryshuar;

Shkronjat ñaò dhe ñcò në pikën 1.4 në nenin 9, përcaktuar shprehimisht:
1.4. Të drejtën dhe përgjegjësinë e kryerjes së veprimtarive ekonomike, sipas së cilës:
a) për përmbushjen e funksioneve publike në interes të komunitetit që përfaqësojnë, **<u>në përputhje me legjislacionin në fuqi</u>**, ushtrojnë veprimtari ekonomike që nuk bie ndesh me orientimet themelore të politikave ekonomike të shtetit;
c) veprimtaria ekonomike e njësive të vetëqeverisjes vendore **<u>rregullohet në përputhje me legjislacionin në fuqi</u>**.

Pikën 1 në nenin 22, përcaktuar shprehimisht:
1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore **<u>rregullojnë dhe administrojnë ushtrimin e funksioneve të veta</u>** në mënyrë të plotë dhe të pavarur, në përputhje me Kushtetutën, Kartën Europiane të Autonomisë Vendore dhe **<u>ligjet në fuqi.</u>**

Pikën 6 në nenin 34, përcaktuar shprehimisht:
6.Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore **<u>harton, miraton, zbaton dhe administron</u>** çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, **<u>si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.</u>**

Pikën 1 në nenin 40, përcaktuar shprehimisht:
1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore **<u>kryejnë shpenzime</u>**, **<u>sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi</u>**, në përputhje me parimet e disiplinës fiskale, menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimin me efiçencë, efektivitet dhe ekonomi të burimeve të tyre financiare.

▪ Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në RSHò, i ndryshuar;

Neni 2, përcaktuar shprehimisht:
Ky ligj zbatohet nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme në të gjitha fazat e procesit buxhetor, që do të thotë:
a) përgatitjen, shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit;
b) zbatimin, ndjekjen dhe rishikimin e buxhetit.

Pikën 38 në nenin 3, përcaktuar shprehimisht:
38. ñAngazhim buxhetorò është **<u>marrja përsipër e detyrimeve financiare</u>**, në formë të shkruar, përmes hyrjes në marrëdhënie kontraktuale.

Nenin 19, paragrafi:
Nëpunësi autorizues është përgjegjës për menaxhimin financiar në njësinë e qeverisjes së përgjithshme ku është caktuar, **në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 4, të këtij ligji**.
Nenin 40, paragrafi:
Për angazhimet buxhetore shumëvjeçare, që lidhen me projekte të reja investimesh publike, gjatë vitit të parë të zbatimit të tyre **<u>nuk lejohet që në buxhetin e njësisë përkatëse të qeverisjes së përgjithshme të shpërndahen më pak se 20 për qind e vlerës</u>** së plotë të projektit përkatës.
Neni 50 paragrafi:
Nëpunësit autorizues të njësive të qeverisjes së përgjithshme mbajnë të dhëna për angazhimet financiare dhe nuk lejojnë ndërmarrjen e angazhimeve të reja, përtej kufirit të fondeve buxhetore të shpërndara.

Ligji nr.68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò;
Neni 5, paragrafi:
Në menaxhimin e financave vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore **ndjekin parimet e përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor** në Republikën e Shqipërisë dhe në këto parime.

Pika 1 në nenin 47, përcaktuar shprehimisht:
1. Angazhimet buxhetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore **kufizohen në disponueshmërinë e parashikuar të mjeteve monetare dhe në shpërndarjet e miratuara buxhetore.**

▪ Shkronja ñfò në pikën 21 në Udhëzimin plotësues të MFE nr.1381/1 prot., datë 25.01.2021 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2021ò.
-Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Titulli i gjetjes: Pranimi i faturave të lëshuara nga subjektet e kontraktuara për kryerjen e punëve publike, me vlerë më të lartë se sa vlera e buxhetuar për vitin 2021.
Situata: Nga shqyrtimi i llogarisë analitike 401-408 (detyrime në fund të vitit 2021 të Bashkisë Shkodër ndaj palëve të treta), u konstatua se në 3 raste nga Drejtoria e Financës, Sektori i Financës, janë pranuar fatura për punëpublike, me vlerë më të lartë se sa vlera e buxhetuar në PBA 2021-2023 për tôu financuar në vitin 2021, pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Objekti	Data e Faturës	Vlera e faturuar(000 lekë)	Vlera (000 lekë)e buxhetuar për vitin 2021 (PBA 2021-2023)
Sistemim - Asfaltim i rruges Vukatanë ï Guri i Kuq, (Loti 2)	09.06.2021	11,651	2,000
Sistemim Asfaltim rruga e Geshtenjave Rrenc,Gur i Zi	13.09.2021	6,679	1,206
Rikonstruksion vazhdimi i Rrugës ñAjasëmò	30.12.2021	2,878	847

Burimi: Drejtoria e Financës, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Kriteri: Pika 40 në Udhëzimin plotësues të MFE nr.1381/1 prot., datë 25.01.2021 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2021ò.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.
Efekti: Rritjeartificialisht të vlerës sëdetyrimeve në fund të vitit.
Rëndësia:I Mesëm.
Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme që të mos ndërmerren angazhime buxhetore shumëvjeçare mbi vlerat e miratuara në planin e buxhetit vjetor dhe PBA.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.373/5 prot., datë 07.07.2022, konkretisht nga Drejtoria e Financës, për sa më poshtë:
Pretendimi i Subjektit:
Për objektet:
-"Sistemim Asfaltim i rrugës Vukatane - Guri i Kuq, (Loti 2)";
-"Sistemim Asfaltim rruga e Gështenjave Rrenc, Gur i Zi";
-"Rikonstruksion vazhdimi i Rrugës "Ajasem".
Bashkia Shkodër i është referuar ligjit nr. 87/2019 ñPër faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimitò, neni 4, neni 6 , neni 8, si dhe Udhëzimit nr.16, datë 03.04.2020 ñPër faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimitò, neni 2, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 9, datë. 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò,

i ndryshuar pikat 79, 80, 81, përsa i përket të drejtës për të kryer shpenzime dhe kontrollit të angazhimeve shumëvjeçare brenda tavaneve 3-vjeçare të miratuar me VKB.

E drejta për të kryer shpenzime

"79. E drejta për të kryer shpenzime, brenda kufirit të fondeve të miratuara, skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës. Për fondet e njësive vendore, nga transferta e pakushtëzuar apo të ardhurat vendore, e drejta për të kryer shpenzime është në përputhje me përcaktimet e ligjit përkatës për vetëqeverisjen vendore.

80. Për të siguruar kontrollin që angazhimet shumëvjeçare të jenë brenda tavaneve trevjeçare,të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit ndiqet kjo procedurë:

a. Rregjistrimi dhe mbartja e kontratave, vjetore apo shumëvjeçare, bëhet nga dega e thesarit përkatës, sipas vlerave të përcaktuara për çdo vit të buxhetit të miratuar trevjeçar;

b. Nëse kohëzgjatja e kontratës shumëvjeçare shkon përtej periudhës trevjeçare të ligjit të miratuar të buxhetit, pjesa e mbetur e vlerës së kontratës, pas rregjistrimit të vlerave për çdo vit të buxhetit të miratuar trevjeçar, rregjistrohet në vitin buxhetor pasardhës që vjen menjëherë pas vitit të fundit të ligjit të miratuar të buxhetit trevjeçar. "

81. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria përgjegjëse për Financat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime.

Në zbatim të nenit 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar, pas dates 15 tetor të çdo viti buxhetor, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk mund të publikojnë njoftimin për prokurimin e mallrave/punëve/shërbimeve, të cilat nuk janë përfshirë në regjistrin e prokurimeve publike, deri në këtë datë.

Ne Ligjin baze te funksionimit te institucioneve publike Nr.9936/2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH", i ndryshuar veprimet tregtare te mesiperme përkufizohen si "angazhim buxhetor":

Neni 4 "Angazhim buxhetor" është marrja përsipër e detyrimeve financiare, në formë të shkruar, përmes hyrjes në marrëdhënie kontraktuale.

Për sa më sipër, miratimi i financimeve të kontratave për një periudhë 2-3 vjeçare është krejtësisht në zbatim të ligjit.E rëndësishme dhe e mjaftueshme është që këto fonde të jenë të angazhuara për këtë autoritet kontraktor në vijim, bazuar tek buxheti afatmesëm.Bashkia Shkodër në fillim të vitit ka hartuar bazuar në planin e vet buxhetor regjistrin e prokurimeve publike, dhe ka vijuar zbatimin me përpikmëri, duke mos marrë në asnjë rast a*ngazhime buxhetore përtej afatit.*

Rekomandim 6.1: Ky rekomandim nuk pranohet.

<u>Qëndrimi i Grupit të Auditimit:</u>

Për pretendimin e ngritur më sipër nga subjekti i audituar sqarojmë se:

-Kuadri rregullator pra Ligji nr.87/2019 ñPër faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimitò, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr.16, datë 03.04.2020 ñPër faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimitò, i ndryshuar, ka si objekt të tij lëshimin e faturës tatimore për furnizimin e mallrave/punimeve të ndërtimit, shërbimeve, si dhe pranimin e tyre nga institucionet publike, në rastin kur fatura është lëshuar për institucionin publik. Pra grupi i auditimit nuk është shprehur se përse është lëshuar faturë tatimore apo përse është pranuar fatura, por është shprehur për vlerën e pranuar, ku sipas përcaktimit të bërë pikën 40 në Udhëzimin plotësues të MFE nr.1381/1 prot., datë 25.01.2021 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2021ò, shprehimisht:

ñ**<u>Në rastin e kontratave shumëvjeçare, njësia shpenzuese nuk duhet të pranojë faturimin nga operatori ekonomik, për kryerjen e shërbimit apo ofrimit të mallrave</u>**

objekt të kontratës, brenda vitit financiar në një vlerë më të madhe se sa buxheti i miratuar për atë kontratë në vitin financiar respektivë.
Duke vijuar më tej, në rastin e mësipërm grupi i auditimit nuk është shprehur për angazhime buxhetore përtej afatit ligjor, apo mbi mënyrën e financimit të kontratës me afat 3-vjeçar.
-Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

2.3.*Auditimi mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.*

Për zbatimin e buxheteve është rakorduar çdo muaj me DegëneThesaritShkodër,sipërshpenzimet ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Nga BashkiaShkodër janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipasklasifikimitekonomik.

Tabela nr.5 Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik ï viti 2021

Llogaria	Emërtimi	2021		
		Plan	Fakt	Real.%
600	Paga	720,127	566,893	79%
601	Sigurime shoqërore	115,991	93,983	81%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	891,062	761,241	85%
604	Transferta korente te brendshme	180,432	168,479	93%
606	Trans për buxh. fam. & individ	993,215	964,928	97%
230	Kapitale të patrupëzuara	45,376	15,442	34%
231	Kapitale të trupëzuara	715,632	450,503	63%
	Total	**3,695,353**	**2,782,960**	**75%**

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Grafiku nr.1 Pesha e secilit artikull ndaj totalit



Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuartëdhënavetëpasqyrëssëmësipërme rezulton se për vitin 2021 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 75 %, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 606 ñTansferta për Buxhetin Familjar dhe Individò, ku përfshihen ndihma ekonomike, duke vijuar me transfertat Korente të Brendshme, ndjekur nga shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë shpenzimet për mallra e shpenzime kapitale. Vihet re se për vitin 2021 investimet (231) paraqiten 63 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik,ka realizimin më të ulët.

- **Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit.**

Tabela nr.6Buxheti sipas burimeve të financimit 2021

Art.	Emertimi	Fakt 2021			
		Gjithesej	Tr. Pakushtezuar dhe Specifike	Te ardhurat e veta	Transferta e kushtezuar
230+231	Investime	450,503	65,170	337,379	47,953
600	Paga	566,893	482,143	60,411	23,466
601	Sigurime Shoqërore	93,983	80,249	11,191	2,395

602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	522,729	265,343	248,257	7,742
604	Transferta Korente të Brendshme	168,479	93,613	66,806	8,059
606	Trans. per Buxh. Fam. & Individ	964,928	3,383	1,847	959,397
	Total	**2,767,515**	**989,901**	**725,891**	**1,049,012**

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferta e kushtëzuar, në vlerën 1,049,012 mijë lekë, kanë peshën më të lartë në krahasim me burimet e tjera të të ardhurave të Bashkisë Shkodër, ndjekur nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 989,901 mijëlekë dhe të ardhurat e veta në vlerën 725,891 mijë lekë.

Transferta e kushtëzuar.
-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për vitin 2021 është realizuar në vlerën **1,124,357** mijë lekë, ose **40%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda transfertës së kushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për investime.
Transferta e pakushtëzuar.
-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2021 është realizuar në vlerën **989,901** mijë lekë, ose **36%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga.
Të ardhurat e veta.
-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2021 është realizuar në vlerën **725,891 mijë** lekë, ose **26%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime dhe shpenzime operative.

-Fonde nga FZHR nuk ka pasur.

- **Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.**

Me miratimin e buxhetitpër vitin 2021 është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/i kontigjencës, ku për vitin 2021 është planifikuar në masën 10,486 mijë lekë, i cili nuk është përdorur.

- **Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.**

Nga Bashkia Shkodër është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 20,366 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 8,059 mijë lekë, për mbulimin e shpenzimeve për rikonstruksionin e banesave sociale në pronësi të Bashkisë Shkodër.
-Totali i fondit rezervë dhe kontigjencës është brenda limitit 3%, përjashtuar transfertën e kushtëzuar.

- **Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Shkodër.**

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se, Bashkia Shkodër përgjatë periudhës 2021-2023 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

Tabela nr.7Subvencionet nga/dhe për Bashkinë.

Nr	prog	Art	Buxheti Plan	Likuidimi
1	4570	603	3,000,000	-

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Realizimi i Investimeve.

Titulli gjetjes:Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

Situata: Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele të ulta në vitin 2021, konkretisht në masën 63%. Kjo situatë vjen si rezultat i mosrealizimit të investimeve të planifikuara për disa programe ekonomike, si p.sh., programi ekonomik ñAdministrimi i pyjeve dhe kullotaveò (nuk është realizuar asnjë investim, mosparaqitje të ofertave, mungesa e miratimit nga MTM të planit të menaxhimit të fondit pyjor/kullosor), programi ekonomik ñRrjeti rrugor ruralò realizuar në masën 70%, për arsye se shumë projekte janë në proces zbatimi, pasi një pjesë e konsiderueshme e kontratave janë lidhur në fund të vitit 2021.
Kriteri: Shkronja ñaò në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò;
Pika 24 dhe 25 në nenin 3 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
Shkaku: Lidhja e kontratave në fund të vitit, si dhe për vlerën e plotë të projektit dhe jo për nivelin e fondeve të buxhetuara për vitin përkatës.
Efekti: Mos realizim i investimeve të planifikuara.
Rëndësia:I Lartë.
Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Financës, të marrë masa që kontratat me palët e treta të lidhen në një fazë më të hershme gjatë vitit buxhetor, me qëllim përshpejtimin e realizimit e investimeve të planifikuara brenda vitit buxhetor.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.373/5 prot., datë 07.07.2022, konkretisht nga Drejtoria e Financës, për sa më poshtë:
Pretendimi i Subjektit:
Në zbatim të Udhëzimit nr.23, datë 30.07.20218 "Per procedurat standarde te përgatitjes se programit buxhetor afatmesëm te njesive te vetëqeverisjes vendore", të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pika 35, citon:
ñDrejtuesit e ekipit te menaxhimit te programit jane përgjegjës dhe raportojnë përpara nëpunësit autorizues, per hartimin e kërkesave buxhetore per programin përkatës, per realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve te programit gjate procesit te zbatimit te Buxhetitò.
Pika 36 citon.
ñDrejtuesit e ekipit te menaxhimit te programit jane përgjegjës per te garantuar realizimin siç; duhet te përgjegjësive te ekipit te menaxhimit te programit, si nje komponent i rëndësishëm i organizimit institucional per përgatitjen e kërkesave buxhetoreò.
Drejtuesit e Ekipit te Menaxhimit te Programit, janë përgjegjës për realizimin e investimeve të planifikuara sipas Programeve Ekonomike që menaxhojnë.
Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë. 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar, pika 153, citon:
ñMarrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike
Kërkesa për shpenzim paraqitet nga drejtuesi funksional i aktivitetit të çdo niveli të njësisë /nënprogramit/ programit buxhetor, përgjegjës për realizimin e objektivave të planifikuara në kuadrin e programit respektiv buxhetor. Kërkuesi i shpenzimit nuk mund të kërkojë kryerje të shpenzimeve jashtë fondeve të kërkuara prej tij dhe të miratuara në procesin e planifikimit të buxhetit të njësisë sipas programeve buxhetore ku bën pjesë.
Pika 154 citon:
ñKërkesa për shpenzim i drejtohet Nëpunësit Autorizues dhe për dijeni Nëpunësit Zbatues. Në rastet kur kërkesa është e lidhur me një proces blerje apo kryerje shërbimi i dërgohet strukturës përgjegjëse për prokurimet në njësinë shpenzuese. Struktura përgjegjëse për prokurimet kryen kontrollet e nevojshme krahasuese me kërkesat e planifikuara dhe planin e

prokurimit të miratuar në procesin e planifikimit të buxhetit. Në rast të kërkesave të reja, të paplanifikuara më parë, kërkohet miratimi paraprak i Nëpunësit Autorizues të njësisë. Në përfundim të procesit njofton Nëpunësin Zbatues të njësisë për urdhrin e prokurimit, i cili autorizohet nga struktura përgjegjëse e Thesarit në degë përpara se të fillojë procesi i prokurimit. Kërkesa për shpenzim i drejtohet nëpunësit autorizues dhe për dijeni nëpunësit zbatuesò.
Kërkojmë që rekomandimi 4.1 të riformulohet, pasi proçesi menaxhohet nga drejtuesit e programeve buxhetore.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
Për pretendimin e ngritur më sipër nga subjekti i audituar sqarojmë se:
Rekomandimi i mësipërm i është drejtuar NA dhe NZ së Bashkisë Shkodër, të cilat janë pjesë e pozicioneve të nivelit të lartë drejtues. Për më tepër NZ ka një sërë detyrash të cilat lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, pjesë e të cilave me rëndësi sa i përket rekomandimit të dhënë, si vijon:
Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;
Nëpunësi zbatues i njësisë publike është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë publike për garantimin e cilësisë së:
a) dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe **bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë publike**, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike;
b) **raportimit periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave**, si dhe të pasqyrave financiare vjetore të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministri i Financave.
-Megjithatë observacioni juaj merret në konsideratë dhe është reflektuar në rekomandimin përkatës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.373/5 prot., datë 07.07.2022, konkretisht nga Drejtoria e Financës, për sa më poshtë:
Pretendimi i Subjektit:
Bashkia Shkodër i është referuar Udhëzimit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 9, datë. 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar pikat 79, 80, 81, përsa i përket të drejtës për të kryer shpenzime dhe kontrollit të angazhimeve shumëvjeçare brenda tavaneve 3-vjeçare të miratuar me VKB.
E drejta për të kryer shpenzime
ñ79. E drejta për të kryer shpenzime, brenda kufirit të fondeve të miratuara, skadon ditën e fundit të vitit buxhetor, pavarësisht nëse kontrata njëvjeçare ose shumëvjeçare mund të vazhdojë edhe në vitin buxhetor pasardhës. Për fondet e njësive vendore, nga transferta e pakushtëzuar apo të ardhurat vendore, e drejta për të kryer shpenzime është në përputhje me përcaktimet e ligjit përkatës për vetëqeverisjen vendore.
80. Për të siguruar kontrollin që angazhimet shumëvjeçare të jenë brenda tavaneve trevjeçare,të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit ndiqet kjo procedurë:
a. Rregjistrimi dhe mbartja e kontratave, vjetore apo shumëvjeçare, bëhet nga dega e thesarit përkatës, sipas vlerave të përcaktuara për çdo vit të buxhetit të miratuar trevjeçar;
b. Nëse kohëzgjatja e kontratës shumëvjeçare shkon përtej periudhës trevjeçare të ligjit të miratuar të buxhetit, pjesa e mbetur e vlerës së kontratës, pas rregjistrimit të vlerave për çdo vit të buxhetit të miratuar trevjeçar, rregjistrohet në vitin buxhetor pasardhës që vjen menjëherë pas vitit të fundit të ligjit të miratuar të buxhetit trevjeçar. ñ
81. Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme është e detyruar që, përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të marrë një konfirmim nga Ministria

përgjegjëse për Financat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime.
Në zbatim të nenit 51, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, të ndryshuar, pas dates 15 tetor të çdo viti buxhetor, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk mund të publikojnë njoftimin për prokurimin e mallrave/punëve/shërbimeve, të cilat nuk janë përfshirë në regjistrin e prokurimeve publike, deri në këtë datë.
Ne **Ligjin baze te funksionimit te institucioneve publike Nr.9936/2008** "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar veprimet tregtare të mësiperme përkufizohen si "angazhim buxhetor":
*Neni 4 "**Angazhim buxhetor"** është marrja përsipër e detyrimeve financiare, në formë të shkruar, përmes hyrjes **në marrëdhënie kontraktuale**.*
Për sa më sipër, miratimi i financimeve të kontratave për një periudhë 2-3 vjeçare është krejtësisht në zbatim të ligjit.
E rëndësishme dhe e mjaftueshme është që këto fonde të jenë të angazhuara për këtë autoritet kontraktor në vijim, bazuar tek buxheti afatmesëm.
Bashkia Shkodër në fillim të vitit ka hartuar bazuar në planin e vet buxhetor regjistrin e prokurimeve publike, dhe ka vijuar zbatimin me përpikmëri, duke mos marrë në asnjë rast a*ngazhime buxhetore përtej afatit.*
Sqarojmë se këto objekte janë të planifikuara me Vendim Këshilli Bashkiak, të përfshira në rregjistrin e prokurimeve dhe të parashikuara me fonde disponibël.
Rekomandim 2.1: Ky rekomandim nuk pranohet, pasi bazuar në dispozitat ligjore të mësipërme, angazhimi ka filluar përpara datës 15 Tetor 2021.
<u>Qëndrimi i Grupit të Auditimit:</u>
Për pretendimin e ngritur më sipër nga subjekti i audituar sqarojmë se:
-Në asnjë rast nuk jemi shprehur se është mangësi të ndërmarrësh angazhim buxhetor me financim që shtrihet në 3 vite;
-Në asnjë rast nuk jemi shprehur se angazhimet buxhetore të mësipërme nuk janë brenda tavaneve përfundimtare për programet buxhetore;
-Në asnjë rast nuk jemi shprehur mbi realizimin apo jo të të ardhurave;
-Kryerja e shpenzimit është një veprim i mëpasshëm, pra që nënkupton pakësimin e pasurisë së institucionit dhe krijohet si rrjedhojë e faturës tatimore që lëshon subjekti që ka kryer punimet, furnizimin, shërbimin etj. Pra në rastin e mësipërm jemi përpara këtij veprimi, jemi në fazën e lidhjes së kontratës dhe jo kryerjes së shpenzimit.
-Grupi i auditimit pas shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur observacionit, konkretisht VKB nr.45, datë 27.07.2021 për ndryshimin VKB nr.63, datë 28.12.2020 ñPër miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA 2021-2023 të Bashkisë Shkodërò dhe rialokimit të fondeve për 3 projektet e mësipërme, e merrë në konsideratë observacionin dhe ka bërë ndryshimet përkatëse.

<u>Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak.</u>
Në zbatim të nenit 48 ñ*Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor*ò të ligjit 68/2017 ñ*Për financat e vetëqeverisjes vendore*ò, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñ*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*ò, i ndryshuar neni 65,UMF nr. 2, datë 06.02.2012 ñ*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*ò i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 ñ*Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore*ò, si dhe nenin 44[11], të ligjit nr. 139/2015 datë

[11] Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim te këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe instuticionet e saj të varësisë. Ky raport paraqitet në këshill jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.

17.12.2015 ñ*Për vetëqeverisjen vendore*ò, konstatohet se për vitin 2021 raportet periodike dhe ai vjetor për monitorimin e zbatimit të buxhetit, janë realizuar dhe përcjellë në Këshillin Bashkiak, si dhe Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra më sipër.

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Shkodër, rezulton se është bërë planifikimi i likujdimit të tyre për cdo vit buxhetor, janë raportuar periodikisht në Këshillin Bashkiak dhe MFE.

Me fondet buxhetore të vitit 2021, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale.

Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2021 ka ardhur duke u rritur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2021.

Tabela nr. 9 Detyrime për periudhën 2021

Detyrime e NJQV 2021	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2020	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2021	Total detyrime	Shlyerja gjatë 2021	Mbetja në fund të vitit 2021
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Investime	81,271,846	124,083,988	205,355,834	77,345,198	128,010,636
Mallra dhe shërbime	87,822,119	13,793,821	101,615,940	20,258,370	81,357,570
Vendime gjyqësore	27,664,603	1,336,617	29,001,220		29,001,220
Tjera ...	21,194,657	21,423,797	42,618,454	21,194,657	21,423,797
486	3,199,930	3,376,220	6,576,150	3,199,930	3,376,220
Total Detyrime	221,153,155	164,014,443	385,167,598	121,998,155	**248,490,839**
Gjendja e llogarisë 520 në fund të vitit 2021					717,169,979

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që ka Bashkia Shkodër ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2021, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyrues (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.

Titulli i gjetjes: Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe raportimi i tij në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë.

Situata: Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2021, përcjellë në MFE me shkresën nr.2438 prot., datë 15.02.2022, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Shkodër ndaj palëve të treta raportuar në MFE, përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore dhe shpenzime korrente, në vlerën 3,376,220 lekë, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së	Stoku i përllogaritur/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së	
I	**Borxhe (a+b)**	-				
a	Hua sfatgjatë	-				
a,1	Principali					
a,2	Interesi					
b	Hua afatshkurtër	-				
b,1	Hua					
b,2	Overdrafte					
b,3	Kredi të furnitorëve					

II	**Detyrime (a+b+c)**	**3,376,220**		**0.19%**	**248,490,839**	
a	Shpenzime korrente	571,032				
a,1	Mallra dhe shërbime				2,618,224	
a,2	Paga dhe sigurime					
a.3	Të tjera	571,032			79,928,066	
b	Shenzime kapitale	-			163,139,361	
b,1	Insitucione buxhetore					
b,2	Subjekte private					
c	**Vendime gjyqësore**	**2,805,188**			**2,805,188**	
c,1	Marrëdhënie pune					
c,2	Mallra dhe shërbime					
c,3	Investime	2,805,188			2,805,188	
c,4	Të tjera					
III	**Totali (I+II)**	**3,376,220**	**1,743,763,693**	**0.19%**		**14.2%**

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Në vijim parashtrojmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, çfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:

"Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta", nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, <u>të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike</u> (30 ditë për procedurat 3 e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrat, faturë ose sipas ligjit"[12].

"Detyrimet e prapambetura rregjistrohen në llogarinë ekonomike 4864 "Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura"[13].

"Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2021, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr.4864 në debi të llogarisë nr.467 "Kreditorë të ndryshëm për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në llogari në datën 31.12.2021"[14].

-Nga verifikimi i llogarisë 467 në pasqyrat financiare të vitit 2021, faturave të regjistruara në llogarinë 401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò, për faturat të cilat kanë mbi 60 ditë kalendarike që nuk janë likuiduar, përfshirë edhe likuidimet deri në 26.01.2022 në ditarin e bankës, rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021 është në vlerën 248,490,839 lekë, detajuar si më poshtë vijon:

-Llogaria 486 - 3,376,220 lekë;

-Llogaria 467 me kundërparti llogarinë 486[15] - 79,357,034 lekë (e cila nuk është debituar për vlerën 79,357,034 lekë në pasqyrat financiare të vitit 2021);

-Llogaria 401-408 ï fatura që kanë kaluar 60 ditë kalendarike pa u likuiduar (përfshirë periudhën deri në 26.01.2022) dhe janë kontabilizuar në këtë llogari, ndërkohë që duhet të kontabilizoheshin në llogarinë 4864 - 165,757,585 lekë. **(Llogaritë analitike të mësipërme dhe likuidimet deri më datë 26.01.2022 janë pasqyruar në Kapitullin "Anekse", tabela nr.8)**.

<u>Kriteri:</u>Udhëzimi nr.26, datë 27.09.2019 ñProcedura për menaxhimin e vështirësisë financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendoreò.

[12] Udhëzimi nr.26, datë 27.09.2019 ñProcedura për menaxhimin e vështirësisë financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendoreò.

[13] Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 ñPër monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshmeò.

[14] Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 ñPër disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, i ndryshuarò.

[15] Debitohet llogaria përkatëse 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambeturaò dhe Kreditohet llogaria përkatëse 467 ñKreditorë të ndryshëmò.

Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 ñPër monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshmeò.
Udhëzimi nr.5, datë 21.02.2022 ñPër disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, i ndryshuarò.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.
Efekti: Mospasqyrimi real i stokut të detyrimeve të prapambetura.
Rëndësia:I Lartë.
Rekomandimi:Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, duke kryer sistemimet e nevojshme në llogarinë 4864.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr.373/5 prot., datë 07.07.2022, konkretisht nga Drejtoria e Financës, për sa më poshtë:
Pretendimi i Subjektit:
Theksojmë se është respektuar radha e veprimeve dhe likuidimeve duke ruajtur afatin 30-ditor për faturën dhe 60-ditor në rastin e certifikatës së marrjes në dorëzim të përkohshme, apo proces- verbal marrje në dorëzim, (kjo për 230-231).
Përsa i përket faturave:
-Për subjektin S.M.O.V, faturë e datës 11.08.2019, theksojmë se kjo faturë ka qenë e angazhuar në bazë të kontratës, neni 3, me financim 2019, 2020, 2021. Financimi për vitin 2021 është bërë me çeljen e fondeve të trashëguara dhe fondeve të Buxhetit me të Ardhura të vitit 2021.(bashkëngjitur kopje e USh dhe detajimi i VKB).
-Për objektin Bleran Bardhaj faturë e datës 27.11.2020 e cila është i me datë 11.02.2021, pasi ka qenë financim i vitit 2021, kjo sipas PBA 2020-2022. Prandaj me çeljen e detajimin të fondeve të trashëguara dhe fondeve të Buxhetit me të Ardhura të vitit 2021 është bërë likuidimi i financimit të vitit 2021. (bashkëngjitur kopje e USh dhe detajimi i VKB).
-Për subjektin N faturë e datës 26.07.2019, e cila është likuiduar me datë 11.03.2021, pasi ka qenë financim i vitit 2021, sipas PBA 2019-2021. Prandaj me çeljen e detajimin të fondeve të trashëguara dhe fondeve të Buxhetit me të Ardhura të vitit 2021 është bërë likuidimi i financimit të vitit 2021.(bashkëngjitur kopje e USh dhe detajimi i VKB).
-Për Subjektin Ervin Sadiku, me faturë të datës 29.12.2020, likuidimi është bërë me datë 26.01.2021, pasi është bërë detajimi i Buxhetit të vitit 2021 dhe PBA 2021-2023, me datën 14.01.2021, si bashkëngjitur, ku janë likuiduar faturat që kanë qenë të parashikuara me financim transfertës e pakushtëzuar dhe transfertës e pakushtëzuar Sektoriale. (bashkëngjitur kopje e USh dhe detajimi i VKB).
Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.46, datë 24.12.2020 ñPër procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të Buxhetit për vitin 2020ò, pika 23, likuidimi i procedurave për vitin 2020, ka vazhduar deri me datën 26 Janar 2021. Pas kësaj date është bërë mbyllja dhe rakordimi me Degën e Thesarit Shkodër për vitin 2020. Trashëgimi i fondeve me të ardhura është bërë në Mars të vitit 2021. Prandaj dhe likuidimi i gjithë financimeve është realizuar në muajin Mars 2021. (bashkëngjitur kopje e USh dhe detajimi i VKB).
-Për Subjektin Rr.G, faturë e datës 14.08.2020 e cila është likuiduar me datë 12.02.2021, ka qenë me financim për vitin 2021, kjo sipas PBA 2020-2022. Prandaj me çeljen e detajimin të fondeve të trashëguara dhe fondeve të Buxhetit me të Ardhura të vitit 2021 është bërë likudimi i financimit të vitit 2021. (bashkëngjitur kopje e USh dhe detajimi i VKB).
-Për Subjekti L me faturë të datës 28.12.2020 e likuiduar me datë 24.02.2021, pasi kjo procedurë ka qenë situacion përfundimtar dhe ka çertifikatë marrje në dorëzim të

përkohshme me datën 04.02.2022, dhe likuidimi është bërë më datë 24.02.2022. **Procedurë e likuiduar brenda afatit 30-ditor.** (bashkëngjitur kopje e USh dhe detajimi i VKB).

-Për subjektin S.M.O.V faturë e datës 31.12.2020 e cila është likuiduar me datë 22.02.2021, ka qenë me financim të vitit 2021, kjo sipas PBA 2020-2022. Prandaj me çeljen e detajimin të fondeve të trashëguara dhe fondeve të Buxhetit me të Ardhura të vitit 2021 është bërë likuidimi i financimit të vitit 2021. (bashkëngjitur kopje e USh dhe detajimi i VKB).

Në lidhje me gjetjen 3, për detyrimet e prapambetura, sqarojmë:

Në zbatim të Udhëzimit 37 përcaktohet së njësitë vendore duhet të regjistrojnë faturat e papaguara në sistemin e thesarit (SIFQ), duke përpiluar dokumentacionin e Urdhër Detyrimit, duke klasifikuar llogarinë ekonomike dhe ***dokumentacionin justifikues dhe të rregullt***. **"Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta**ò, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrate, faturë ose sipas ligjit.

Për shumën prej 1,705,129 lekë, për A dhe subjektin Sh.V, Bashkia Shkodër ka vijuar menjëherë likujdimin në bazë të urdhër nr.763, datë 12.08.2021, likuiduar me datë 20.08.2021 për subjektin A, dhe për Sh.V në bazë të urdhërit të kryetarit nr. 1015, datë 06.10.2021 likuiduar me datë 24.11.2021.

Për të bërë regjistrimin si urdhër detyrimi duhet dokumentacion i rregullt ligjor dhe financiar.

Në Udhëzimin 26 përcaktohet pika **30**, përcaktohet se ñTabela për verifikimin e situatës financiareò (Aneksi 1) dhe ñTreguesit fiskale te konsoliduar te NJVQVò (Aneksi 2), jane **dy** tabelat që do raportohen **një herë në katër muaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, së bashku me raportin e monitorimit.**

Bashkia Shkodër, ka raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 2438 prot, datë 15.02.2022 me objekt ñDorëzim i raportit të vetëvlerësimit financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2021 për situatën e gjendjes financiare të bashkisë Shkodërò. (bashkëngjitur kopje e shkresës).

Në pikën 60 tëUdhëzimit nr. 9, date 20.03.2018 "Per procedurat standarde te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar, përcaktohet: ñ*Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative.* Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa miratimin e titullaritò.

Sqarojmë se Bashkia Shkodër ka likuiditete, fonde disponibël, por përsa kohë që procedurat janë me mungesë dokumentacioni, financiare dhe ligjore, si dhe ka procese gjyqësore të cilat janë në proces, këto detyrime nuk mund të rregjistrohen si Urdhër -Detyrim, pasi dokumentacioni nuk është i plotë. Bashkia Shkodër ka likuiditet dhe në bazë të urdhërit të kryetarit , Drejtoria e Financës ka bërë likuidimin.

<u>Qëndrimi i Grupit të Auditimit:</u>

Për pretendimin e ngritur më sipër nga subjekti i audituar sqarojmë se:

-Sa i përket respektimit të likujdimit të faturave brenda afatit 30 ditor për 28 raste, ky konstatim është nxjerrë nga vetë të dhënat tuaja.

-Sa i përket rradhës së likujdimit të faturave ekonomike, sqarojmë se grupi i auditimit nuk është shprehur se përse fatura nuk është likujduar në vitin 2020, sepse e kemi të qartë që financimi është bërë për 3 vite. Grupi i auditimit është shprehur se për 4 faturat të evidentuara për subjektet S.M.O.V, N, Rr.G dhe L, të cilat janë pasqyruar për të ilustruar fenomenin e konstatuar, nuk është respektuar rradha brenda vitit buxhetor. Pra fatura e S.M.O.V sipas mënyrës së financimit në kontratën ndërmjet palëve, është përcaktuar që

njëpjesë e vlerës së projektit të likujdohet në vitin 2021, pikërisht për këtë faturë që duhet të likujdohet në vitin 2021, në krahasim me fatura të tjera të mbërritura më vonë dhe që do të likujdohen në vitin 2021, fatura e S.M.O.V duhet të likujdohet më përpara. Pra ky është fenomeni i konstatuar.
-Sa i përket tabelës së raportimit të situatës financiare, këtë informacion e kemi marrë nga ju, pra nuk është e nevojshme që të citoni se kur e keni përcjellë në MFE, pasi e kemi të qartë që keni raportuar. Ne jemi shprehur për vlerën e stokut të raportuar dhe për vlerësimin e stokut jemi mbështetur në përcaktimet ligjore që i kemi referuar në trajtimin e çështjes dhe tek Rubrika ñKriteretò.
-Sa i përket likujdimeve për 2 vendimet gjyqësore ndaj subjekteve ñAò dhe ñSh.Vò, pas shqyrtimit të dokumentacionit bashkëlidhur observacionit, merret në konsideratë dhe është bërë ndryshimi përkatës.
-Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.

Titulli i gjetjes: Efektet negative në buxhet si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësorepër zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.
Situata: Nga shqyrtimi i vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës rezultoi se në Bashkinë Shkodër janë administruar 3 vendime gjyqësore të formës së prerë, si vijon: Vendimi nr.277, datë 26.07.2021 për subjektin Y.V; Vendimi nr.23, datë 13.01.2021 për subjektin V.P; Vendimi nr.22, datë 15.01.2016. Si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nga shqyrtimi i ditarit të bankës mbi likujdimin e tyrepër subjektet V.P, Y.V dhe Gj.S, rezulton se përgjatë vitit 2021 janë kryer likujdime të plota/pjesore në 3 raste në vlerën 2,285,200 lekë, *të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet*, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për likujdimin e subjektit Gj.S, në urdhrin nr.628, datë 01.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna të subjektit Gj.S, moslikujdimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbarimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Shkodër.
Kriteri: Nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar.
Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.
Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Shkodër.
Rëndësia:I Lartë.
Rekomandimi:Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likujdimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.
-Planifikimin e grafikut të likujdimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.
Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme për analizimin e vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, duke identifikuar personat përgjegjës dhe vendosjen e masave administrative ndaj tyre, si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me Sektorin Juridik të bashkëveprojnë për shmangien e penalizimeve të tilla financiare.

-Shpronësimetpër interespublik.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 *"Përshpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interespublik"*, Bashkia Shkodër, në cilësinë e subjektit në favor të të cilit bëhet shpronësimi për interes publik,për vitin 2021, paraqitet si vijon:

Tabela nr.10 Shpronësime

Nr	Pronari	Vlera e shpronësimit	Likuidimet nga Bashkia	Diferenca	Vlera e mbetur e palikujduar deri në 31.12.2021 Për pjesën e Ministrise
1	VKM nr. 623, date 24.09.2014 Shpronësim per objektin "Rikonstruksion rruga Stacioni i trenit Rruget A.Spahija, N.Luli, B.Bishanaku, Rr. Kalase, B.Pallate Q.Hardhiò, Çesk Shllaka	398,088	398,088	0	**0**
2	Shpronësime baze te VKM nr. 833, date 20.11.2019 "Per shpronësimin per interes publik per rik rruga Shkodër Velipojë ne emër te Xhemal Hamz Cufi	312,687		1,865,349	nuk është akorduar fond nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Me date 21.04.2021 është bere shkrese ministrisë me nr. 6299 prot per akordim fondi.
3	Shpronësime baze te VKM nr. 833, date 20.11.2019 "Per shpronësimin per interes publik per rik rruga Shkodër Velipojë ne emër te K.T.H	469,152			nuk është akorduar fond nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Me date 21.04.2021 është bere shkrese ministrisë me nr. 6299 prot per akordim fondi.
4	Shpronësime baze te VKM nr. 833, date 20.11.2019 "Per shpronësimin per interes publik per rik rruga Shkodër Velipojë ne emër te H.H.Rr	413,100			nuk është akorduar fond nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Me date 21.04.2021 është bere shkrese ministrisë me nr. 6299 prot per akordim fondi.
5	Shpronësime baze te VKM nr. 833, date 20.11.2019 "Per shpronësimin per interes publik per rik rruga Shkodër Velipojë ne emër te J.R.M	670,410			nuk është akorduar fond nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Me date 21.04.2021 është bere shkrese ministrisë me nr. 6299 prot per akordim fondi.
	Total	**2,263,437**	**398,088**	**1,865,349**	

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Faturat e palikuiduara brenda afatit 30 ditor.

Titulli gjetjes: Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor përgjatë vitit 2021, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i rradhës në likuidimin e tyre.

Situata: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Shkodër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2021, ky afat nuk është respektuar në 28 raste për vlerën 96,852,384 lekëpasqyruar në tabelën analitike nr.12, në Kapitullin ñAnekseò.

Tabela nr.11 përmbledhëse e faturave për vitin 2021

Artikulli	Sasia	Viti2021/lekë
230 - 231	26	95,676,480
602	2	1,175,904
Totali	**28**	**96,852,384**

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Faturat e mësipërme ndahen si më poshtë vijon:

- Për vitin 2021 - 26 fatura për shpenzime për investime në vlerën 95,676,480 lekë dhe 2 fatura për shpenzime korrente në vlerën 1,175,904 lekë.
- Në fillim të vitit 2021 vlera e faturave të palikuiduara (celja e llogaria 401-408 dhe celja e llogarisë 467) ka qenë 149,042,632 lekë dhe fund të vitit 2021 vlera e faturave të palikuiduara (teprica kreditore e llogarisë 401-408 dhe llogarisë 467) është 209,368,206 lekë, ose 60,325,574 lekë më tepër në krahasim me fillim-vitin 2021.

-Sa i përket likujdimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet rradha e likujdimit të tyre, pra fatura e parë likujdohet më parë, ilustruar me disa raste.

Konkretisht për rastin e detyrimit ndaj subjektit:

-S.M.O.V faturë e datës 11.08.2019 në vlerën 2,353,509 lekë, likujduar më datë 11.03.2021, ndërkohë që deri më darë 11.03.2021 janë likujduar fatura të mbërritura më vonë se fatura e subjektit të mësipërm, si p.sh., blerje uniforma për policinë bashkiake, faturë e datës 29.12.2020, likujduar më datë26.01.2021; blerje dekori, faturë e datës 14.12.2020 likujduar më datë 11.02.2021; mbikëqyrje e punimeve për asfaltimin e rrugës së varrezave Bleran ï Bardhaj, faturë e datës 27.11.2020, likujduar më datë 11.02.2021.

-E njëjta situatë si më sipër rezulton edhe për subjektin N, faturë e datës 26.07.2019, likujduar më datë 11.03.2021;

-Rr.G faturë e datës 14.08.2020, është likujduar më datë 12.02.2021, ndërkohë që janë kryer likujdime përpara kësaj date për detyrime të krijuara në vitin 2020, konkretisht është likujduar fatura e subjektit ñE.Sò në datë 26.01.2021, me faturë të datës 29.12.2020.

Për detyrimin ndaj subjektit ñLò sh.p.k i datës 28.12.2020, është likujduar më datë 24.02.2021, ndërkohë që përpara kësaj date janë likujduar detyrime të krijuara dhe faturuara subjekte të cilët kanë lëshuar faturë të datës 31.12.2021 konkretisht subjekti óôS.M.O.Vôô dhe është likujduar në datë 22.02.2021.

Kriteri: Pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar.

Shkaku: Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesën më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i radhës në likujdimin e detyrimeve të prapambetura.

Efekti: Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikujduara.

Rëndësia:I Lartë

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës për vitin 2021, në lidhje me investimet publike, rezultoi se nuk ka financim projektesh nga FSHZH/FZHR. Nga grandet dhe fondet e veta të Bashkisë Shkodër, për vitin 2021 janë lidhur 165kontrata për investimenë kapitale të trupëzuara dhe të pa trupëzuara për vlerën 309,383,811 lekë.

Sa i përket fondeve të alokuara nga Ministria e linjës për vitin 2021, rezulton se është financuar 1 projekt investimi (kontratë e lidhur në vitin 2020) me vlerë kontrate 72,079,645 lekë, pasqyruar në tabelën si më poshtë vijon:

Tabela nr.13 Fonde të deleguara për vitin 2021 dhe likujdimi i tyre

Nr	Objekti i Prokurimit	Vlera e debituar	Vlera kontratës	Operatori Ekonomik i shpallur fitues	Likujduar deri në 2021	Mbetur
1	Rikonstruksion i godinave ne pronesi te njesive te vetqeverisjes vendore per strehim social (Rikonstruksion i ish Konviktit te shkolles veterinare)	47,953,417	72,079,645	O	72,079,645	0

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Shkodër dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës . Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Konkluzion i përgjithshëm:
-Buxhetii Bashkisë Shkodër dhe PBA 2021-2023, në përgjithësi janë miratuar në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore të ligjit të buxhetit;
-Kanë ndodhur ndryshime në buxhetet fillestare (shtesa/pakësimi), të cilat në çdo rast janë miratuar me VKB;
-Ndryshimet buxhetore të shpeshta përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë të dobët në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.
-Për periudhën 2021-2023 në krahasim me planet vjetore, realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik për 12-mujorin është mesatarisht në masën 75 %, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 604 ñTransferta Korente të Brendshmeò, duke vijuar me transfertat për buxhetet familjare në masën ku përfshihet ndihma ekonomike dhe PAK, ndjekur nga shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore, si dhe realizimin më të ulët e kanë shpenzimet për mallra e shërbime dhe shpenzime kapitale.
-Nga shqyrtimi i kontratave të lidhura dhe listës së projekteve (E3 sipas PBA 2021-2023) me afat financimi 2021-2023, miratuar me VKB nr.63, datë 28.12.2020, i ndryshuar, u konstatua se në 8 raste, për kontrata të lidhura në vlerën 76,659 mijë lekë, nga Bashkia Shkodër janë ndërmarrë angazhime buxhetore mbi limitin vjetor të miratuar, si dhe pa pasur në dispozicion minimalisht 20% të vlerës së kontratës.
-Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Shkodër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2021, ky afat nuk është respektuar në 28 fatura për shpenzime për investime dhe shpenzime korrente në vlerën 96,852,384 lekë.

-Sa më sipërmbajnë përgjegjësi zj.V.A, ish Kryetar i Bashkisë, zj.B.M me funksion Drejtor i Drejtorisë së Financës,si dhe zj.T.H me funksion Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit.

2.2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

Në zbatim të pikës II.2, nënpika 2.6, të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1)Evidencat analitike të llogarive debitore për taksat dhe tarifat vendore.
2)Akt rakordimi me degën e thesarit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.
3)Evidencat e debitorëve për taksat dhe tarifat vendore për subjektet dhe për detyrimet familjare.
4)Të tjera dokumente për arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifat vendore.
5)Vendimet e Këshillit të Bashkisë për paketën fiskale.
6)Vendimet e Këshillit të Bashkisë për strukturën organike.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
1.Përshkrimi i situatës.

Nën pika 2.6. *Burimi krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe nxjerrja e detyrimeve tatimore e ndarë sipas viteve.*

1.Struktura e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për vitin 2021 me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 63, datë 28.12.2020 ñPër miratimin e buxhetit të vitit 2021dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar 2021 ï 2023ò, në pikën 6 të këtij vendimiështë miratuar numri i punonjësve, konfirmuar nga Prefekti Qarkut Shkodër me shkresën nr. 01/1 prot.,datë 14.01.2021. Me vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 2, datë 05.01.2021është miratuarstrukturaorganizativesipas drejtorive/sektorëve.

Me vendim të Kryetarit të Bashkisë Shkodër nr.62 prot.,datë 05.01.2021dhe në referencë të numrit total të punonjësve të miratua rnë VKB është miratuar struktura organizative sipas drejtorive/sektorëve, ku janë të detajuar dhe punonjësit për secilën nga drejtoritë, ku bën pjesë dhe Drejtoria e tëArdhurave, si më poshtë vijon:

-Drejtoria e të Ardhurave Vendore (*këtu e vijimDAV Bashkia Shkodër)*, kanë strukturën e saj **29 punonjës**[16]dhe është e ndarë në katër sektorë: Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Biznesit, Sektori i Regjistrimit dhe Vlerësimit të Taksave dhe Tarifave për Individin, Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit të të Ardhurave dhe Njësia e Inspektimit Tatimor dhe Kundërvajtjeve Administrative.

Për vitin 2021, pranë Bashkisë Shkodër ka funksionuar Drejtoria e të Ardhurave, struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Shkodër nga taksat dhe tarifat. Ky sektor në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave bashkëpunon edhe me sektor të tjerë pranë Bashkisë, si ai i pronave, pyjeve, urbanistikës, infrastrukturës, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim, si dhe roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim, dokument i cili i shërben subjektit për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

Titulli i gjetjes: Mangësi në strukturën organizative të Drejtorisë së Taksave Vendore.

Situata: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave si dhe kryqëzimi me VKB për miratimin e strukturës për vitin 2021 të Bashkisë Shkodër, rezulton se struktura e DAV Bashkia Shkodër nuk është plotësisht në funksion të realizimit të të ardhurave, pasi evidentohet mos krijimi i Sektorit të Menaxhimit të Borxhit tatimor. Alternimi i këtij sektori në përbërje të Sektorit të Kontrollit Terren është i papërshtatshëm, kjo nisur nga fakti se kanë natyra të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vetë dhe afate të përcaktuara. Gjithashtu theksojmë faktin se krijimi i këtij sektori është i domosdoshëm, duke pasur në konsideratë numrin e debitorëve të prapambetur në Bashkinë Shkodër, ku vetëm për kategorinë ñBiznesò debitorë të trashëguar nga viti 2020 janë 6568 subjekte.

-Në strukturën organizative të DAV Bashkia Shkodër, konstatohet se nuk është parashikuar pozicioni i përgjegjësit të sektorit të kontrollit në terren, duke sjellë që ky sektor të kontrollohet direkt nga Drejtori i DAV Bashkia Shkodër.

Kriteri: Kreun XI- ñMbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguarò, nenet 88 ï 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në RSHò i ndryshuar.

Nenin 3 në Ligjin nr.90/2012 ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò.

Shkronja ñdò në pikën 8 në nenin 8, shkronja ñfò në pikën 4 në nenin 9, si dhe shkronjën ñbò në pikën 3 në nenin 22 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar.

[16]Tabela e strukturës së DAV Bashkia Shkodër pasqyrohet në Kapitullin Anekse-Taksat dhe Tarifat Vendore.

Ndikimi/Efekti: Mungesa e stafit dhe mos përshtatja e strukturës më natyrën e menaxhimit të të ardhurave, çojnë në mos realizim të të ardhurave. Gjithashtu në gjykimin e grupit të auditimit, mungesa e pozicionit të përgjegjësit të sektorit, krijon ngarkesë të shtuar për pozicionin e Drejtorit të DAV, çka mund të ndikojë negativisht në monitorimin e realizimit të objektivave të këtij sektori, si dhe marrjen e masave konkrete për arritjen e këtyre objektivave.
Shkaku: Mungesa e marrjes së masave nga niveli drejtues i Bashkisë Shkodër për plotësimin e strukturës së DAV në funksion të realizimit të objektivave të kësaj drejtorie.
Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për plotësimin dhe përshtatjen e strukturës së DAV Bashkia Shkodër sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar Sektorin e Menaxhimit të Borxhit.

II.Taksat dhe Tarifat e aplikuara dhe arkëtuara nga Bashkia Shkodër.

Paketafiskale e Bashkisë Shkodër është miratuar me VKB nr.25, datë 20.12.2019, si dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër. Mbështetur në paketën fiskale të mësipërme në Bashkinë Shkodër, sipas sektorëve përkatës, janë aplikuar/mbledhur 36 lloje taksash dhe tarifash.
Për vitin2021 subjektet mbi të cilat janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër dhe Njësitë Administrative, ndahen në 3 kategori:
1.Biznes;
2.Familjar;
3.Institucione.
Kategoritë e mësipërme (përjashtuar institucionet) ndahen në disa nënkategori për efekt të nivelit të taksës/tarifës që aplikohet, konkretisht:
-Kategoria e parë ndahet në Biznes i Madh; Biznes i Mesëm; Biznes i Vogël; Tregtarët Ambulant.
-Kategoria e dytë për efekt të taksave/tarifave ndahet në familje që kanë në pronësi/përdorim banesa private, familje që jetojnë në apartamente, pensionist, familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, veteranët e luftës, invalid.

Tabela nr.1 Llojet e subjekteve mbi të cilët janë aplikuar taksat dhe tarifat vendore, sidhe numri i tyre.

Nr	Lloji	2021
1	Biznesi i Madh	1,177
2	Biznesi i Vogël	4,471
3	Ambulant	127
4	Institucione	53
5	OJF	144
6	Familje	42,439

Burimi: DAV Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Veç taksave dhe tarifave të mësipërme Bashkia Shkodër ka planifikuar dhe arkëtuar të ardhura nga disa lloje burimesh të ndryshme, si gjoba nga inspektorati i mbrojtjes së territorit, policia bashkiake, qira tokë bujqësore, pyjore, truall, ndërtesë, etj.

-Të gjitha sa më sipër, mbi planifikimin dhe realizimin e tyre në mijë lekë, për vitin 2021, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

	LLOJI I TAKSËS	Plani 2021	Fakti 2021	Në %
A	**TË ARDHURAT E VETA**	**877,420**	**738,309**	**84%**
A.I	TË ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE	373,082	259,082	69%
I.1	Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	7,650	6,974	91%

I.1.0	Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	50	139	
I.2	Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	179,343	160,406	89%
I.2.1	Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	144,500	138,703	96%
I.2.1.1	*Ndërtesa banimi*	*65,440*	55,689	85%
I.2.1.2	*Ndërtesa të tjera*	*79,060*	83,014	
1.2.2	Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	21,736	8,283	38%
1.2.3	Të ardhura nga taksa mbi truallin	13,107	13,421	
I.3	Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	15,000	12,967	86%
I.4	Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	155,044	65,687	42%
	Nga ndërtimet e reja	*124,035*	44,006	35%
	Ndertimet ne proçes legalizimi	*31,009*	21,680	70%
I.5	Të ardhura nga taksa e tabelës	15,995	12,909	81%
1.5.1	*Takse Tabele*	*8,797*	12,886	
1.5.2	*Takse Reklame*	*7,198*	23	0%
A.II	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	105,949	164,666	
II.1	Të ardhura nga taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve të përdorura	80,100	109,324	
II.2	Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	14,560	17,555	
II.3	Të ardhura nga taksa e rentës minerare	35	11	
II.4	Të ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	11,254	37,777	
A.III	TE ARDHURA NGA TARIFAT VENDORE	316,584	287,445	91%
III.1	Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	169,711	157,588	93%
III.1.1	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Familje	73,699	62,011	84%
III.1.2	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Institucione	512	721	
III.1.3	Të ardhura nga tarifë pastrimi nga Biznesi	95,500	94,856	99%
III.2	Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	39,767	32,719	82%
III.1.1	Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga Familje	23,998	20,449	85%
III.1.2	Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Institucione	125	138	
III.1.3	Të ardhura nga tarifë ndriçimi publik nga Biznesi	15,644	12,132	78%
III.3	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	22,972	20,111	88%
III.1.1	Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga Familje	9,602	7,967	83%
III.1.2	Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Institucione	160	138	86%
III.1.3	Të ardhura nga tarifë gjelbrimi nga Biznesi	13,210	12,005	91%
III.5	Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	84,134	77,028	92%
III.1.1	Nga tarifa shërbimie administrative, kontroll zhvillim territorit, AMTP,	3,604	5,707	
III.1.2	Nga tarifa për vulosje veterinere të bagëtive të therura	848	573	68%
III.1.3	Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit	1,050	866	82%
III.1.4	Nga tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike	4,508	5,528	
III.1.5	Nga tarifë për dhënie liçensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	5,000	6,543	
III.1.6	Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	580	11	2%
III.1.7	Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MKZ	660	1,591	
III.1.8	Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	45,000	40,470	90%
III.1.9	Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	500	0	0%
III.1.10	Nga dokumentat për tender, ankand etj.	12	22	
III.1.11	Nga tarifa të institucioneve të arsimit, kultures, sportit, etj	22,372	15,717	70%
III.1.11.1	*Biblioteka "Marin Barleti"*	*15*	12	80%
III.1.11.2	*Muzeumet*	*2,500*	1,340	54%
III.1.11.3	*Teatri "Migjeni"*	*1,800*	679	38%
III.1.11.4	*Qendra Kulturore e fëmijëve*	*177*	0	0%
III.1.11.5	*Pallati sportit " Qazim Dervishi"*	*650*	0	0%
III.1.11.6	*Stadiumi Loro Borici*	*800*	0	0%
III.1.11.7	*Qendra Komunitare*	*0*	0	0%
III.1.11.8	*Nga mensat (konviktet)*	*30*	69	
III.1.11.9	*Nga kopshtet*	*11,100*	9,055	82%
III.1.11.10	*Nga çerdhet*	*5,300*	4,562	86%
A.IV	TË ARDHURA TË TJERA	81,805	27,116	33%
IV.1	Të ardhura nga kundravajtjet administrative (Gjobat)	20,000	21,768	
IV.1.1	*Gjobe Këstí*	9,500	12,239	
IV.1.2	*Gjoba Policia Ndërtimore*	9,000	8,551	95%
IV.1.3	*Gjobe Gjendja Civile*	0	0	0%
IV.1.4	*Gjobe Policia Bashkiake*	1,500	978	65%
IV.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë	2,543	2,802	
IV.3	Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime	3,060	1,396	46%
IV.4	Grante nga ndihma nderkombetare	55,861	210	0%
IV.5	Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e sherbimeve	0		0%
IV.6	Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	0	0	0%
IV.7	Të ardhura nga privatizimi	0	0	0%
IV.8	Të ardhura te tjera	0	0	0%
IV.9	Të ardhura nga garanci financiare	341	301	88%
IV.10	TË ARDHURA NGA DONACIONET	0	639	0%
	Të ardhura nga shitja e titujve të pjesëmarrjes në ndërmarrjet shtetërore	0	23,987	0%

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për vitin 2021, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 877,420 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 738,309 mijë lekë ose 84%.
-Nga taksat e mësipërme, nivelin më të ulët të realizimit e ka taksa mbi tokën bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë, tarifa e pastrimit nga familjet.

-Debitorët sipas kategorive të tyre.
III.1.Biznesi dhe Institucionet

Titulli gjetjes: Debitorët ñBiznes dhe Institucioneò të cilët nuk kanë likujduar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, si dhe mosmarrja e masave shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.
Situata: Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga drejtoria e të ardhurave, ecuria e debitorëve për vitin2021, për tarifën e shërbimit, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, reklamës, tabelës, zënies së hapësirës publike, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë.

Tabela nr.14 Debitor (Biznesi dhe Institucione) 000/lekë

Nr	Lloji	Të Trashëguara 2020		Krijuar Brenda vitit 2021			
		Nr	Vlerë	Nr	Principal	Kamatvonesa	Progresive
1	Biznesi i Madh	927	212,440	968	68,528	5,803	286,771
2	Biznesi I Mesëm	0	0	0	0	0	0
3	Biznesi i Vogel	5641	381,835	3841	76,076	7,546	465,457
4	Institucione	24	2,168	28	22,976	90	25,234
	TOTAL	**6592**	**596,443**	**4837**	**167,580**	**13,439**	**777,462**

Burimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme vihet re se nga viti 2020 në vitin 2021 kemi një rritje të debitorëve të Biznesit të madh në numër dhe në vlerë, të biznesi i vogël kemi një ulje në numër por rritje në vlerë, dhe në institucione kemi rritje në numër dhe në vlerë, konkretisht për vitin 2021 kemi 1755 debitorë më pakdhe181,019 mijë lekë më tepër. Sa më sipër, konstatohet se në vitin 2021 në Bashkinë Shkodër dhe NJA, janë debitor 4837 subjekte në vlerën 181,019 mijë lekë, e ndarë si më poshtë vijon:
-968 subjekte ñBiznesi i Madhò në vlerën 74,331 mijë lekë
-3841 subjekte ñBiznesi i Vogëlò në vlerën 83,622 mijë lekë
-28 subjekte ñInstitucioneò në vlerën 23,066mijëlekë.
Në mënyrë progresive në fund të vitit 2021, janë 5972 subjekte debitore në vlerën 777,462 mijë lekë.
Taksa e fjetjes në hotel.
Për vitin 2021 taksa e fjetjes në hotel paraqitet me realizim në vlerën 12,967 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua se, ndjekja e kësaj taksë aplikohej bazuar në akt-konstatimet e Sektorit të Kontrollit Terren çdo datë 5 fillim muaj me tarifën e përcaktuar në VKB është 70 lekë/natë/personi për hotele nën 4 yje dhe 175 lekë për hotele 4-5 yje. Në këto akt-konstatime nuk evidentohet se sa netë kanë fjetur këto persona, por është evidentuar thjeshtë numër i tyre. Ky dokument (akt-konstatimi), nuk është i saktë, pasi në të nuk paraqitej panorama e plotë e lëvizjes (akomodimit) të personave në hotel, por thjeshtë bëhej një konfirmim i deklaratës së subjektit (vetëdeklarim). Pra nuk evidentohej, sa dhoma ka hoteli diponibël për aktivitet, sa shtretër janë për dhomë dhe gjithsej, sa dhoma janë aktive dhe sa jo. Të gjitha këto mangësi bëjnë që kjo taksë të mos jetë planifikuar sakë për numrin e personave që akomodohen në Bashkinë Shkodër, kryesisht kjo në sezonin veror ku numri i personave që akomodohen në hotele është edhe më i lartë, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër nga mos planifikimin i saktë të të ardhurave nga kjo taksë.

-Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, nga bizneset, nga ana e Drejtorisë së Ardhurave, janë dërguar njoftim detyrimet për subjektet debitorë dhe më pas janë dërguar disa shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë.

Tabela nr.15 Masat Shtrënguese

Ndikimi i aplikimit te mjeteve ligjore	Viti 2021		Nr debitorësh (biznes dhe institucione)	Mbuluar me masa shtrenguese
	Nr.i masave	Borxhi i mbledhur ne lek		
Përmes njotimit për pagesën			Nga 802 subjekte te bllokuar me vlere debitore 223,705,112 jane zhbllokuar 109 subjekte dhe jane lidhur 64 aktmarreveshje per shlyerjen me keste te detyrimeve dhe jane paguar ne total 32,867,614 leke nga detyrimet e prapambetura.	802 bllokime llogarish dhe 38 Urdhera Ekzekutimi
Njoftim dhe Kerkese per Pagese Debie	4950	157,634,398		
Njoftim per vendosje te masave siguruese				
Përmes masave shtënguese				
Bllokime të llogarive bankare	802	32,867,614		
Vendosje të barrës hipotekore në Kadastër				
Vendosje të barrës siguruese në DPSHTTR				
Vendosje të barrës ndaj titujve në QKB				
Përmes masave ekzekutuese				
Urdh-ekezuktimi kalim shume nga llog e tatimpaguesve ne llogari Bashkis	38	8,874,605		
Totali i mbledhur		199,376,617		
Planifikimi vjetor për mbledhjen e borxhit				

Burimi: DAV Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Në raport me numrin e subjekteve debitorë në fund të periudhës ushtrimore dhe subjekteve për të cilat është kërkuar në zbatim të ligjit masa shtrënguese, konstatohet se është i ulët, kështu nga 5972 subjekte fizik/ juridik me vlerë 238,686 mijë lekë është zbatuar marrje masa vetëm për 802 subjekte ose rreth 14% e totalit të subjekteve. Për më tej nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit, vendosje e barrës hipotekore, barrë siguruese, deri në kallëzim penal.

Kriteri: Neni 76, neni 114 dhe neni 117 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar;
-Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e Taksave Vendoreò, i ndryshuar;
-Neni 64 në Ligjin nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò, i ndryshuar;
-Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 ñPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò;
-VKB nr.63, datë 28.12.2020 Për miratimin e buxhetit të vitit 2021;
Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër në vlerën 777,462 mijë lekë.
Rëndësia:I Lartë
Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodërtë marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokim të llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës siguruese për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 777,462 mijë lekë.
Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.

III.2.Familjet

Titulli i gjetjes: Debitorët ñFamiljarò të cilët nuk kanë likujduar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Shkodër.

Situata:Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e shërbimit (gjelbërim, pastrim), ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, tokës bujqësore:

NJA	Nr. I familje sipas Gj.Civile	Nr. i kontrat te perjashtuar nga taksat/tarifat (lehtësira fiskale)	Nr. kontrata te faturuara	Gjithësej familje sipas DAV	Mbetja pa kontrata edhe pa faturuar
	1	2	3	4 = (3+2)	5 = (1-4)
Qytet	38,093	5,630	26064	31,694	6,399
Ana e malit	1,732	136	1179	1,315	417
Bërdicë	2,725	194	1223	1,417	1,308
Dajç	2,285	61	1872	1,933	352
Gur i Zi	3,522	301	1237	1,538	1,984
Pult	902	44	240	284	618
Rrethina	8,036	605	3473	4,078	3,958
Shalë + Shosh	1,727	64	555	791	936
Velipojë	3490	198	3292	3490	0
Postribë	3847	543	3304	3847	0
	65,117	7,776	42,439	50,387	14,730

Tabela nr.16 Numër familje debitore sipas NJA, të cilat rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa

		2021		
Nr	Njësi Administrative	Familje gjithësej të taksuara dhe tarifuara	Familje Debitore	Në %
		Nr	Nr	
1	Qendër	26064	7076	27%
2	Ana e malit	1179	906	77%
3	Bërdicë	1223	785	64%
4	Dajç	1872	1537	82%
5	Gur i Zi	1237	935	75%
6	Postribë	3304	2394	72%
7	Rrethina	3473	2029	58%
8	Velipoje	3292	1715	52%
9	Pult	240	144	60%
10	Shale	319	169	53%
11	Shosh	236	202	85%
	TOTAL	**42,439**	**17,892**	**42%**

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Gjithësej familje të taksuara sipas DAV janë 42,439 familje, ndërkohë rezultojnë 14,730 familje të cilat nuk taksohen/tarifohen, ku vetëm nëse do të bënim llogaritjet vetëm për tarifën e pastrimit, sipas nivelit të aplikuar në NJA, *rezultojnë 39,966,900 lekë të ardhura të munguara nga mospërfshirjen e numrit të plotë të familjeve.* Për familjet të cilat nuk janë të taksuara dhe tarifuar, DAV Bashkia Shkodër nuk ka ndërmarrë veprime ligjore për identifikimin dhe faturimin e tyre, ku mos taksimi çon në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar dhe paketën fiskale të vitit 2021.

Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se numri i familjeve debitore në mënyrë të grupuar, ndarë sipas Njësive Administrative, në fund të vitit 2021 është:

-7076 familje nga 26064 gjithësej të taksuara për Qytetin e Shkodrës, ose 27% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-906 familje nga 1179 gjithësej të taksuara për NJA Ana e Malit, ose 77% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-785 familje nga 1223 gjithësej të taksuara për NJA Bërdicë, ose 64% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-1537 familje nga 1872 gjithësej të taksuara për NJA Dajç, ose 82% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

-935 familje nga 1237 gjithësej të taksuara për NJA Gur i Zi, ose 75% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;
-2394 familje nga 3304 gjithësej të taksuara për NJA Postribë, ose 72% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;
-2029 familje nga 3473 gjithësej të taksuara për NJA Rrethina, ose 58% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;
-1715 familje nga 3292 gjithësej të taksuara për NJA Velipojë, ose 60% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;
-144 familje nga 240 gjithësej të taksuara për NJA Pult, ose 58% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;
-169 familje nga 319 gjithësej të taksuara për NJA Shalë, ose 58% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;
-202 familje nga 236 gjithësej të taksuara për NJA Shosh, ose 85% e tyre rezultojnë debitor në një ose disa taksa/tarifa;

Tabela nr.17 Numër familjesh debitore sipas llojit të taksës/tarifës

Nr	Familjar	Bashkia Shkodër dhe NJA Debitor 31.12.2021		TOTAL 2021
		Nr debitor/Taksë ose Tarifë	Vlerë	Progresive
1	Taksë Ndertese	16,014	187,880	
2	Taksë Trualli	15,517	7,203	
3	Taksë T.Bujq	7,761	26,160	
4	Tarifë Pastrimi	14,683	256,764	
5	Tarifë Ndricimi	14,290	82,484	
6	Tarifë Gjelberimi	7,368	31,835	
	TOTAL		**592,329**	**592,405**

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme, konstatohet se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Shkodër dhe NJA, janë:
-16,014 familje debitore në vlerën 187,880 mijë lekë për **taksën e ndërtesës**;
-15,517 familje debitore në vlerën 7,203 mijë lekë për **taksën e truallit**;
-7761 familje debitore në vlerën 26,160 mijë lekë për **taksën e tokës bujqësore;**
-14,683 familje debitore në vlerën 256,764 mijë lekë për **tarifën e pastrimit;**
-14,290 familje debitore në vlerën 82,484 mijë lekë, për **tarifën e ndriçimit;**
-7368 familje debitore në vlerën 31,835 mijë lekë, për **tarifën e gjelbërimit;**

-Sipas informacionit të pasqyruar në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit, llogaritë bankare të Agjentit tatimor Ujësjellës Kanalizime SHA kanë qenë të bllokuara nga shoqëri përmbarimore në bankat e nivelit të dytë, dhe si pasojë detyrimi që Ujësjellës Kanalizime SHA ka ndaj Bashkisë Shkodër nuk është transferuar në llogari të saj duke sjellë mosrealizim të ardhurash sipas planifikimit për vitin 2021 me një diferencë prej -50,466 mijë lekë, ose ndryshe -6% më pak të ardhura. Kjo vlerë ka ndikuar gjithashtu edhe në mosrealizimin e zërave kryesorë të të ardhurave si: taksa e ndërtesës, e truallit, tarifa e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit etj.*Nga DAV Shkodër për këtë situatë nuk janë marrë masat ligjore (aplikimin e gjobave) ndaj agjentit tatimor* UK SHA Shkodër, i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë ñFamiljarò.
Kriteri: Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 ñPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò;
Neni 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;

Ndikimi/Efekti:Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër në vlerën 592,329 mijë lekë, nga të cilat 50,466 mijë lekë, ose ndryshe -6% më pak të ardhura arkëtuar si rrjedhojë e bllokimit të llogarive bankare të UK SHA Shkodër.
Shkaku: Mos evidentimi i saktë i familjeve, çon në mos planifikimin dhe mungesë të ardhurash në Bashkinë Shkodër.
Situata e krijuar ndaj agjentit tatimor UK SHA Shkodër.
Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet strukturave përkatëse pranë Bashkisë Shkodër.
Rëndësia: I Lartë.
Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë ñFamiljeò, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit për vitin 2021, *rezultojnë 39,966,900 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër.*
Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efektmosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore nga abonentët familjarë, si rrjedhojë e bllokimit të llogarive bankare të UK ShA., Shkodër (në rolin e agjentit tatimor), vlerësimin e detyrimit që ka UK ShA Shkodër ndaj Bashkisë Shkodër si dhe aplikimin e penaliteteve ndaj UK Sha Shkodër.
Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 592,329 mijë lekë, me qëllim eleminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

III.3.Familje debitore për taksën e tokës bujqësore
Titulli i Gjetjes: Keqmenaxhim mbi procedurat e ndjekura të planifikimit, arkëtimit të taksës së tokës bujqësore.
Situata: Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithësej tokë bujqësore në Bashkinë Shkodër dhe Njësitë Administrative janë 16091 Ha, sipërfaqe e cila shërben si bazë për planifikimin e arkëtimeve nga kjo taksë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se taksa e tokës bujqësore është planifikuar në vlerën 21,736,000 lekë, ndërkohë sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit, bazuar në kategorinë e bonitetit dhe sipërfaqe tokë bujqësore, rezulton se taksa e tokës bujqësore e cila duhet të përllogaritet nga Bashkia Shkodër është 25,372,760 lekë/*3,636,760 lekë planifikuar më pak nga DAV Bashkia Shkodër, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë.*

Kategoria e tokës	Sip/HA Qendër	Sip/HA Nj.A.	Sip/HA Nj.A.	Sip/HA Nj.A.	Sip/HA NjA.	Vlera/Ha	Plani/Lekë
Kategoria II		**0**					
Kategoria III		**3071**				1960	6,019,160
Kategoria IV		**8361**				1610	13,461,210
Kategoria V		**3211**				1330	4,270,630
Kategoria VI		**1448**				1120	1,621,760
Kategoria VII							
Kategoria VIII							
e. Totali sip. ha sipas planifikimit		**16091**					**25,372,760**
Plani sipas DAV							21,736,000
Diferenca							3,636,760

Tabela nr.18 Debitor për taksën bujqësore për vitin 2021

NJ.A.	Debitor të trashëguar nga viti 2020	Debitorë 31.12.2021 (Lekë)					TOTAL DEBIA PROGRESIVE
		Familje me tokë bujqësore	Sip (m2)	Maturimi	Likujdimi	Debia	

Qendër	48	51	299,813	48,125	13,598	34,527	82,670
Ana e Malit	750	996	5,858,217	943,173	633,395	309,778	2,035,000
Bërdicë	595	834	7,728,640	1,171,861	811,196	360,665	1,501,400
Dajç	1,099	1,658	23,260,551	5,889,029	435,777	1,531,252	6,837,179
Gur i Zi	710	957	3,871,124	623,251	62,584	56,0667	1,980,808
Postribë	1,785	2,638	8,177,750	1.847097	672,508	1,174,589	5,702,876
Rrethina	1,410	1,092	2,162.,278	1,002,000	321,209	680,791	4,451,530
Velipoje	724	689	8,992,509	1,447,794	1,413,012	34,782	2,254,973
Pult	72	166	585,714	100,800	20,400	80,400	226,865
Shale	99	215	1,650,580	894,633	36,900	857,373	1,008,512
Shosh	134	203	463,696	109,449	35,400	74,049	217,798
Total	7,426	9,499	63,049,972	14,077,212	8,364,381	6,306,764	**26,299,610**

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme rezulton se vlera debitore gjithësej për taksën e tokës bujqësore, krijuar për vitin 2021 është6,306,764 lekë.Sipërfaqja e mësipërme e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore. Debia progresive deri më datë 31.12.2021 për këtë taksëështë në vlerën 26,299,610 lekë.

Kriteri: Nenin 23 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar.

Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 ñPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò;

Pika 1.2.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër miratuar me VKB nr.25 datë 20.12.2019, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos evidentimi i saktë i familjeve me tokë bujqësore, çon në mos planifikimin e saktë të kësaj takes dhe mungesë të ardhurash në Bashkinë Shkodër.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit midis drejtorie/sektorëve Bashkia Shkodër.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë, duke evidentuar familjet me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër.

Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës 26,299,610 lekë.

III.4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale (banim ose e kombinuar), objekt legalizimi.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e vendore e ASHK Shkodër, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën e vitit 2021, i paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Në Bashkinë Shkodër deri në 31.12.2021, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar lejet e legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Shkodër. Nga DVASHK Shkodër, janë dërguar dokumentet për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Njësive Administrative të Bashkisë Shkodër, ku përcaktohet edhe detyrimi për të paguar vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Shkodër, nuk janë marrë

masatshteruese(nga DAV Shkodër janë dërguar urdhrat për bllokimin e llogarive bankare) për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga DVASHK Shkodër. Në vijim paraqiten pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, funksioni, vendndodhja e objektit, sipërfaqja e objektit, detyrimi sipas personave që duhet të paguanin, për vitin2021, sipas tabelave më poshtë:

Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale - Viti 2021

Natyra e debitorëve	Detyrime gjithsej2021		Arkëtuar deri 31.12.2021		Debitorë me 31.12.2021	
	Person	Lekë	Person	Lekë	Person	Lekë
Taksainfrastrukture(legalizim)	568	40,492,140	104	10,726,080	464	29,766,060

Burimi: DAV Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i Gjetjes: Procedurat e ndjekura për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve informale që ndodhen në territorin e Bashkisë Shkodër.

Situata: Bazuar në të dhënat e marra nga Bashkia Shkodër u konstatua se, nuk janë marrë masa për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi, të pajisura me leje legalizimi nga DVASHK Shkodër konkretisht:

-Vlera debitore progresive është 231,342,984 lekë (220,380,615 lekë në fillim të vitit 2021 - 18,803,692 lekë likuidime gjatë vitit 2021 + 29,766,061 lekë debi e krijuar në vitin 2021).

Për vitin 2021 - vlera debitore progresive është ***29,766,061* lekë,** *e cila përfaqëson të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër*. Në numër personash të cilët posedojnë lejen e legalizimit dhe që nuk kanë shlyer detyrimin e taksës vendore të ndikimit në infrastrukturë është 464 posedues të lejeve të legalizimit.Për arkëtimin e vlerës debitore krijuar në vitin 2021 nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve informale, nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, por nga DAV Bashkia Shkodër janë dërguar vetëm urdhrat për bllokimin e llogarive bankare.

Kriteri: Nenet 91-93 në Kreun XI të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, si dhe pikën 2 të nenit 4, shkronjën ñcò të pikës 1 të nenit 22/5 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò të ndryshuar.

Ndikimi/Efekti:Të ardhura të munguara në vlerën 231,342,984 lekë.

Shkaku: Mungesa e marrjes së masave shtrënguese në mënyrë shteruese për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 231,342,984 lekë, për legalizimin e objekteve informale.

Në mënyrë të përmbledhur vlera e detyrimit tatimor, për taksa dhe tarifa (gjelbërim, pastrim, ndriçim, ndërtesë, truall, ndikim në infrastrukturë, reklama, tabelë, zënie të hapësirës publike, tregtim karburanti), në mënyrë progresive deri më datë 31.12.2021 është në vlerën 1,601,133 mijë lekë (426,803 mijë lekë krijuar brenda vitit 2021), nga të cilat:

-5972 subjekte (Biznes dhe Institucione) në vlerën 777,462 mijë lekë;

-17,892 familje në vlerën 592,329 mijë lekë (tarifë shërbimi, ndriçimi, taksë ndërtese, trualli, taksë për tokën bujqësore);

-2264 subjektepër taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtesave informale në vlerën 231,342 mijë lekë.

Borxhi tatimor i krijuar brenda vitit 2021 është në vlerën 426,803 mijë lekë nga të cilat:
-4837 subjekte (Biznes dhe Institucione) në vlerën 181,019 mijëlekë;
-216,018 mijë lekë debitorë për kategorinë ñfamiljarò;
-464 subjekte për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtesave informale në vlerën 29,766 mijëlekë.

Konkluzion i përgjithshëm.
Përgjatë periudhës 01.01.2021-31.12.2021 Bashkia Shkodër ka treguar një performancë jo të mirë në vlerësimin dhe marrjen e masave të nevojshme për arkëtimin e detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën 1,601,133 mijë lekë për buxhetin e Bashkisë.

IV.1.Debitor nga gjoba të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit dhe Policia Bashkiake.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, rezulton në fund të vitit 2021 në mënyrë progresive nga gjobat e vendosura nga Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit kryqëzuar me informacionin e pasqyruar në akt-rakordimin për të ardhurat dhe pasqyrat financiare të vitit 2021[17], të cilat janë në formë të prerë dhe që nuk pengohet ekzekutimi i tyre, janë 254,345,500 lekë gjoba pa u arkëtuar, nga të cilat 36 gjoba në vlerën 173,468,000 lekë janë të vitit 2021, si dhe debia progresive deri më datë 31.12.2021 nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake,është në vlerën 1,669,073 lekë, nga të cilat në vitin 2021 janë 1405 gjoba në vlerën 1,650,022 lekë.

Tabela nr.19 Gjobat e IMTV Bashkia Shkodër

Nr.	Subjekti	Vendimi i gjobës	Statusi Juridik	Vlera Gjobës	Kamata	Vlera e Detyrimit
1	F.A	Nr.925, datë 07.01.2021	Në fuqi	500,000	300,000	800,000
2	S.D	Nr.928, datë 15.01.2021	Në fuqi	1,000,000	60,000	1,060,000
3	A.C	Nr.930, datë 25.01.2021	Në fuqi	5,000,000	300,000	5,300,000
4	L.P	Nr.933, datë 25.01.2021	Në fuqi	5,020,000	312,000	5,332,000
5	D.L	Nr.935, datë 01.02.2021	Në fuqi	500,000	-	500,000
6	P.N	Nr.936, datë 05.02.2021	Në fuqi	5,000,000	3,000,000	8,000,000
7	A.C	Nr.937, datë 09.02.2021	Në fuqi	20,000	12,000	32,000
8	L.P	Nr.938, datë 11.02.2021	Në fuqi	20,000	12,000	32,000
9	E.H	Nr.942, datë 12.02.2021	Në fuqi	500,000	300,000	800,000
10	L.M	Nr.943, datë 12.02.2021	Në fuqi	5,000,000	3,000,000	8,000,000
11	T.M	Nr.944, datë 15.02.2021	Në fuqi	5,000,000	3,000,000	8,000,000
12	N.B	Nr.946, datë 24.02.2021	Në fuqi	500,000	300,000	800,000
13	S.H	Nr.950, datë 04.03.2021	Në fuqi	500,000	300,000	800,000
14	L.M	Nr.951, datë 12.03.2021	Në fuqi	5,020,000	312,000	5,332,000
15	D.J	Nr.954, datë 31.03.2021	Në fuqi	5,000,000	3,000,000	8,000,000
16	G.T	Nr.966, datë 03.06.2021	Në fuqi	2,800,000	1,680,000	4,480,000
17	F.T	Nr.967, datë 03.06.2021	Në fuqi	5,000,000	3,000,000	8,000,000
18	D.M	Nr.968, datë 04.06.2021	Në fuqi	50,000	30,000	80,000
19	G.U	Nr.969, datë 04.06.2021	Në fuqi	50,000	30,000	80,000
20	P.M	Nr.976, datë 18.06.2021	Në fuqi	35,000	21,000	56,000
21	D.M	Nr.982, datë 01.06.2021	Në fuqi	8,400,000	5,040,000	13,440,000
22	H.G	Nr.983, datë 06.07.2021	Në fuqi	8,960,000	5,376,000	14,336,000
23	S.Sh	Nr.985, datë 14.07.2021	Në fuqi	50,000	30,000	80,000
24	V.G	Nr.986, datë 21.07.2021	Në fuqi	500,000	300,000	800,000
25	A.P	Nr.987, datë 23.07.2021	Në fuqi	10,000	6,000	16,000
26	D.M	Nr.988, datë 26.07.2021	Në fuqi	4,200,000	2,520,000	6,720,000
27	S.H	Nr.992, datë 28.07.2021	Në fuqi	500,000	300,000	800,000
28	P.N	Nr.993, datë 02.08.2021	Në fuqi	10,020,000	6,012,000	16,032,000
29	X.P	Nr.994, datë 04.08.2021	Në fuqi	5,000,000	3,000,000	8,000,000
30	M.B	Nr.998, datë 09.09.2021	Në fuqi	2,240,000	1,344,000	3,584,000
31	L.L	Nr.999, datë 09.09.2021	Në fuqi	11,900,000	7,140,000	19,040,000
32	D.Ç	Nr.1001, datë 24.09.2021	Në fuqi	3,080,000	1,848,000	4,928,000
33	N.G	Nr.1004, datë 04.11.2021	Në fuqi	3,500,000	2,100,000	5,600,000
34	D.V	Nr.1005, datë 05.11.2021	Në fuqi	5,000,000	3,000,000	8,000,000

[17] Llogaria analitike nr.468

35	A.C	Nr.1006, datë 11.11.2021	Në fuqi	2,800,000	1,680,000	4,480,000
36	B.L	Nr.1007, datë 19.11.2021	Në fuqi	1,330,000	798,000	2,128,000
	Total			**114,005,000**	**59,463,000**	**173,468,000**

Burimi: IMTV Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Tabela nr.20 Gjobat e Policisë Bashkiake Shkodër

Gjoba Policia Bashkiake		**Nr**	**Vlerë**	**Paguar**	**Debi Nr.**	**Debi vlerë**
Viti	2021	1509	2,090,000	439,978	1405	1,650,022
	Total					

Burimi: DAV Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Titulli i Gjetjes: Procedurat e ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake Shkodër.

Situata: Nga auditimi i procedurave të ndjekurapër arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2021 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër në vlerën 256,014,573 lekë, nga të cilat:

-Gjobat e IMTV të paarkëtuara janë gjithësej 254,345,500 lekë (36 gjoba në vlerën 173,468,000 lekë i përkasin vitit 2021);

-Gjobat e Policisë Bashkiake të paarkëtuara janë gjithësej 1,669,073 lekë, nga të cilat në vitin 2021 janë pa u arkëtuar 1405 gjoba në vlerën 1,650,022 lekë;

Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse[18]. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga IMTV Shkodër, rezulton se për gjobat e mësipërme është bërë kërkesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë (GJSHP) Shkodër për lëshimin e urdhrit për ekzekutimin e tyre nëpërmjet përmbarimit. Në vijim nga IMTV Shkodër i janë përcjellë vendimet e GJSHP Shkodër zyrave të përmbarimit për ekzekutimin dhe arkëtimin e gjobave të vendosura, por në vazhdim nuk administrohet informacion se cilat janë masat e marra nga zyrat e përmbarimit, si sekuestrimin e pasurive të luajtshme/paluajtshme për likujdimin e gjobës, të cilat në gjykimin e grupit të auditimit vonojnë procesin e arkëtimit të gjobave dhe reduktojnë investimet nga buxheti i Bashkisë Shkodër.

Kriteri: Neni 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 ñPër organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunësò, i ndryshuar.

Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò.

Kreun IV.3.8 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër.

Ndikimi/Efekti:Të ardhura të munguara në vlerën254,345,500 lekë**.**

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës dhe mosndjekja plotësisht e procesit të arkëtimit të gjobave të vendosura.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve të mësipërm, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 254,345,500 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Kryeinspektori i IMTV Shkodër, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proçes shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të

[18] Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 ñPër organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunësò, i ndryshuar, ñPër shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmujor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative"; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, si dhe Kreun IV.3.8 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër.

luajtshme/paluajtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamat-vonesa) të palëve të treta ndaj Bashkisë Shkodër. Për çdo rast, kur nga përmbaruesit nuk merren të gjitha masat e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, Bashkia Shkodër tëi drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që nga kjo e fundit të aplikohen penalitetet ndaj përmbaruesve.

V.Kontratat e qirave.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore për Administrimin/menaxhimin e fondit pyjor kullosor,BashkiaShkodërkalidhurkontratapërdhëniemeqirapërshfrytëziminefonditpyjorkullos orpërantenatë Telefonisë Celularë BST, gjithsej 7kontratat me tëdhënasi mëposhtë:

Nr.	Qiramarrësi	Kontrata	AfatiiLidhjes	Sipërfaqe	Vleralek/vit
1	O.T	Antene e telefonisë	01.10.2017-30.09.2022	205m^2	234,445
2	O.T	Antene e telefonisë	01.10.2017-30.09.2022	205m^2	179,325
3	O.T	Antene e telefonisë	01.10.2017-30.09.2022	205m^2	186,500
4	O.T	Antene e telefonisë	28.09.2018-27.09.2023	250m^2	281,250
5	O.T	Antene e telefonisë	19.08.2018-18.08.2023	250 m^2	281,250
6	O.T	Antene e telefonisë	18.09.2021-17.09.2026	250 m^2	281,500
7	Z.M	Kullotje bagetish	01.05.2018-30.04.2027	1 HA	3,750

Burimi: DAV Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nr.	Qiramarrësi	Zona	Objekti	Afati (vite)	Dt kontratës	Detyrim vjetor, viti 2021 (lek)	Paguar (lek)
1	Shoqëria "B.T" Sh.a.	Rruga 28 Nëntori	ZK 8594, Nr. pasurie 4/250, sipërfaqe 7.5m^2	1 vit	Nr. 18758 Prot, Dt. 11.12.2020	15,660	15,660
2	Subjekti "B.V" Sh.p.k	Rruga Nacionale Shkodër- Grudë e Re	ZK 1869, Nr. pasurie 254/1, sipërfaqe 12m^2	1 vit	Nr. 506 Prot, Dt. 12.01.2021	25,056	25,056
3	Subjekti "S.Sh"	Bulevardi Bujar Bishanaku	ZK 8591, Nr. pasurie 7/39, sipërfaqe 155m^2	1 vit	Nr. 903 Prot, Dt. 18.01.2021	323,640	323,640
4	m.d	Rruga 13 Dhjetori,	ZK 8594, Nr pasurie 4/255, sipërfaqe 27m2	1 vit	Nr. 10224 Prot, Dt. 16.06.2021	56,376	56,376
5	Shoqëria "F" Sh.p.k	Dobraç	ZK 1495, Nr.pasurie 152/2, siperfaqe totale 1131m^2	5 vite	Nr.20746 Prot, Dt. 22.11.2021	128,700	128,700

-Nga auditimi i kontratave të qiradhënies rezultoi se janë kryer likuidimet nga subjektet qiramarrës.

VI.(Për tarifën e lëshimit të licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, të Bashkisë Shkodër).

-Për vlerësimine veprimtarisë së Bashkisë Shkodër mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e Taksave Vendoreò, i ndryshuar;

-Ligj Nr.9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;

-Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr.212, datë 16.3.2016 ñPër përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)ò

-VKB për miratimin e paketës fiskale, përkatësisht VKB nr.25, datë 20.12.2020 për vitin 2020-2021 e në vijim, në të cilën është përcaktuar tarifa e lincencimit, si dhe sektori përgjegjës për lëshimin e licencës, faturës së arkëtimit;

-Dosjet e licencimit të subjekteve, me përmbajtje: Licenca e dhënë për ushtrim aktiviteti, Ekstrakti i rregjistrimit në QKB (në të cilin pasqyrohet lloji aktivitetit dhe vendet e ushtrimit

të aktivitetit nga subjekti në Bashkinë Shkodër dhe NJA, që korrespondon me periudhën 01.01.2021-31.12.2021), Akti teknik i lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial; Leje mjedisore për ushtrim aktiviteti, Raporti teknik i lëshuar nga shërbimi i zjarrëfikses, Projekti teknik i vendit ku do të ushtrohet aktiviteti, vendosja e depozitave, autorizimet për pagesë, faturat e arkëtimit dhe pagesa e kryer nga subjekti;
-Rregullore e brendshme e Bashkisë Shkodër, e miratuar me vendim të Kryetares së Bashkisë me nr. 96 datë 20.03.2017, në të cilën përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për drejtorinë e shërbimeve publike dhe ndjekjes së investimeve të infrastrukturës, specialisti i sinjalistikës, transportit dhe mobilitetit.
-Gjithashtu u kryqëzua informacioni i sjellë me bazën e të dhënave të subjekteve që kanë ushtruar aktivitet në Bashkinë Shkodër dhe NJA, bazën e të dhënave të Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial, institucioni që inspekton subjektet e tregtimit të karburanteve.

Titulli i Gjetjes: Menaxhimi i të ardhurave nga tarifa e licencimit të subjekteve që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.
Situata:Në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Shkodër dhe në Njësitë Administrative në vartësi Shkodër, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Guri i Zi, Postribë, Pult, Rrethinat, Shalë, Shosh dhe Velipojë, na u vendosën në dispozicion dosjet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, pasqyruar si më poshtë vijon:

Tabela nr.21 Subjektet për të cilat administrohet dosje fizike në Bashkinë Shkodër

1	K	Rruga "Inxh. Gjovalin Gjadri"
2	K	Bulevardi "Zogu I"
3	K	Rruga nacionale Shkoder-Hani Hotit, Dobraç
4	O	Rruga "Pal Engjelli"
5	O	Pranë Drejtorisë së Policisë Qarku Shkodër
6	A	Rruga "Mbreti Gent"
7	K.B&B	Shtoj i Ri
8	D	Hot i Ri
9	G	Dajç, Dajç Bregu i Bunës
10	A/SH	Rruga "Edit Durham"
11	N Sh.p.k	Gur i Zi, Shkoder
12	"L"	Rruga "Bujar Bishanaku"
13	D.G	Gomsiqe e Re
14	G.C	Rruga "Dasho Shkreli"
15	G.C	Rruga "Pazar"
16	G.C	Draçin
17	G.C	Beltojë, Rruga nacionale Shkodër-Lezhë
18	G.C	Beltoje, Rruga nacionale Lezhë-Shkodër
19	G.C	Oblike, Rruga nacionale Shkodër-Muriqan
20	G.C	Rruga "Inxh. Gjovalin Gjadri"
21	L.A	Pazar, Shkodër
22	L.A	Rruga "Agron", Bahçallek
23	L.A	Rruga "Gjon Buzuku"
24	A.P Sh.p.k	Rruga nacionale Muriqan-Shkoder
25	A.B	Mes, Rruga nacionale Mes-Shkodër
26	D	Rruga "Vëllezerit Frashëri"
27	D	Zues, Rruga Shkodër-Muriqan
28	K 2008	Mes
29	I Sh.p.k	Shtoj i Ri, Qendër
30	L-T	Mbisukë
31	B.M Sh.p.k	Postribë
32	D.O	Rruga "Mbreti Gent"
33	J & M L	Fshat i Ri, Rruga nacionale Mes-Shkodër
34	A Sh.p.k	Rruga Tirana
35	A Sh.p.k	Bërdice e Sipërme,
36	J	Rruga "Faik Konica"
37	K	Berdicë e Sipërme
38	A.E shpk	Rruga "Kol Prela"
39	G.O	Shtoj i Ri, Rruga nacionale Shkodër-Hani Hotit
40	G-O	Rruga "Pazarit"
41	R.2R.P	Rruga "Tiranës"

42	J.A	Rruga "Agron", perballe Kishes se Zojes.;
43	J.A	Dobraç, Rruga nacionale Shkodër- Koplik,
44	K	Shtoj i Ri, Rruga nacionale Shkodër-Koplik
45	D.P	Rruga "Fetih Dizdari"

Burimi: DAV dhe Drejtoria e Shërbimeve, Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sipas të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Shkodër, për vitin 2021 ushtrojnë këtë aktivitet 45 subjekte, ku 14 prej tyre janë liçensuar, si dhe kanë paguar vlerën e tarifës prej 15,536,630 lekë (pasqyruar në tabelën nr.19 më poshtë).

-Nga numri i stacioneve të mësipërme u konstatua se në 28 prej tyre është ushtruar aktivitet pa u pajisur me licencën përkatëse, konkretisht:

- O pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- A pa licencë për periudhën 01.01.2019-31.12.2021;
- K.B&B pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- G pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021
- N sh.p.k pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- D.G pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- G.C pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- G.C pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- G.C pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- G.C pa licencë për periudhën 01.01.2021-01.12.2021;
- A.P pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- D pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- D pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- I Sh.p.k pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- L-T pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- B.M sh.p.k pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- D.O pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- J&M L pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- A sh.p.k pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- A sh.p.k pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- J pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- K pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- A.Esh.p.k pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- G.O pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- G-O pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- R.2R.P pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- J.A pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- J.A pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- K pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;
- D.P pa licencë për periudhën 01.01.2021-31.12.2021;

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, sa i përket masave të marra për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit, rezulton se Drejtoria e Shërbimeve Publike, pranë Bashkisë Shkodër, përgjatë muajit Mars 2022 i është drejtuar me shkresë subjektit përkatës për pajisjen me licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke vendosur në dijeni Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Gjithashtu përgjatë vitit 2021 ka patur korrespondencë shkresore ndërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së të Ardhurave, Policisë Bashkiake, për penalizimin e subjekteve që nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit në tregtimin e karburanteve.

-Pra sa më sipër konstatohet se përgjatë vitit 2021 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e subjekteve për detyrimin e pajisjes me licencë për ushtrimin e aktivitetit, njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë nëpikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017.
-Në mënyrë të përmbledhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, mosmarrjen e masave shtrënguese deri në kallëzimin penal (në vitin 2021) në mënyrë shteruese për arkëtimin e tarifës së licencimit nga DAV Bashkia Shkodër, konstatohet se nga 18 subjekte për 20 stacione shitje të karburantit nuk është kryer pagesa e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të *ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodërnë vlerën 13,871,692 lekë.*
-Në kuptim të përcaktimit të bërë në shkronjën "h" të pikës 40.17 të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Shkodër, mbanë përgjegjësi zj.E.K, specialiste e sektorit të sinjalistikës, transportit dhe mobilitetit, sidhe bazuar në Kreun III.4.5 të Paketës Fiskale, z.Gj.K Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave.

Tabela nr.22Subjektet që kanë ushtruar/ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve në territorin e Bashkisë Shkodër

Nr.	Subjekti	Adresa ku ushtron aktivitet sipas QKB	Pajisur me Licencë		Diferenca
			Po	Jo	
1	K	Rruga "Inxh. Gjovalin Gjadri"	po		-
2	K	Bulevardi "Zogu I"	po		-
3	K	Rruga nacionale Shkoder-Hani Hotit, Dobraç		jo	948,331
4	O	Rruga "Pal Engjelli"		jo	-
5	O	Pranë Drejtorisë së Policisë Qarku Shkodër	po		-
6	A	Rruga "Mbreti Gent"		jo	943,331
7	K.B&B	Shtoj i Ri		jo	959,997
8	D	Hot i Ri	po		-
9	G	Dajç, Dajç Bregu i Bunës	po		-
10	A/SH	Rruga "Edit Durham"	po		-
11	N Sh.p.k	Gur i Zi, Shkoder		jo	-
12	"L"	Rruga "Bujar Bishanaku"	po		-
13	D.G	Gomsiqe e Re		jo	463,333
14	G.C	Rruga "Dasho Shkreli"		jo	416,665
15	G.C	Rruga "Pazar"	po		-
16	G.C	Draçin		jo	-
17	G.C	Beltojë, Rruga nacionale Shkodër-Lezhë	po		-
18	G.C	Beltoje, Rruga nacionale Lezhë-Shkodër	po		-
19	G.C	Oblike, Rruga nacionale Shkodër-Muriqan		jo	-
20	G.C	Rruga "Inxh. Gjovalin Gjadri"		jo	1,759,997
21	L.A	Pazar, Shkodër	po		-
22	L.A	Rruga "Agron", Bahçallek	po		-
23	L.A	Rruga "Gjon Buzuku"	po		-
24	A.P Sh.p.k	Rruga nacionale Muriqan-Shkoder		jo	959,997
25	A.B	Mes, Rruga nacionale Mes-Shkodër	po		-
26	D	Rruga "Vëllezerit Frashëri"		jo	-
27	D	Zues, Rruga Shkodër-Muriqan		jo	-
28	K 2008	Mes	po		-
29	I Sh.p.k	Shtoj i Ri, Qendër		jo	959,997
30	L-T	Mbisukë		jo	759,997
31	B.M Sh.p.k	Postribë		jo	959,997
32	D.O	Rruga "Mbreti Gent"		jo	-
33	J & M L	Fshat i Ri, Rruga nacionale Mes-Shkodër		jo	959,997
34	A Sh.p.k	Rruga Tirana		jo	716,665
35	A Sh.p.k	Bërdice e Sipërme,		jo	233,332
36	J	Rruga "Faik Konica"		nuk është territor	
37	K	Berdicë e Sipërme		jo	-
38	A.E shpk	Rruga "Kol Prela"		nuk është territor	
39	G.O	Shtoj i Ri, Rruga nacionale Shkodër-Hani Hotit		jo	849,998
40	G-O	Rruga "Pazarit"		jo	133,232
41	R.2R.P	Rruga "Tiranës"		jo	413,332
42	J.A	Rruga "Agron", perballe Kishes se Zojes.;		jo	216,665

43	J.A	Dobraç, Rruga nacionale Shkodër- Koplik,		jo	216,665
44	K	Shtoj i Ri, Rruga nacionale Shkodër-Koplik		jo	516,832
45	D.P	Rruga "Fetih Dizdari"		jo	483,332
	TOTAL				**13,871,692**

Kriteri: Pikën 2 të nenit 4 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e Taksave Vendoreò, i ndryshuar.
Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja ñbò në pikën 1 në nenin 131 *"...nuk i paguan ato në buxhet"* të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar.
Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017.
Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër në vlerën 13,871,692 lekë.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.
Rëndësia: I Lartë
Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt tõ drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët ndërmjet Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë.
Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Shkodër të zbatojë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, për arkëtimin e detyrimeve ndaj subjekteve të cilat kanë pasur licencë të ushtrimit të aktivitetit, por nuk kanë paguar tarifën përkatëse, në vlerën 13,871,692 lekë në total.

VII. Për realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në prokurimet e fondeve publike nga Bashkia Shkodër.

Për vlerësimine veprimtarisë së Bashkisë Shkodër mbi arkëtimin e tarifës së pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit nga Bashkia Shkodër, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:
-VKB për miratimin e paketës fiskale, përkatësisht VKB nr.25, datë 20.12.2019 për vitin 2021;
-Evidenca e prokurimeve me fonde publike 01.01.2021 - 31.12.2021;
-Faturimi i detyrimit dhe pagesa.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
1.Përshkrimi i situatës.
Nënpika 2.6 e Programit të Auditimit. Burimi i krijimit të të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor / nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.
Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi dhe sipas dokumenteve të paraqitura, u auditua dokumentacioni për subjektet e ndërtimit, (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Shkodër,) të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike.

OE	Detyrimi
C	47,000
S	5,833
N	5,833

Totali	**58,666**

Titulli i Gjetjes: Procedurat e kryera për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në territorin e Bashkisë Shkodër.
Situata:Në auditimin e kryer për ndjekjen e procedurave në krijimin e të ardhurave nga tarifat vendore për pastrimin, ndriçimin ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi me fondet e Bashkisë Shkodër/Buxheti i Shtetit, u konstatua se nga DAV, Bashkia Shkodër, nuk është aplikuar dhe nuk është arkëtuar tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave urbane, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë, të cilat janë shpallur fitues në prokurimet e zhvilluara dhe kanë lidhur kontratat për kryerje punime të ndryshme ndërtimi, me fonde publike. Nga përllogaritjet e kryera rezulton se për vitin 2021 në 3 raste, *subjektet e ndërtimit nuk janë ngarkuar me detyrime për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit në vlerën 58,666 lekë, vlerë e cila përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodër.*
Kriteri: Shkronja ñaò e pikës 5 të nenit 35 në Ligjin nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò, i ndryshuar;
Pika 10 e nenit 3 dhe pika 2 në nenin 18 të Ligjit nr. 68/2017 ñPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò.
Kreu III.1 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër.
Ndikimi/Efekti:Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër në vlerën 58,666 lekë.
Shkaku: Mos marrja e masave për ndjekjen dhe arkëtimin e të ardhurave nga strukturat përgjegjëse.
Rëndësia: I Mesëm.
Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave të nxjerrë njoftim detyrimin për tarifën e shërbimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej 58,666 lekë.

Përdorimi i të ardhurave.
-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2021 është realizuar në vlerën 738,309 mijë lekë, ose **42%** e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2021, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për investime dhe shpenzime operative.

Tabela nr.23 Përdorimi i të ardhurave 2021

Art.	Emertimi	Fakt 2021
		Te ardhurat e veta
230+231	Investime	337,379
600	Paga	60,411
601	Sigurime Shoqërore	11,191
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	248,257
604	Transferta Korente të Brendshme	66,806
606	Trans. per Buxh. Fam. & Individ	1,847
	Total	**725,891**

Burimi: Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit KLSH-së

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar në krye të herës, llojin e mangësive të identifikuara si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi:
1.Zj.V.A, ish Kryetare e Bashkisë Shkodër.
2.Z.G.K, Drejtor i Drejtorisë të Ardhurave.
3. Z.F.K, Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Familjare.
4. Zj. E.K, Përgjegjës i Sektorit tëRegjistrimit dhe Vlerësimit të Biznesit.
5. Z. G.N, Kryeinspektor i Policisë së Bashkisë Shkodër.
6. Zj. E.K, Specialiste e sektorit të sinjalistikës, transportit dhe mobilitetit.

III.2.3. Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe udhëzimine MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.

2.3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

2.3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

2.3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

1. <u>Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.</u>

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetinò dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2021, <u>konkretisht:</u>

<u>Pasqyrat Financiare të vitit 2021.</u>

- Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2021 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:
  - Pasqyrat financiare të vitit 2021;
  - Centralizatori/Libri i madh;
  - Ditari i Bankës;
  - Ditari i Arkës;
  - Ditari i Magazinës;
  - Ditari i Pagesave;
  - Ditari i Veprimeve të ndryshme;
  - Aktrakordimet me Degën e Thesarit Shkodër;
  - Inventarët etj.

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2021 janë hartuar dhe depozituar më datën 23.03.2022 në Degën e Thesarit Shkodër, brenda afatit ligjor.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm dhe i mbështetur *në testet e kontrollit dhe testet thelbësore të transaksioneve* për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar: Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në Bashkinë Shkodër, është realizuar në mbështetje të kërkesave të

ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"* akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara. Pasqyrat financiare janë plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe formatet e miratuara nga Ministria e Financave.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.

- **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2021 janë:**

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasqyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);

- Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, ku janë është dhënë informacion mbi:

- Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Shkodër me NIPT K36813001H;
- Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2021-31.12.2021;
- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Data e hartimit të Pasqyrave Financiare, 23.03.2022;
- Përgatitur nga zj.M.D;
- Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Shkodër me shkresën nr.4426, datë 23.03.2022, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër zj. V.A.

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimin financiar janë Aktrakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Shkodër të konfirmuara dhe nënshkruara nga NZ dhe NA i Bashkisë Shkodër, kontabilisti dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Shkodër.

-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike. Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:
Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.
b. Kontrolle të llogarive dhe dokumenteve.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=76,162,943,721 lekë.**
- Aktivet 78,040,202,062 lekë
- Pasivet 1,877,258,340lekë
- Aktivet neto 76,162,943,721lekë

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën **2,326,520,466lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 ñMjetet monetare dhe ekujvalentet e tyreò në shumën 720,169,965 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 ñGjendje inventari qarkulluesò në shumën 48,472,627 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 ñLlogari të arkëtueshmeò në shumën 1,554,501,654 lekë dhe
- ñTë tjera aktive afatshkurtraò në shumën 3,376,220 lekë.
- Vlera e llogarisë 520 ñDisponibilitete në thesarò në shumën 717,169,979 lekë, përbëhet nga: gjendja e fondeve ne thesar me 31.12.2021 në shumën 623,872,734 lekë; gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 93,297,245 lekë.
- Mjetet në ruajtje përbëhen nga ndalesat e 5 % te garancisë së punimeve.

-Gjendja e llogarisë nr.520, nr.532 dhe nr.512 *"Disponibilitete në Thesar", "Vlera të tjera" dhe "Mjete monetare në bankë",* sipas mbylljes së bilancit të vitit 2021 është në vlerën prej 720,169,965 lekë dhe në mbyllje të vitit 2020 në vlerën prej 675,358,445 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V ñTeprica në fillim të vitit ushtrimorò në vlerën 675,358,445 lekë dhe rubrikën VI ñTeprica e Likujditeve në fund të vitit ushtrimorò në vlerën 720,169,965 lekë. *(sipas formatit F3 "Pasqyra e flukseve monetare")*

Rakordimi i llogarive me degën e thesarit, llogaria nr.520 ñDisponibilitete në Thesarò.

Viti 2021

Llogaria nr.520 "Disponibilitete në Thesar", në pasqyrat financiare të vitit 2021 paraqitet në vlerën prej 717,169,979 lekë. Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit është e analizuar si më poshtë:

Testimi i llogarisë nr.520 "Disponibilitete në Thesar" për vitin ushtrimor 2021

Llogaria 520	
I.Të trashëguara nga viti 2020	**Lekë**
Sipas aktit të rakordimit për shumën. Nga të cilat:	
Granti I trashëguar	456,471,086
Të ardhura të trashëguara	106,155,192
Mjete në ruajtje të trashëguara (llog. 466)	93,508,883
Fonde specifike	5,906,262
FZHR	-
Totali	**662,041,422**
II.Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit	-
Granti I vitit	652,826,000
Të ardhurat e vitit	764,743,493
Të hyra nga mjetet në ruajtje	31,491,713
Granti specifik(Te kushtezuar + sektorial)	408,339,602
FZHR	-
buxheti	1,075,060,133
Tot.	**2,932,460,942**
Totali I të ardhurave (I+II)	**3,594,502,365**
III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520	**2,877,332,386**
Paga sigurime (600+601)	262,877,095
Shpenzime operative (602)	372,658,393
Subvencione (603)	-
Transferime korente të brendshme (604)	166,579,243
Transferime korente me jashtë (605)	-
Transferime për buxhetet familjare dhe individë (606)	962,577,837
Kredia (BKT) + Interesa për huamarje (651)	-
Investime (231)	440,688,627
Të dala nga mjetet në ruajtje (466)	31,703,351
Transferime korente te brendshme + transferta buxhetin e vet (418,470,743 +5,975,765)	640,247,840
-	-
Gjendja debitore (saldi) (I + II) - III	**717,169,979**

Burimi:Bashkia Shkodër, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë nr.520 ñDisponibilitete në Thesarò dhe me ditarin e bankës rezultojnë të jenë të rakorduara, veprimet të paraqitura në tabelën e mësipërme.

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Shkodër në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 48,472,627 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 ñMaterialeò në vlerën 34,561,347 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 ñObjekte inventariò në vlerën 13,911,280 lekë.
Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 719,291 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 ñNdryshimi gjendjes së inventaritò *(pasqyra F2 – performanca financiare)* në shumën 719,291 lekë.
Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Shkodër ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit nr.1361, 1362 dhe 1363, datë 28.12.2021, ku janë përcaktuar grupet për inventarizimin e aktiveve.
Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 ñNdryshimi i gjendjeve të inventaritò dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 ñNdryshimi i gjendjeve të inventaritò.

Fondi i Konsoliduar.
Në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën **76,162,943,721 lekë.** Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet.

		2021	2020
D	**FONDI I KONSOLIDUAR:**	**76,162,943,721**	**74,704,884,728**
101	Teprica (Fondi I akumuluar) / Deficiti i akumuluar	75,551,883,422	74,142,361,586
12	Rezultatet e mbartura	86,372,202	0
85	Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	408,549,343	452,965,987
115	Nga Fondet e veta te investimeve	27,754,031	71,822,039
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime	29,001,220	
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne	47,953,417	24,117,516
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	11,430,086	13,617,600

Pasqyra e Performancës Financiare.
Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare përsa i përket të ardhurave:
-Llogaritë e financimit nga buxheti i shtetit për vitin 2021 (grant) paraqitet në shumën prej **1,721,377,067** lekë.
-Të ardhurat e realizuara nga Bashkia për vitin 2021 janë 702,120,477 lekë nga të cilat:
-Të ardhurat tatimore në vlerën **492,338,039** lekë dhe të ardhurat jo tatimore në vlerën **209,782,438** lekë, sipas aktit të rakordimit me degën e Thesarit Shkodër.
-Llogaria nr.7002 "Tatim mbi Biznesin e vogël" pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 7,113,568 lekë. Nga viti 2020 ky zë vjen me rënie të vlerës, si rezultat i rënies së arkëtimeve nga biznesi.
-Llogaria nr.7020 "Tatim mbi pasurinë e paluajtshme"pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 160,405,697 lekë. Në krahasim me vitin 2020 kemi rritje të të ardhurave me 12,427,440 lekë, si rrjedhojë e rritjes së arkëtimeve nga tatimi mbi truallin, tokën bujqësore dhe ndërtesat.
-Llogaria nr.7029 "Të tjera tatime mbi pasurinë e paluajtshme"pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 17,554,737 lekë. Në krahasim me vitin 2020 kemi rritje të të ardhurave me 17,554,737 lekë, si rrjedhojë e rritjes së numrit të transaksioneve (shitje, blerje, dhurim) me pasurinë e paluajtshme, të ardhura që vilen nga Drejtoria Vendore e ASHK Shkodër.

-Llogaria nr.7033 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 109,323,738 lekë, ku sipas aktrakordimit me thesarin në të përfshihen taksa e rregjistrimit të mjeteve të përdorura të transportit.

-Llogaria nr.7035 "Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 197,638,895 lekë, ku sipas aktrakordimit me thesarin në të përfshihen të ardhura nga taksa dhe tarifa vendore si: Taksë vendore për zënien e hapësirave publike; Taksë vendore e ndikimit të infranstrukturës nga ndërtimet e reja dhe legalizimet; Taksë vendore për fjetjen në hotel; Taksë për therjen e bagëtive; Taksë vendore për reklamat; Taksë vendore e tabelës; Tarifa e licencimit të karburanteve, etj.

-Llogaria nr.7109 "Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia"paraqitet në bilancin e vitit 2021 në vlerën 2,802,261 lekë, në krahasim me vitin 2020 kemi rritje të saj me 998,472. Kjo llogari përfaqëson të ardhurat nga qiratë e pasurive të paluajtshme.

-Llogaria nr.7110 "Të ardhurat nga tarifat administrative dhe rregullatore" pasqyrohet në bilancin e vitit 2021 në vlerën 158,646,892 lekë, që përfaqëson të ardhura nga lëshimi i akteve administrative, tarifë pastrimi, leje transporti, konkurset.

-Llogaria nr.7111 "Të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh" pasqyrohet në bilancin e vitit 2021 në vlerën 19,144,711 lekë, që përfaqëson të ardhurat nga çerdhet dhe parkimi.

-Llogaria nr.7113 "Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve" pasqyrohet në bilancin e vitit 2021 në vlerën 1,681,585 lekë, që përfaqëson të ardhurat nga mencat, shërbimi zjarrëfikës për miratim projekti, certifikatë ekspert zjarrëfikës, si dhe nga shitja e dokumenteve të tenderit.

-Llogaria nr.7114 "Të ardhura nga biletat" pasqyrohet në bilancin e vitit 2021 në vlerën 1,896,200 lekë, që përfaqëson të ardhurat nga bileta të muzeumeve, atraksioneve turistike;

-Llogaria nr.7115 "Të ardhura nga gjobat" pasqyrohet në bilancin e vitit 2021 në vlerën 23,163,892 lekë, që përfaqëson të ardhurat nga gjobat e IMTV, Policia Bashkiake, Sekuestrime;

-Llogaria nr.7206 "Financim i pritshëm nga buxheti"në vlerën prej 1,332,562 lekë përbëhet nga vlera e detyrimeve të dhjetorit të palikujduar për shpenzime personeli për paga, për kontribute sig.,shoqërore e shëndetësore, për punonjësit e Gjendjes Civile dhe QKB.

Rakordimi i Shpenzimeve

Emertimi	Sipas Pasyrës së Performancës
600	226,761,306
601	36,344,929
602	369,575,024
603	0
604	166,579,243
606	962,577,837
63	-719,292
kalim fond institucionet e varesise	611,756,212
Totali	**2,372,875,259**

- Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 ñshpenzimetò dhe klasës 7 ñtë ardhuratò, janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 ñRezultati i veprimtarisë ushtrimoreò, konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra
I	Totali të ardhura	2,781,424,602

II	Shpenzime	2,372,875,259
III	Rezultati i vitit ushtrimor	408,549,343

Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën 408,549,343 lekë, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare.

-Në veçanti u konstatua se:

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.468 ñDebitorë të ndryshëmò.
Situata: Llogaria nr. 468 ñDebitorë të ndryshëmò, në fund të vitit 2021 është në vlerën 1,553,169,092 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	1,173,548,050
Shtesa gjatë vitit 2021	1,110,225,581
Pakësime gjatë vitit 2021	730,334,267
Gjendja në 31.12.2021	**1,553,439,365**

Ndërkohë sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit, bazuar në të dhënat e vendosura nga Bashkia Shkodër (Drejtoria e të Ardhurave, IMTV), lëvizjet debitore dhe kreditore të llogarive përkatëse, rezultoi se vlera e llogarisë nr.468 nuk është kontabilizuar për 223,179,324 lekë më pak, si më poshtë vijon:
-13,438,000 lekë kamatëvonesa për detyrimet ndaj biznesit dhe institucioneve;
-222,324,563 lekë debitorë kategoria familjar për taksa dhe tarifa vendore krijuar brenda vitit 2021;
-Gjoba të vendosura nga IMTV mbivlerësuar për vlerën 4,432,962 lekë, më tepër për 8,294,277 lekë kamatëvonesa, si dhe më tepër për 144,000 lekë për likujdime brenda vitit (pasqyruar tabela analitike në Anekse).
Kriteri: Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, shkronja ñëò, pika 3, neni 12;
Ligji nr.25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, pika 1, neni 11.
Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, i ndryshuar,rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja ñcò.
Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.468 ñDebitorë të ndryshëmò, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të përbërjes së debitorëve të Bashkisë Shkodër në fund të vitit 2021.
Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.
Rëndësia:I Mesëm.
Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme, që kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 ñDebitorë të ndryshëmò me kundërparti llogarinë nr. 470 ñTë ardhura për tôu marrëò.
Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 466 ñKreditorë për mjete nën ruajtjeò.
Situata: Llogaria 466 ñKreditorë për mjete nën ruajtjeò, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Shkodër, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 93,297,245 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Shkodër.

Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Celje e vitit 2021	**93,508,883**
Shtesa	31,491,713
Pakësime	31,703,351
Gjendja në 31.12.2021	**93,297,245**

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar dhe është marrë në dorëzim, sipas vitit përkatës, paraqiten si më poshtë:

1	Rikonstruksion Rruga Bashej	329,784
2	Rikonstruksion Rruga "Pjeter Spani"(Faza e II)	24,039
3	Rehabilitim dhe risistemim i Merkatos Rus (faza e II)Situacion perfundimtare	72,106
4	Ndertim prita malore ne Njesite Administrative,Sit.perfundimtar	100,397
5	Situacion perfundimtar dt. 13.08.2015 Ndriçim rruge dytesore	117,461
6	FV Kufizues shpejtesie (bumpe gome)	84,480
7	Upgrade-im i platformes Transparenca e Buxhetit ne mobile App dhe mirembajtje	48,996
8	Upgrade-im i funksionaliteteve te sistemit te informacionit te sherbimeve sociale	72,000
9	Upgrade-im i aplikimit S1ZIN dhe STTV permes Web,integrimi ne platformen e-Albania	249,600
10	Ndertimi i rrjetit te brendeshem te komunikimit elektronik (intranet) ne 3 njesi Administrative dhe 5 lagje.	101,724
11	Furnizim vendosje kamera sigurie per ambjente publike	330,676
12	Ndertim xhepa kazanash per mbeturina	22,967
13	Rehabilitim dhe ndertim i kendeve te lojrave ne parqet dhe lulishtet e qytetit te Shkodres	79,080
14	Rehabilitim dhe ndertim i kendeve te lojrave ne parqet dhe lulishtet e qytetit te Shkodres	63,720
15	Rikontruksion Blloku i Pallateve Osja Falltores (krahu i majte) Situacion Nr. 2(perfundimtar)	28,323
16	Investim ndriçim rruge dytesore sit.perf.	338,954
	Total	**2,064,307**

-Llogaria 466 ñKreditore për mjete nën ruajtjeòështë mbivlerësuar për 2,064,307 lekë për vitin 2021.

Kriteri: Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar, pika 3.2 ñTrajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) ï funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4ò.

Ndikimi/Efekti: Llogarianr. 466 ñKreditore për mjete nën ruajtjeò,nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia:I Mesëm.

Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisënr. 466 ñKreditore për mjete nën ruajtjeò, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 150 ñShuma t^y parashikuara p^y r rreziqe e shpenzimeò dhe llogarisë 683 ñShuma t^y parashikuara t^y shfrytëzimitò.

Situata: Llogaria nr.683 ñShuma të parashikuara të shfrytëzimitò pasqyron provizionet për shpenzime të njësisë publike, të cilat jan^y ngjarje të ndodhura, q^y cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tôu paguar nga ana e njësisë. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit.

Testi substancial

Llogaria 150 ñShuma t^y parashikuara p^y r rreziqe dhe zhvlerësimeò në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 29,001,220 lekë, **ndërkohë** rezulton se llogaria 683 ñShuma t^y parashikuara t^y shfrytëzimitò paraqitet në vlerën zero lekë.

Në analizë të vendimeve gjyqësore që kanë kaluar fazën e parë të gjykimit, rezulton se vlera e provizioneve për Bashkinë Shkodër në fund të vitit 2021 është50,381,241 lekë(Pasqyruar në Kapitullin Aneksi 2 ï Pasqyrat Financiare).

Sipas udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 ñ*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*ò, i

ndryshuar, pika 34 citohet; ñProvizionet py r shpenzime jany ngjarje të ndodhura, ty cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tôu paguar nga ana e njësisë. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit. Këto provizione duhet të njihen ny kontabilitet dhe të pasqyrohen ny pasqyrat financiare vjetore ty njësisë nëse:
-Njy sia ka njy detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv), si rezultat i njy ngjarje ty ndodhur;
-ı shty e mundur qy një dalje e burimeve ekonomike ty jety e nevojshme py r ty py rmbushur detyrimin;
-Si dhe mund të bëhet një parashikim i besueshy m mbi vlerën e detyrimit.

Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet py r provizionet ty bëhen si my poshty :
a) Ny momentin e njohjes sy provizionit kryhen ky to regjistrime:
Debitohet llogaria 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit"; dhe Kreditohet llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime".
b) Në momentin e përdorimit apo pakësimit të provizionit kryhen këto regjistrime:
Debitohet llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime"; dhe Kreditohet llogaria 785 "Përdorim i shumave të parashikuara për shpenzime të viteve të ardhshme".
Gjithashtu sipas Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.6 ñProvizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuaraò, paragrafët 10 ï 22, përcaktojnë qartë njohjen në kontabilitet të provigjionit që lind për shkak të një vendimi gjyqësor të formës së prerë në monetin fillestar për vitet përkatëse si më poshtë;

<u>Sa më sipër për vitin 2021 duhej të ishte bërë regjistrimi kontabël</u>
Llogaria 683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit" 79,382,461 lekë (29,001,220 lekë + 62,133,941 lekë)
tek
Llogaria 150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime"79,382,461 lekë.
Përfundimisht kemi nënvlerësim të llogarisë *150 "Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime" për* **50,381,241**lekë në vitin 2021, si dhe nënvlerësim të shpenzimeve *683 "Shuma të parashikuara të shfrytëzimit"* në pasqyrën e performancës financiare me **79,382,461** lekë.
<u>Kriteri:</u> Pika 1.1.5 ñGrupi i llogarive 15 ï Shuma të parashikuara për rreziqe e shfrytëzimeò nëUdhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 ñPër disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar.
<u>Ndikimi/Efekti:</u> Llogaria nr.683 ñShuma të parashikuara të shfrytëzimitò, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të shpenzimeve për provizionet që ka Bashkia Shkodër në fund të vitit 2021.
<u>Shkaku:</u>Moszbatim i kuadrit rregullator.
<u>Rëndësia:</u>I Mesëm.
<u>Rekomandim:</u>Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në llogarinë nr. 683 ñShuma të parashikuara të shfrytëzimitò duke e debituar atë në momentin e njohjes dhe kredituar llogarinë nr. 150 ñShuma ty parashikuara py r rreziqe e shpenzime.

<u>Titulli i gjetjes:</u> Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.486 ñShpenzime të periudhave të ardhshme me kundërparti llogarinë nr. 467 ñKreditorë të ndryshëmò në pasiv të bilancit.
<u>Situata:</u>Llogaria nr.486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 3,376,220 lekë.

Vlera e kësaj llogarie duhet të përfaqësojë detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve, si shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore, për detyrime të prapambetura për shërbime, për detyrime të prapambetura për mirëmbajtje, për investime, për detyrime të prapambetura të tjera.
Kjo llogari ka si kundërparti gjendjen e llogarisë nr.467 ñKreditorë të ndryshëmò në pasiv të bilancit në vitin 2021 në vlerën 79,357,034 lekë.
-Nga verifikimi i analitikut të llogarisë nr.486 për vitin 2021, ditarit të shpenzimeve, konstatohet se në vitin 2021 në këtë llogari nuk janë kryer kontabilizimet e plota për 245,114,619 lekë, detajuar si më poshtë vijon:
-Llogaria nr.467 me kundërparti llogarinë nr.486[19] - 79,357,034 lekë (e cila nuk është debituar për vlerën 79,357,034 lekë në pasqyrat financiare të vitit 2021, prakemi klasifikim të gabuar dhe jo mospasqyrim të vlerës së detyrimeve në këtë rast);
-Llogaria nr.401-408 ï fatura që kanë kaluar 60 ditë kalendarike pa u likuiduar (përfshirë periudhën derin në 26.01.2022) dhe qëndrojnë të kontabilizuara në këtë llogari (detyrime afatshkurtra, të cilat më tepër janë detyrime që krijohen nga operacione korrente dhe likuidohen brenda vitit, pra kemi klasifikim të gabuar dhe jo mospasqyrim të vlerës së detyrimeve në këtë rast). Duke analizuar faturat e investimeve të cilat janë klasifikuar si 401-408, por që në fakt kontrata e investimit ka filluar në vitin 2019, 2020, 2021 dhe likuidim i tyre kalon në vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023, duhet riklasifikuar në 467 si detyrime të prapambetura, si dhe duhen debituar në kundërparti në llogarinë 486- Shpenzime të periudhave të ardhshme - 165,757,585 lekë (pasi përfaqësojnë detyrime për likujdim në periudha afatgjata, më tepër se një 1 vit).
-Sa më sipër nuk është bërë klasifikimi i rregullt i llogarisënr. 486 për 245,114,619 lekë diferencë;
Kriteri: Pika 15 në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 ñPër disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò, detyrime ndaj të tretëve, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë të Bashkisë Shkodër në fund të vitit 2021.
Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.
Rëndësia:I Mesëm.
Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme, që kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të Bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr.486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò, duke kryer mbylljen e saj në debi të llogarisë nr.467 ñKreditorë të ndryshëmò.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò.
Situata: Llogaria nr.213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreònë fund të vitit paraqitet në vlerën kontabël 5,823,166,242 lekë. Referuar formatit 7/a ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), në fund të vitit 2020 aktivet e kontabilizuara në llogarinë nr.213 paraqiten në vlerën 4,630,506,579 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,857,614,631 lekë (- amortizim të akumuluar 34,448,389 lekë) si rrjedhojë e shtesave të bëra përgjatë vitit 2021, kryesisht rikonstruksione të rrugëve dhe rrjeteve.
-Analitiku i llogarisë nr.213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò përbëhet nga 2009 objekte. Nga verifikimi i amortizimit të përllogaritur për aktivet e llogarisë nr.213, konstatohet se për shtesat në aktive të bëra gjatë vitit 2021, nuk është përllogaritur amortizimi për pjesën e

[19]Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore të vitit 2021 kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr.4864 në debi të llogarisë nr.467 për totalin e detyrimeve të prapambetura, të cilat quhen të tilla në momentin kur nuk janë likujduar brenda afatit 60 ditor në përfundim të vitit ushtrimor.

mbetur nga data e marrjes në dorëzim të investimit deri në fund të vitit 2021. Përllogaritur për 362 objekte të vitit 2021 (likujdimi i fundit + 30 ditë shtesë deri në kolaudimin e objektit, si dhe pjesën e mbetur të vitit 2021, pasqyruar në Kapitullin ñAnekse ï Pasqyrat Financiareò) në vlerën 9,614,406 lekë.
Kriteri: Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar, klasa 2 ñAktivet Afatgjataò (përbërja dhe trajtimi kontabël).
Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò në fund të vitit 2021, nuk pasqyron vlerën e drejtë dhe reale të saj.
Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.
Rëndësia:I Mesëm.
Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò, për vlerën 9,614,406 lekë.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 202 ñStudime dhe kërkimeò.
Situata: Llogaritë e Klasës 20 ñAktivet Afatgjata Jo materiale**",** përbëhen nga llogaria nr.202 ñStudime dhe kërkimeò, në vlerën 117,851,609 lekë në fund të vitit 2021.
Në fund të vitit 2020 sipas formatit 7/b ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò llogaria nr.202 ñStudime dhe kërkimeò paraqitet në vlerën 113,784,690lekë, dhe në fund të vitit 2021 (kosto historike) në vlerën 117,851,609 lekë, si rrjedhojë e shtesave gjatë vitit në vlerën 4,066,919 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	113,784,690
Shtesa gjatë vitit 2021	15,420,108
Pakësime gjatë vitit 2021	11,353,189
Gjendja në 31.12.2021	117,851,609

Në llogarinë 202 janë kontabilizuar investimet për aktive afatgjata jomateriale të marra në dorëzim gjatë vitit 2021, gjithsej 43 projekte.
Nga shqyrtimi i pasqyrës së aktiviteve afatgjata F7/b ñGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò, rezulton se nuk është kryer amortizimi i llogarisë nr.202 ñStudime dhe kërkimeò, në vlerën 17,677,741 lekë (kosto historike + shtesa ï pakësime * 15%) sipas normës 15% për aktivet afatgjata jomateriale.
Kriteri: Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar, klasa 2 ñAktivet Afatgjataò (përbërja dhe trajtimi kontabël).
Ndikimi/Efekti: Llogarianr. 202 ñStudime dhe Kërkimeò,nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.
Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.
Rëndësia:I Mesëm.
Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 ñStudime dhe Kërkimeò, për vlerën 17,677,741 lekë.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 215 ñMjete transportiò.
Situata: Llogaria 215 ñMjete transportiò paraqet vlerën neto të mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Shkodër më datë 31.12.2021 në shumën 13,481,644 lekë.

Nr	Emertimi	Cmimi	Sipas të dhënave kontabël	
			Sasi (cope)	vlefte
1	Ford Focus	1,022,537	1	1,022,537

2	Wolksvagen JETTA/	2,583,000	1	2,583,000
3	Benz	1,682,400	1	1,682,400
4	SKODA	1,323,000	1	1,323,000
5	Land Rover	1,599,600	1	1,599,600
6	Fiat Punto	-	1	0
7	Autoveture Chrysler	-	1	0
8	Makine teknologjike	3,588,000	1	3,588,000
9	Makine teknologjike targa APV	2,880,000	1	2,880,000
10	Dumdum Shefing	475,000	1	475,000
11	Makine per pastrim rere tip delfin	972,000	1	972,000
12	Makine Vijezimi		1	
13	APV/KATER PILAR		1	0
14	Autoveture Chrysler	990,000	1	990,000
15	Kamionçin/Mercedes	2,148,000	1	2,148,000
16	Mercedes Benc	4,470,000	1	4,470,000
17	Makine vijezimi/TERMEX/2016	4,797,600	1	4,797,600
18	Vinc me Kosh APV/ NISSAN	2,256,000		2,256,000
19	APV Fiat Auto shkolle	2,496,000		2,496,000
20	Ëolksvagen CADDY	2,795,400	1	2,795,400
21	Automjet fuoristradë Land Rover	1,987,200	1	1,987,200
22	Autoveture Volksvagen Bora	120,000	1	120,000
23	Autoveture Ford Fokus	170,534	1	170,534
24	Automjet Mitsubishi Pajero		1	0
25	Fadrome FAI		1	0

-Nga shqyrtimi llogarisë analitike të mjeteve të transportit, rezulton se kemi klasifikim të gabuar të disa makinerive në këtë llogari, si makinë vijëzimi ï në vlerën 4,797,600 lekë, makinë pastrim rëre - 972,000 lekë, makinë teknologjike ï 6,468,000 lekë, të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë 214, si dhe për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%).

Kriteri: Nomeklatura e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune ï llogaria 7-shifrore 2140240-Paisje dhe makineri për konstruksione (ndërtime); 2140260-Paisje pastrimi për rrugët; 2140320-Mjete dhe paisje te tjera teknike.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr. 215 ñMjete transportiò,nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2021.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Rëndësia:I Mesëm.

Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisënr. 215 ñMjete transportiò.

Për sa më sipërmbajnë përgjegjësi Drejtoresha e Financës znj. M.M dhe Përgjegjësja e Kontabiliteti zj. M.D.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur observacionet, me shkresën nr.373/5 prot., datë 07.07.2022, konkretisht nga zj. B.M dhe zj.M.D, si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Llogaria 468.

Për subjektin K&B B, është faturuar me 10.11.2021 dhe rezulton në listën e debitorëve të vitit 2021 (nr.rendor 184785, i listës debitore)

Subjekti D.P është faturuar me 10 nëntor 2021 dhe ka paguar me 13.12.2021

Per vleren 222,324,563 lek, debitorë, i përket kategorisë familjare për taksa dhe tarifa vendore krijuar brenda vitit 2021, është e kontabilizuar në listën e debitorëve total për bashkinë Shkodër 2021.

Kamatëvonesa për gjobat e vendosura nga IMTV, është bërë referuar ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", i ndryshuar, (neni 16) Gjoba

paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamatë 2 për qind për çdo ditë vonesë, deri në një muaj. Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë semerret në konsideratë pjesërisht për dy subjektet K&B B dhe D.P. Për kontabilizimin e detyrimeve për taksa dhe tarifa vendore për kategorinë familjar, ju pasqyrojmë llogarinë analitike nr.468 të dërguar nga sektori i kontabilitetit, ku për lehtësi leximi kemi filtruar vetëm vitin 2021

Levizja e llogarise 468 Sintetike			Viti 2021		
Bashkia/NJA	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2020	Debi	Kredi	Mbetja
2021	Gjobe IMT 2021	-	1,800,000	1,400,000	400,000
2021	Kamatvonese IMT	-	330,000	30,000	300,000
2021	Kamatvonese P. Bashkiake	-	182,580	68,900	113,680
2021	Gjoba P. Bashkiake biznes	-	1,899,040	774,058	1,124,982
2021	Sekuestrime	-	1,085,556	966,771	118,785
2021	Infrastrukture Ndertime te reja	-	35,559,035	31,342,810	4,216,225
2021	Bashkia Shkoder 2021	-	748,707,693	547,715,056	200,992,637
2021	Drejtoria MNZ	-	-	-	-
2021	Gjobe IMT 2021	-	121,350,462	1,662,500	119,687,962
2021	Policia Bashkiake individ 2021	-	601,000	76,000	525,000
2021	Kamatvonesa IMT	-	66,587,277	26,000	66,561,277
2021	Kamatvonesa Gj. Polici Bashkiake	-	253,200	4,940	248,260
2021	Legalizim	-	49,284,405	18,803,692	30,480,713
2021	Individ debitore 2021	-	7,277,826	6,582,407	695,419
2021	Sekuestrime 2021	-	2,389,729	70,000	2,319,729

Pra sa më sipër në asnjë rast nuk evidentohet kontabilizimi i debitorëve për taksa dhe tarifa të kategorisë familjar. Për më tepër që në pretendimin tuaj për akt-konstatimin jeni shprehur se sektori i kontabilitetit bënë kontabilizimin e informacionit të përcjellë nga DAV, pra keni pranuar se informacioni nuk iâu është përcjellë nga DAV.

Pretendimi i subjektit:

Llogaria 466.

Per llogarinë 466, ñKreditore per mjete ne ruajtjeò Drejtoria e Financës nuk disponon asnjë procedure likuidimi per 5% garanci, ndaj Subjekteve . Kërkesat per likuidim 5% vijnë kryesisht nga **Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes se Investimeve**. Drejtoria e Financës bën ekzekutimin e fondeve pas verifikimit dhe kontrollit të dokumentacionit dorëzuar nga drejtoria që ndjek investimet, si: (Urdhëri për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzim të punimeve pas përfundimit të garancisë teknike,, pasi komisioni verifikon dhe inspekton gjendjen e objekt bën informacion mbi gjendjen teknike të objektit duke ia dërguar Titullarit, dhe në fund hartohet Çertifikata e marrjes në dorëzim përfundimtare apo Proces-verbali përfundimtar i marrjes në dorëzim, kjo në varësi të fushës së objektit, nëse është rikonstruksion apo blerje paisje, kjo në vijim të Ligjit nr.8402 datë 10.09.1998 óPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të Ndërtimitò, i ndryshuar dhe udhëzimit nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar. Të gjitha janë të përcaktuara në Kontratën e nënshkruara nga Autoriteti Kontraktor dhe Operatori ekonomik, e cila është 1-2 vjet garancia. Neni 28 i kontratës ñdefektet e pakorrigjuaraò pika 28.5 citon ñ*Periudha e garancisë për defektet është 24 muaj nga data e marrjes në dorëzim të objektit të kontratës. Me përfundimin e kësaj periudhe , kontraktori paraqet kërkesën e kthimit të vlerës së garancisë së punimeve e cila i është mbajtur nga Investitori. Ky i fundit cakton komisionin e marrjes në dorëzim të veprës, i cili në bashkëpunim më Kontraktorin, drejtuesin e projektit, Kolaudatorin/Grupin e Kolaudimit Brenda 10 ditëve, organizojnë vizitën në terren ku kontrollohen relikuduar , janë likudualizimit e detyrave të lëna, korrigjim i defekteve të lindura gjatë periudhës së garancisë*

teknike të punimeve. Nëse janë kryer të gjitha korrigjimet e defekteve hartohet akti përkatës i marrjes në dorëzim të objektit (çertifikata) dhe që shënon përfundimin e detyrimeve reciproke të kontratës së sipërmarrjes dhe atë të Drejtuesit të projektit. Ky akt është subjekt i miratimit nga Autoriteti Kontraktor". Neni 58 i kontratës "Përfaqësimi i palëve" citon:Struktura organizative që do të jetë përgjegjës , në emër të Autoriteti Kontraktor për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës do të jetë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së investimeve të Infrastrukturës , Sektori i Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturësò. Për objektet, sqarojmë si më poshtë:Rikonstruksion rruga Rozar Dodmasej, me shumë 229,686 lekë, likuidimi është bërë me datë 18.03.2022. (bashkëngjitur kopje e USH). Ndërtim parcela të reja varresh Nj. A rrethina, me shumën 433,792 lekë, likuidimi është bërë me datë 22.11.2021. (bashkëngjitur kopje e USH). Sistemim trotuari dhe gjelbërim rruga lëvizja e postribës, me shumë 71,123 lekë, likuidimi është bërë me datë 01.12.2021. (bashkëngjitur kopje e USH).Rikonstruksion rruga Bashej, me shumë 71,123 329,784lekë, likuidimi është bërë me datë 16.06.2022. (bashkëngjitur kopje e USH).
FV Kufizues Shpejtësie (Bumpe Gome), me shumë 84,480 lekë, likuidimi është bërë me datë 16.06.2022. (bashkëngjitur kopje e USH).

<u>Qëndrimi i Grupit të Auditimit:</u>

Për pretendimin e mësipërm sqarojmë se merret në konsideratë pjesërisht për likujdimin e kryer për objektin e punimeve ñNdërtim parcela të reja varresh Nj. A rrethina, dhe punimet në Rrugën Rozar Dodmasej.
Për pretendimet e tjera kemi të njëjtin qëndrim me atë të mbajtur në Projekt Raportin e Auditimit.
Gjithashtu sjellim në vëmendjen tuaj përcaktimin e bërë në shkronjën ñgjò pika 3 në nenin 12 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar:
gj) garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet tôia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues.

<u>Pretendimi i subjektit:</u>

Llogaria 486.
Nga Dega e Thesarit Shkodër, jemi orientuar me email të datës 19 Nëntor 2020 se :ñNe zbatim te udhezimitudhëzimit nr.37 date 06.10.2020 "Per Monitorimin dhe Raportimin e Stokut te Detyrimeve te Prapambetura te Institucioneve te QeverisjeseQeverisjes se PergjithshmePërgjithshme ", ne mbeshtetjembështetje te Ligjit nr. 48/2014 "Per Pagesat e Vonuara ne Detyrimet Kontraktore e Tregtare", neni 7, si dhe pas konsultimit me strukturat perkatesepërkatëse ne MFE te kontratave me financim shume vjeçar qe institucioni juaj ka, Shumat qe do te likujdohen vitet pasardhese, nuk konsiderohen si detyrim dhe si te tilla nuk do te rregjistrohenregjistrohen ne SIFQ, pasi sipas kontrateskontratës eshteështë rene dakord nga investitori mbi grafikun e financimit.ò (Bashkëngjitur e-mail nga dega e Thesarit Shkodër, datë 19 Nëntor 2020).ñDetyrime të prapambetura ndaj palëve të tretaò, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontrate, faturë ose sipas ligjit.Sqarojmë se kontratat e investimeve që janë me financim disa vite e kanë të përcaktuar në kontratë shumën e financimit, si dhe gjithashtu janë të parashikuara në Programin Buxhetor Afatmesëm. Investimet me financime ndër vite janë kontabilizuar në debi të llogarisë 231, dhe në kredi të llogarisë 404, kjo sipas aneksit nr.1 , Paragrafi, ñTrajtimit kontabël dhe funksionimi i grupit 21 ñAktive Afatgjata Materialeò të Udhëzimit nr.5, date 21.02.2022 "Per disa ndryshime ne udheziminudhëzimin nr.8 date

09.03.2018 "Per procedurat e pergatitjespërgatitjes, paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore ne Njesite e Qeverisjes se Përgjithshme", i ndryshuar. Rezulton se shuma e llogarisë 401-408 të cilës ju i referoheni nuk është 165,757,585 lekë por është 130,011,172 lekë. Në bazë të udhëzimit nr.5, date 21.02.2022 "Per disa ndryshime ne udhëzimin nr.8 date 09.03.2018 "Per procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore ne Njesite e Qeverisjes se Përgjithshme", i ndryshuar, pika 15 citonò. ñLlogaria 4864 ñShpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambeturaò, nuk është pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar.ò

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Për pretendimin tuaj se llogaria 468 nuk është pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar, nuk qëndron, llogaritë dhe pasqyrat financiare që janë pjesë e raportimit financiar janë të përcaktuar në Aneksin nr.2 tëUdhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 ñPër disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò. Pika 15 përcakton për regjistrimet e thesarit në llogarinë 486 që gjenerohet nga SIFQ nuk janë pjesë e PF, pra nuk lidhet me kontabilizimin e kësaj llogarie nga sektori i kontabilitetit. Gjithashtu në paragrafin në vijim përcaktohet veprimi kontabël për llogarinë nr.486 me kundërparti llogarinë 467.
Gjithashtu grupi i auditimit është shprehur se kemi keqklasifikim, pra jo fshehje të detyrimit. Pikërisht edhe në dhënien e opinionit nuk është përfshirë vlera për llogarinë 486. Sa i përket vlerës që duhej kontabilizuar në llogarinë 486, fatura të kontabilizuara në llogarinë 401-408, e kemi pasqyruar analitikisht në kapitullin ñAnekse ï Tabela nr.8ò.
Për likujdimin e detyrimit ndaj subjektit Albtelecom dhe Shoqata e të Verbërëve merret në konsideratë dhe është bërë ndryshimi përkatës.

Pretendimi i subjektit:

Vendimet gjyqesore që jane kontabilizuar në llogarinë 467 "Kreditore te ndryshem", kanë kaluar në llogarinë 150 "Shuma te parashikuara per rreziqe dhe zhvlerësime", kështu që nuk preket llogaria 683 "Shuma te parashikuara te shfrytëzimit".
Në bazë të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshëmò, i ndryshuar, citon, pika 34 kreu III si më poshtë :
Provizionet p^y r shpenzime jan^y ngjarje të ndodhura, t^y cilat sjellin një probabilitet që do të ketë një detyrim për tôu paguar nga ana e njësisë. Raste të tilla do të konsiderohen të gjitha vendimet gjyqësore, të cilat kanë kaluar shkallën e dytë të procesit të apelimit. Këto provizione duhet të njihen n^y kontabilitet dhe të pasqyrohen n^y pasqyrat financiare vjetore t^y njësisë.ò.
Sqarojmë se të gjitha këto vendime gjyqësore që nuk janë kontabilizuar, janë në Gjykatën e Shkallës së Parë.
Sqarojmë se Rekomandim 10.1 Ky rekomandim nuk pranohet.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Për pretendimin tuaj, ju pasqyrojmë tabelën e vendosur në dispozicion nga Drejtoria Juridike, si më poshtë:

Nr.	Padites	Viti	Shuma e kërkuar	Vendimi i Gjykatës shkalla e Parë	Vlerë	Statusi çeshtjes
1	D.H	2019	Pa vlere te caktuar	Gjykata administrative e shkallës së parë Shkodër me vendimin nr. 23(44), date 22.01.2020, kavendosur: Pranimin e padise.	-	Vazhdon gjykimi në Gjykatën Administrative të A pelit Tiranë.
2	Bashkia Shkodër	2020	20 000 leke	Gjykata administrative të shkallës së parë, Shkodër me vendimin nr.267(372, date 19.04.2021	20 000	Vazhdon gjykimi në Gjykatën Administrative të A pelit Tiranë.
3	N.S	2020	123 000 lekë .	Gykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder me vendimin nr.606 (3261), date 17.9.2020,	123 000	Vazhdon gjykimi Gjykatën Apelit ,

				ka vendosur: Pranimin e padise .		Shkoder.
4	A.S	2018	6 663 301 leke.	Gykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder me vendimin nr. 201(288),date 26.02.20219, ka vendosur: paranimin e padise .	6 663 301	Vazhdon gjykimi Gjykatën Apelit Shkoder.
5	Gj.Sh	2018	11 700 000 leke	Gjykata Administrative Shkalles se Pare Shkoder, me vendimin nr. 469(636) date 23.06.2021 ka vendosur: Pranimin e padise sipas objektit	11,700,000	Vazhdon gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
6	N	2018	30 059 000 lekë	Gjykata Administrative Shkalles se Pare Shkoder , me vendimin nr. 201(288) date 09.04.2019 ka vendosur: pranimin e kerkese padise.	30 059 000	Vazhdon gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
7	M.K	2020	6 000.000 lekë	Gykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder me vendimin nr. 87(362) date 21.02.2022ka vendosur :Pranim te pjesshem te padise ne masen 400 000 lekë.	400 000	Vazhdon gjykimi Gjykatën Apelit Shkoder.
8	Shoqëria óAô sh.a;	2011	1.352.700 lekë	Gykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder me vendimin nr. 97(692) date 23.02.2022 ka vendosur: Pranimin e padise .	1,352,700	Vazhdon gjykimi Gjykatën Apelit Shkoder.
9	L.Ç	2018	100 000 000 lekë	Gjykata Administrative Shkalles se Pare Shkoder , me vendimin nr. - date 13.04.2022	100 000 000	Në afat njoftim vendimi nga Gjykata Administrative.
10	Bashkia Shkodër	2020	308,454 lekë	Gjykata Administrative Shkalles se Pare Shkoder, me vendimin nr.- , date 28.03.2022ka vendosur:Rrezimin e padise.	308,454	Në afat njoftim vendimi nga Gjykata Administrative.
11	Bashkia Shkodër	2021	430.681 lekë.	Gjykata Administrative Shkalles se Pare Shkoder, me vendimin nr.-,datë 18.01.2022ka vendosur: Rrezimin e padise.	430,681	Në afat njoftim vendimi nga Gjykata Administrative, Shkoder.
12	S.K	2017	852 000 lekë	Gjykata Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër , me nr. 283 (341) , date 02.05.2017ka vendosur: Pranimin e kërkesë padisë	852 000	Vazhdon gjykimi ne Gjykaten e Apelit Administrativ, Tirane.
13	K.M	2018	394 500 lekë	Gjykata Administrative të Shkallës së Parë, Shkodër , me nr. 93 (117) , date 9.2.2018, ka vendosur:Pranimin e kërkesë padisë.	394 500	Vazhdon gjykimi ne Gjykaten e Apelit Administrativ, Tirane.
14	B.K	2018	Vlera e pa percaktuar	Gjykata e Rrethit Shkoder, me vendimin nr.160 (747), datë 15.2.2019, ka vendosur: Pranimin e padisë. Detyrimin e Bashkise Shkdoder te paguaje vleren e 15 pagave	-	Vazhdon gjykimi ne Gjykaten e Apelit Shkoder
15	F.B, M.M	2018	Vlera e pa percaktuar	Gjykata e Rrethit Shkoder, me vendimin nr. 369, date 3.7.2019, ka vendosur:Pranimin e padisë.	-	Vazhdon gjykimi ne Gjykaten e Apelit Shkoder.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, *rekomandojmë*:

A.MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave për investime me afat financimi 2021-2023, miratuar me VKB nr.63, datë 28.12.2020, konstatohet sepërgjatë vitit 2021 nga Bashkia Shkodër në 8 raste, janë lidhur kontrata në vlerën 76,659 mijë lekë,pa pasur në dispozicion minimalisht 20% të vlerës së kontratës në vitin e parë të financimit.Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 9, 10 të nenit 3, nenin 40, nenin 50 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar; Pika 1 në nenin 47 në Ligjin nr.68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò; Pika 1, paragrafi II në nenin 76 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar; Pikat 1 dhe 4 në nenin 106 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, për kontratat e tjera. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (jo më pak se 20% për kontratat

shumëvjeçare) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se për vitin 2021 në 28 raste në vlerën totale 96,852,384 lekë, faturat tatimore janë paraqitur në degën e thesarit jashtë afatit 30 ditor.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se në fillim të vitit 2021 vlera e faturave të palikuiduara (çelja e llogaria 401-408 dhe çelja e llogarisë 467) ka qenë 149,042,632 lekë dhe fund të vitit 2021 vlera e faturave të palikuiduara (teprica kreditore e llogarisë 401-408 dhe llogarisë 467) është 209,368,206 lekë, ose 60,325,574 lekë më tepër në krahasim me fillim-vitin 2021.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare, konkretisht llogarive të detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të Bashkisë Shkodër ndaj palëve të treta, konstatohet se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021 sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit është në vlerën 248,490,839 lekëtë shpenzimeve të institucionit, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura raportuar në MFE është 3,376,220 lekë, e cila tregon se Drejtoria e Financës raporton në MFE një vlerë të detyrimeve të prapambetura prej 245,114,619 lekë më pak se vlera e tyre e pasqyruar në raportimin e vetëvlerësimit financiar.

-Gjithashtu sa i përket likujdimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, u konstatua se në 5 raste nuk është respektuar rradha e likujdimit të tyre, pra detyrimi i parë në radhën kohore nuk është likujduar i pari. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 ñPër monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshmeò, si dhe pikën 15 në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 ñPër disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi:Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likujdimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likujdimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

2.2. Rekomandimi:Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, duke kryer sistemimet e nevojshme në llogarinë 4864.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara ka diferenca me planifikimin, pasi realizimi i këtij zëri ekonomik në vitin 2021, është në masën 63%. Kjo situatë vjen si rezultat i mosrealizimit të investimeve të planifikuara për disa programe ekonomike, si programi ekonomik ñAdministrimi i pyjeve dhe kullotaveò (nuk është realizuar asnjë investim, mosparaqitje të ofertave në tender, mungesa e miratimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të planit të menaxhimit të fondit pyjor/kullosor), programi ekonomik ñRrjeti rrugor

ruralò realizuar në masën 70%, për arsye se shumë projekte janë në proces zbatimi, pasi një pjesë e konsiderueshme e kontratave janë lidhur në fund të vitit 2021.Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën ñaò në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò; Nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Financës, të marrë masa që kontratat me palët e treta të lidhen në një fazë më të hershme gjatë vitit buxhetor, me qëllim përshpejtimin e realizimit e investimeve të planifikuara sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Shkodër, brenda vitit buxhetor.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i likuidimeve të faturave të lëshuara nga subjektet e kontraktuara për kryerjen e punëve publike dhe kontabilizimit të tyre në llogarinë nr. 401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò, u konstatua senë 3 raste nga Drejtoria e Financës, janë pranuar fatura, me vlerë më të lartë se sa vlera e buxhetuar në PBA 2021-2023 për tôu financuar në vitin 2021. Kjo situatëështë konstatuar në kontratat e lidhura për kryerjen e investimeve: ñSistemim - Asfaltim i rrugës Vukatanë ï Guri i Kuq, (Loti 2)ò; ñSistemim Asfaltim rruga e Gështenjave Rrenc, Gur i Ziò dhe ñRikonstruksion vazhdimi i Rrugës ñAjasëmò.Pranimi i faturave me vlerë më të lartë se buxhetimi për vitin përkatës në gjykimin e grupit të auditimit ndikon në rritjen artificialisht të detyrimeve në fund të vitit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 40 në Udhëzimin plotësues të MFE nr.1381/1 prot., datë 25.01.2021 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2021ò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme që të mos ndërmerren angazhime buxhetore shumëvjeçare mbi vlerat e miratuara në planin e buxhetit vjetor dhe PBA.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e të Ardhurave nuk ka në strukturën e saj sektor të menaxhimit dhe mbledhjes së borxhit. Nisur nga numri i lartë i debitorëve për taksat dhe tarifat vendore, për kategorinë e taksapaguesve biznes dhe familjar, gjykojmë se ky sektor është i nevojshëm për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore në rend shterues për arkëtimin e debitorëve.

-Gjithashtu në strukturën organizative të Drejtorisë së tëArdhurave Vendore Bashkia Shkodër, konstatohet se nuk është parashikuar pozicioni i përgjegjësit të sektorit të kontrollit në terren, duke sjellë që ky sektor të kontrollohet direkt nga Drejtori i DAV Bashkia Shkodër.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në kreun XI- ñMbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguarò, nenet 88 ï 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në RSHò i ndryshuar; Nenin 3 në Ligjin nr.90/2012 ñPër organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreò; Shkronjën ñdò në pikën 8 në nenin 8, shkronja ñfò në pikën 4 në nenin 9, si dhe shkronjën ñbò në pikën 3 në nenin 22 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për plotësimin dhe përshtatjen e strukturës së DAV Bashkia Shkodër sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke

krijuar sektorin e menaxhimit të borxhit dhe pozicionin e përgjegjësit të sektorit të kontrollit në terren.

Brenda vitit 2022

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 468 ñDebitorë të ndryshëmò tëpasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Shkodër për arkëtim ndaj të tretëve, është kontabilizuar më pak, për vlerën 223,179,324 lekë duke mospërfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, si vijon:
-13,438,000 lekë kamatëvonesa për detyrimet ndaj biznesit dhe institucioneve;
-222,324,563 lekë debitorë kategoria familjar për taksa dhe tarifa vendore krijuar brenda vitit 2021;
-Gjoba të vendosura nga IMTV mbivlerësuar për vlerën 4,432,962 lekë, më tepër për 8,294,277 lekë kamatëvonesa, si dhe më tepër për 144,000 lekë për likuidime brenda vitit.Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, shkronja ñëò, pika 3, neni 12, Ligjin nr.25/2018 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, pika 1, neni 11, udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja ñcò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)*
6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme, që kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 ñDebitorë të ndryshëmò me kundërparti llogarinë nr. 470 ñTë ardhura për tôu marrëò.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 ñKreditorë për mjete nën ruajtjeò tëpasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë, për vlerën 2,064,307 lekë. Veprimet dhe mosveprimete mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar, pika 3.2 ñTrajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) ï funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4ò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)*
7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 ñKreditore për mjete nën ruajtjeò, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.683 ñShuma ty parashikuara ty shfrytëzimitò tëpasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, është kontabilizuar më pak, për vlerën 79,382,461 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1.1.5 ñGrupi i llogarive 15 ï Shuma të parashikuara për rreziqe e shfrytëzimeò në udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 ñPër disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në llogarinë nr. 683 ñShuma të parashikuara të shfrytëzimitò duke e debituar atë në momentin e njohjes dhe kredituar llogarinë nr. 150 ñShuma ty parashikuara py r rreziqe e shpenzime.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 486ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò me kundërparti llogarinë nr. 467 ñKreditorë të ndryshëmò tëpasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve, etj, është pasqyruar më pak, për vlerën 245,114,619 lekë, si rrjedhojë e klasifikimit jo të rregullt të llogarisë nr. 486 për 245,114,619 lekë diferencë (Llogaria nr.467 - 79,357,034 lekë; Llogaria nr.401-408 ï 165,757,585 lekë); Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 15 në udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 ñPër disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)*

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të Bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr.486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò, duke kryer mbylljen e saj në debi të llogarisë nr.467 ñKreditorë të ndryshëmò.Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò tëpasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se për shtesat në aktive të bëra gjatë vitit 2021, nuk është përllogaritur amortizimi për pjesën e mbetur nga data e marrjes në dorëzim të investimit deri në fund të vitit 2021. Përllogaritur për 362 objekte të vitit 2021 (likujdimi i fundit + 30 ditë shtesë deri në kolaudimin e objektit, si dhe pjesën e mbetur të vitit 2021) në vlerën 9,614,406 lekë. Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra nëudhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar, klasa 2 ñAktivet Afatgjataò, përbërja dhe trajtimi kontabël. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.213 ñRrugë, rrjete, vepra ujoreò, për vlerën 9,614,406 lekë.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 202 ñStudime dhe kërkimeò tëpasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se nuk është kryer amortizimi i llogarisë nr.202 ñStudime dhe kërkimeò, në vlerën 17,677,741 lekë (kosto historike + shtesa ï pakësime * 15%) sipas normës 15% për aktivet afatgjata jomateriale. Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra nëpikën 2, Klasa 2 ñTrajtimi kontabël për AAGJ jomateriale, shkronja ñdò në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 ñPër disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar, si dhe pikën 36 ñPy r aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi ty llogaritet me metody n lineare me normy amortizimi 15%ò në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ñPër

procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)*

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 ñStudime dhe Kërkimeò, për vlerën 17,677,741 lekë.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si vijon:

"Mjedisi i kontrollit"

-Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

-Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.

-Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

-Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta/të plota/mbivendosje.

"Menaxhimi i Riskut"

-Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e të cilave të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eleminimin e plotë të tij.

-Regjistri i riskut nuk përditësohet rregullisht (2 herë në vit).

-Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuara.

-Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues i drejtorive pranë Bashkisë Shkodër.

-Programi i kontabiliteti ñAlphaò i cili përdoret vetëm për veprimet e magazinës, është i vjetër duke moskryer plotësisht funksionet e sektorit të kontabilitetit, si dhe që ka nevojë të bëhet update dhe back up të të gjitha të dhënave.

"Aktivitetet e Kontrollit"

-Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

"Monitorimi"

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore nuk lidhet me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efiçencës e të efektivitetit.

-Në Bashkinë Shkodër mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeò; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 18-26, të Raportit të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër, drejtorët e drejtorive, si dhe përgjegjësat e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit tërisqeve,

me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.
12.2. Rekomandimi:Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investim në program kompjuterik të liçencuar për mbajtjen e kontabilitetit në Bashkinë Shkodër.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e NJAB Bashkia Shkodër përgjatë vitit 2021, u konstatua se:
- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mosofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;
- Nukjanë kryer auditime të teknologjisë së informacionit;
- Nukjanë kryer trajnime për stafin e NJAB Shkodër;
- Nukjanë mbuluar me auditim fusha të aktiviteteve që kryen Bashkia Shkodër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Mbrojtjes kundër Zjarrit, Qendra e Zhvillimit, Teatri ñMigjeniò etj;
-Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin në shkronjën ñçò në nenin 6, nenin 13, shkronja ñçò në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò; Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 ñPër arkivatò; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë ñPër miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016ò; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 ñMbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publikò; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 26-29, të Raportit të Auditimit)*
13.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Shkodër, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisk të lart, si vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike etj, në mënyrë që tôi ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave.
13.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Shkodër, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e instuticionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.
13.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.1.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.
1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likujdimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Shkodër për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 2,285,200 lekë, për 3 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga

shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për likujdimin e subjektit Gj.S, në urdhrin nr.628, datë 01.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna të subjektit Gj.S, moslikujdimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbarimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Shkodër. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet.Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, për vitin 2021, u konstatua senë fund të vitit 2021 në Bashkinë Shkodër dhe NJA në mënyrë progresive janë 5972 subjekte debitore në vlerën 777,462 mijë lekë, nga të cilët brenda vitit 2021 janë debitor 4837 subjekte ñBiznes dhe Institucioneò në vlerën 181,019 mijë lekë, e ndarë si më poshtë vijon:

-968 subjekte ñBiznesi i Madhò në vlerën 74,331 mijë lekë;

-3841 subjekte ñBiznesi i Vogëlò në vlerën 83,622 mijë lekë;

-28 subjekte ñInstitucioneò në vlerën 23,066 mijë lekë.

-Për vitin 2021 taksa e fjetjes në hotel paraqitet me realizim në vlerën 12,967 mijë lekë kundrejt planifikimit në vlerën 15,000 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua se, ndjekja e kësaj taksë aplikohej bazuar në akt-konstatimet e Sektorit të Kontrollit në Terren çdo datë 5 fillim muaj me tarifën e përcaktuar në VKB është 70 lekë/natë/personi për hotele nën 4 yje dhe 175 lekë për hotele 4-5 yje. Në këto akt-konstatime nuk evidentohet se sa netë kanë fjetur këto persona, por është evidentuar thjeshtë numri i tyre.

- Në raport me numrin e subjekteve debitorë në fund të periudhës ushtrimore dhe subjekteve për të cilat është kërkuar në zbatim të ligjit masa shtrënguese, konstatohet se numri i këtyre masave është i ulët, pasi nga 5972 subjekte fizik/ juridik me vlerë 238,686 mijë lekë janë marrë masa shtrënguese vetëm për 802 subjekte ose rreth 14% e totalit të subjekteve. Marrja e këtyre masave nuk është e plotësepse nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese në rend shterues, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, vendosje e barrës hipotekore, barrë siguruese, deri në kallëzim penal. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76, nenin 114 dhe nenin 117 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar; Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e Taksave Vendoreò, i ndryshuar; Nenin 64 në Ligjin nr.139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò, i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 ñPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò; VKB nr.63, datë 28.12.2020 Për miratimin e buxhetit të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodërtë marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjorepër arkëtimin e debitorëve në vlerën 777,462 mijë lekë.
2.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, u konstatua senë fund të vitit 2021 në Bashkinë Shkodër dhe NJA vlera debitore e kategorisë ñfamiljarò është 566,030 mijë lekë (216,018 mijë lekë debitor krijuar brenda vitit 2021), nga të cilat:
-16,014 familje debitore në vlerën 187,880 mijë lekë për **taksën e ndërtesës**;
-15,517 familje debitore në vlerën 7,203 mijë lekë për **taksën e truallit**;
-14,683 familje debitore në vlerën 256,764 mijë lekë për **tarifën e pastrimit;**
-14,290 familje debitore në vlerën 82,484 mijë lekë, për **tarifën e ndriçimit;**
-7368 familje debitore në vlerën 31,835 mijë lekë, për **tarifën e gjelbërimit;**
Gjithsej familje të taksuara sipas DAV janë 42,439 familje, ndërkohë rezultojnë 14,730 familje të cilat nuk taksohen/tarifohen, ku vetëm nëse do të bënim llogaritjet vetëm për tarifën e pastrimit, sipas nivelit të aplikuar në NJA, *rezultojnë 39,966,900 lekë të cilat ndikojnë në reduktimin e të ardhurave nga mospërfshirja e numrit të plotë të familjeve.* Për familjet të cilat nuk janë të taksuara dhe tarifuara, DAV Bashkia Shkodër nuk ka ndërmarrë veprime ligjore për identifikimin dhe faturimin e tyre, ku mos taksimi çon në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër.
-Sipas informacionit të pasqyruar në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit, llogaritë bankare të Agjentit tatimor Ujësjellës Kanalizime SHA kanë qenë të bllokuara nga shoqëri përmbarimore në bankat e nivelit të dytë, dhe si pasojë detyrimi që Ujësjellës Kanalizime SHA ka ndaj Bashkisë Shkodër nuk është transferuar në llogari të saj duke sjellë mosrealizim të ardhurash sipas planifikimit për vitin 2021 me një diferencë prej -50,466 mijë lekë, ose ndryshe -6% më pak të ardhura. Kjo vlerë ka ndikuar gjithashtu edhe në mosrealizimin e zërave kryesorë të të ardhurave si: taksa e ndërtesës, e truallit, tarifa e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit etj. Nga DAV Shkodër për këtë situatë nuk janë marrë masat ligjore (aplikimin e gjobave) ndaj agjentit tatimor UK SHA Shkodër, i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë ñFamiljarò.
Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 ñPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò, si dhe nenin 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*
3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë ñFamiljeò, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit për vitin 2021, *rezultojnë 39,966,900 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër.*
3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat

vendore nga abonentët familjarë, si rrjedhojë e bllokimit të llogarive bankare të UK ShA., Shkodër (në rolin e agjentit tatimor), vlerësimin e detyrimit që ka UK ShA Shkodër ndaj Bashkisë Shkodër si dhe aplikimin e penaliteteve ndaj UK Sha Shkodër.

3.3. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 566,030 mijë lekë, me qëllim eleminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për planifikimin dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se vlera debitore gjithsej për këtë taksë, progresivisht deri në vitin 2021 është 26,299,610 lekë (nga të cilat 6,306,764 lekë krijuar brenda vitit 2021), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodër.

-Gjithashtu konstatohet se nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithsej tokë bujqësore në Bashkinë Shkodër dhe Njësitë Administrative janë 16091 Ha, sipërfaqe e cila shërben si bazë për planifikimin e arkëtimeve nga kjo taksë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se taksa e tokës bujqësore është planifikuar në vlerën 21,736,000 lekë, ndërkohë sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit, bazuar në kategorinë e bonitetit dhe sipërfaqe tokë bujqësore, rezulton se taksa e tokës bujqësore e cila duhet të përllogaritet nga Bashkia Shkodër është 25,372,760 lekë pra *3,636,760 lekë planifikuar më pak nga DAV Bashkia Shkodër, vlerë e cila ndikon në reduktimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore.* Sipërfaqja e mësipërme e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore.Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 23 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 ñPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò; Pikën 1.2.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër për vitin miratuar me VKB nr.25 datë 20.12.2019, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë, duke evidentuar familjet me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet që kanë tokë bujqësore, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës 26,299,610 lekë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive është 231,342,984 lekë, nga të cilat krijuar në vitin 2021, për 464 posedues të lejes së legalizimit është 29,766,061 lekë, e cila përfaqëson të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër. Për arkëtimin e vlerës debitore krijuar në vitin 2021 nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve informale, nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, por nga DAV Bashkia Shkodër janë dërguar vetëm urdhrat për bllokimin e llogarive bankare. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenet 91-93 në Kreun XI të Ligjit nr. 9920,

datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, si dhe pikën 2 të nenit 4, shkronjën ñcò të pikës 1 të nenit 22/5 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 231,342,984 lekë, për legalizimin e objekteve informale.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekurapër arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2021 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër në vlerën 256,014,573 lekë, nga të cilat:

-Gjobat e IMTV të paarkëtuara janë gjithsej 254,345,500 lekë (36 gjoba në vlerën 173,468,000 lekë i përkasin vitit 2021);

-Gjobat e Policisë Bashkiake të paarkëtuara janë gjithsej 1,669,073 lekë, nga të cilat në vitin 2021 janë pa u arkëtuar 1405 gjoba në vlerën 1,650,022 lekë;

Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse[20]. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga IMTV Shkodër, rezulton se për gjobat e mësipërme është bërë kërkesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë (GJSHP) Shkodër për lëshimin e urdhrit për ekzekutimin e tyre nëpërmjet përmbarimit. Në vijim nga IMTV Shkodër i janë përcjellë vendimet e GJSHP Shkodër zyrave të përmbarimit për ekzekutimin dhe arkëtimin e gjobave të vendosura, por në vazhdim nuk administrohet informacion se cilat janë masat e marra nga zyrat e përmbarimit, si sekuestrimin e pasurive të luajtshme/paluajtshme për likujdimin e gjobës, të cilat në gjykimin e grupit të auditimit vonojnë procesin e arkëtimit të gjobave dhe reduktojnë investimet nga buxheti i Bashkisë Shkodër. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 ñPër organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunësò, i ndryshuar; Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò; Kreun IV.3.8 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve të mësipërm, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 256,014,573 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Kryeinspektori i IMTV Shkodër, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proçes shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbaruesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/paluajtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamat-vonesa) të palëve të treta ndaj Bashkisë Shkodër. Për çdo rast, kur nga përmbaruesit nuk merren të gjitha masat e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, Bashkia Shkodër tôi drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që nga kjo e fundit të aplikohen penalitetet ndaj përmbaruesve.

[20] Mbështetur në nenin 13 të Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 ñPër organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunësò, i ndryshuar, ñPër shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës në masën 500 deri në 5000 lekë. Kundërvajtësit janë të detyruar të paguajnë gjobën brenda 5 ditëve nga data e dhënies. Për çdo ditë vonesë gjoba paguhet me kamatë 2 për qind. Me kalimin e afatit njëmujor, gjoba vilet sipas rregullave të përcaktuara në ligjin "Për kundërvajtjet administrative"; duke vijuar me përcaktimin e bërë në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, si dhe Kreun IV.3.8 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve rezulton se përgjatë vitit 2021 në territorin e Bashkisë Shkodër dhe NJA, është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 45 stacione shitje.

-Nga numri i stacioneve të mësipërme u konstatua se në 28 prej tyre është ushtruar aktivitet pa u pajisur me licencën përkatëse. Për këto stacione konstatohet se përgjatë vitit 2021 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e subjekteve për detyrimin e pajisjes me licencë për ushtrimin e aktivitetit, njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë.

-Gjithashtu nga këto stacione shitje të karburantit u konstatua se për 20 prej tyre nuk është kryer pagesa e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të *ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodërnë vlerën 13,871,692 lekë.* Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 4 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e Taksave Vendoreò, i ndryshuar; Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja ñbò në pikën 1 në nenin 131 *"…nuk i paguan ato në buxhet"* të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në RSHò, i ndryshuar; Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt tõ drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët ndërmjet Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Shkodër të zbatojë masat shtrënguese, për arkëtimin e detyrimeve ndaj subjekteve të cilat kanë pasur licencë të ushtrimit të aktivitetit, por nuk kanë paguar tarifën përkatëse, në vlerën 13,871,692 lekë në total.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në territorin e Bashkisë Shkodër, ukonstatua se në vitin 2021 kanë kryer punime ndërtimi me fondet e Bashkisë Shkodër, 3 operatorë ekonomik të shpallur fitues, të cilët nuk kanë paguar tarifën e shërbimit, *duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 58,666 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të nxjerrë njoftim detyrimin për tarifën e shërbimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej 58,666 lekë.

Menjëherë

ANEKSE

Aneksi nr.1 – Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit nga faqja nr.29 deri në faqen nr.72.

Tabela nr.3 Ndryshimet buxhetore 2021

Vendimet e Kryetarit të Bashkisë Shkodër		Qellimi
Nr.	Date	
85	10.03.2021	Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave të shpenzimeve korrente brenda të njëjtin program për vitin 2021(3,096,000 leke)
90	12.03.2021	Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave të shpenzimeve korrente brenda të njëjtit program për vitin 2021(207,056 leke)
106	02.04.2021	Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave të shpenzimeve korrente brenda të njëjtit program për vitin 2021(13,000,000 leke)
123	13.04.2021	Për miratimin e rishpërndarjes së fondit të zërave të shpenzimeve korrente brenda të njëjtit program për vitin 2021(1,900,000 leke)
133	19.04.2021	Për ndryshimin e emërtimit të disa aktiviteteve në detajimin e buxhetit të vitit 2021
